

DITURIA ISLAME



“LEXO”, URDHRI I PARË HYJNOR
QË NGRITI CIVILIZIMIN ISLAM

INTERVISTË:
DR. ARMEND AGOLLI

SHKOLLAT MYSLIMANE
NË BRITANI

فَإِذَا بَلَغَ الْإِنْسَانُ الْحُلُمَ فَلْيَسْمَعْ وَالْيَنْصَحْ وَالْيَكْفُرْ

*"Allahu i lartëson besimtarët,
si dhe i lartëson në shkallë të lartë
edhe të diturit." (El Muxhadele: 11)*



EDITORIAL

- 4 Dituria, rruga e dëlirë drejt dinjitetit!

FETARE

- 5 "Lexo", urdhri i parë hyjnor që ngriti civilizimin islam
Dr. Ejup Haziri
- 9 Komentimi i sures El-Fet'h (8)
Sabri Bajgora
- 13 Mrekullitë historike të Kuranit (1)
Mimoza Sinani
- 17 Ku është Allahu i Madhërishëm?
Mufti Muhamed ibn Adem el-Kevtheri el-Hanefi
- 19 Ruajtja e tërësisë së haditheve, pretendimet dhe realiteti
Dr. Muhamed Stublla
- 23 Koncepti i drejtësisë sociale në mendimin bashkëkohor islam
Fitim Flugaj
- 26 Gjuetia dhe normat e saj në të drejtën islame
Dr. Flamur Sofiu
- 30 Parandalimi dhe obligimi i ndalimit të dhunës
Mihana Goga-Bekteshi

INTERVISTA

- 32 Intervistë me Dr. Armend Agollin

FAMILJE & EDUKIM

- 36 Shkollat myslimane në Britani të Madhe
Daut Dauti



- 38 Sfidat e arsimimit dhe edukimit të brezit të ri në një botë të trazuar
Nada Dosti

- 40 Kërkimi i diturisë, vlera dhe kujdesi
Azemine Kukaj

- 42 Arsimi, ky mision që nuk ecën dot para pa edukim
Bardha Kqiku-Luma

- 44 Kriza e arsimit në (peri)udhën digjitale
Ilaz Hajra – Lumi

- 45 Frika nga dështimi i madh në arsim
Entela Hidri

HISTORI & CIVILIZIM

- 47 Kuttabet, institucionet e para shkollore në historinë islame
Fatime Hafiz

- 50 Kontributi i Ibën Shatirrit (1304 – 1375) për zhvillimin e shkencave
M.sc. Artan S. Mehmeti


- 53 Vështrim historik mbi legjitimitetin e kalifatit osman
Ma. Agon Krasniqi

PERSONALITETE

- 56 Jeta e fakihut dhe muhadithit të njohur bashkëkohor Muhamed Teki Osmanit
Blerton Bahtiri

AKTIVITETE

- 56 Kryesia e BIK-ut mbajti takimin tradicional me bashkatdhetarët tanë



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 394 • viti 37 • shtator 2023
• Safer / Rebiul-Ewel 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
mr. Muharrem Tërnavë,
mr. Vedat Shabani.

Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Europrint", Prishtinë

Dituria, rruga e dëlirë drejt dinjitetit!



*“Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”
Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez Zumer, 9)*

Në vetëdijen e njeriut, faktori kohë fsheh brenda vetes një ndikim interesant, që pavërejtshëm e bën atë të ndërhyjë edhe në planet e tij të përvijuara në kokë qëmoti. Një çast, një ditë apo një muaj që ndërlidhet me ndonjë ngjarje të veçantë, e zgjon kureshtjen e tij dhe e bëjnë atë të ridisenjojë projektet e veta jetësore. Sduket analogji e largët nëse themi që ramazani, duke qenë muaj i bekuar dhe i devocionit, e rikthen vëmendjen tonë kah Zoti, dhe na bënë të përkushtohemi edhe më në rrugën e Tij, po kështu edhe shtatori, ky muaj i rikthimit në shkollë, e ringjallë shpirtin tonë kërkues dhe na shtonë vetëdijen tonë edhe më shumë për dituri, shkencë e shkollim.

Shtatori vije edhe për ta freskuar ndjenjën e vetëbesimit te brezi i ri, e për ta shpëtuar atë nga kthetrat e ndjenjës së pafuqisë, përluljes e inferioritetit. Thënë më ndryshe, na e rritë tejmasë vetëdijen tonë, aq sa për të qenë të fuqishëm që të prishin atë pakt të çuditshëm e poshtërues, që shumë nga bijtë e bijat e këtij brezi e kanë lidhur me injorancën e vanitetin.

Si askund tjetër, në ambientet shkollore, që në shumicën e vendeve të botës duket se hapen në këtë muaj, mblidhen e kokëtojnë të bekuar, një grumbull njerëzish me ideale sublime, ku asnjëri prej tyre s’mund të jetë më pak se kërkues i dijes, eventualisht mësues i saj. Këta të fundit, kanë për detyrë që të bëhen jo thjesht “ciceronë” të informatave të përsëritura para nxënësve entuziastë, që hapin sytë e vëzhgojnë me kureshtje çdo gjë, por duhet edhe të shndërrohen në shëmbëlltyra të gjalla që edhe me heshtjen e tyre, disi të thonë po aq sa thonë me gojët e tyre. Për më tepër, sduhet harruar as mësuesit e as nxënësit që kërkimi dhe dhënia e diturisë është adhurim-ibadet me të cilin ne afrohem edhe më shumë tek Allahu-Zoti ynë. Shpërblimin e kësaj veprë fisnike do e shijojmë edhe në këtë botë, e në formë mahnitëse do e përjetojmë në botën tjetër.

Sokrati dikur thoshte se ekziston vetëm një e mirë, e ajo është dija dhe ekziston vetëm një e keqe, e ajo është injoranca. E ne, në shkollat tona kemi për mision që këtë të mirë-dijen ta çmojmë, ta kërkojmë e ta shpërndajmë në njërën anë, por dhe në anën tjetër, t’i shpallim luftën e pa kompromis asaj të keqeje të madhe – injorancës. Mu për këtë arsye, shkenca dhe dija nuk duhet të kufizohen në një vend, racë, kulturë ose rajon, në fakt duhet të konsiderohen si e drejtë themelore e njeriut anëmbanë globit. Dija është vlerë universale, e përbashkët që është bërë për të qenë në shërbim të krijesës njeri.

Ngazëllimi për lexim, dashuria për dije dhe pasioni për të zhbiruar në të panjohurën, që të gjitha së bashku, po sikurse dje, edhe sot vazhdojnë të rrëfejnë për hendekun civilizues që ndan vendet e popujt e zhvilluar nga ata që janë të kënaqur me të qenët konsumues të produkteve të civilizimeve të tjera. Këtë diferencë e vuri në spikamë edhe citati kuranor, në të cilin Zoti i Gjithësisë në një stil stimulues dhe me një version të pyetjes retorike na u drejtua duke na thënë: “Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez Zumer, 9). I lavdëroi e i çmoi pa doreza ata të zotët e mendjes, e pastaj la të hapur garën fisnike në mes të njerëzve për shkencë, dije e njohuri. Kështu më së miri u jetësua ai postulati i njohur arsimnxitës “të mësuarit gjatë gjithë jetës”, duke e shndërruar atë në një fiksion individual për secilin që dëshiron ngritjen shpirtërore e avancimin intelektual.

Për ta mbajtur brezin e së ardhmes të lidhur me arsim e shkencë, na duhen kristalizuar në mendjet dhe shpirtat e tyre synimet e kësaj rruge fisnike. Andaj duhet theksuar se “synimet e larta të arsimit në perspektivën islame janë ofrimi i një harmonie për njeriun që përfshin formimin e karakterit të rrënjësuar në përlulësi ndaj Zotit, dashuria ndaj krijesave të tjera, qëndrueshmëria e durimi në kohë vuajtjesh, mirësjellja, ndershmëria, guximi për të thënë të vërtetën, dhe qëndrimi i balancuar i emocioneve njerëzore, etj. Kështu, edukimi pa një theks në formimin e edukimin e karakterit, nuk ka praktikisht asnjë vlerë në Islam.” (Al Attas, 1954).

Mr. Driton Arifi

“Lexo”, urdhri i parë hyjnor që ngriti civilizimin islam

Dr. Ejup Haziri



Dija është jetë për njerëzit që vuajnë nga sëmundja e padituriës, injorancës dhe pakujdesisë. Për më tepër, ajo i përngjet një llambadari që ndriçon rrugën. Ai që mbushet me të, do të jetë i shpërblyer dhe i ruajtur. Dija e ngrit njeriun dhe e vendos atë në një vend meritë. Islami i dha rëndësi të madhe dijes, ku fjalët e para të Kuranit zbritën për lexim e dije, në mënyrë që rrugëtimi i njeriut të fillon pikërisht nga aty.

SHKËNDIJAT E PARA TË KURANIT ISHIN PËR DIJE E LEXIM

Për vlerën e dijes mjafton që ajeti i parë i zbritur për njerëzimin, i cili ndërlidhet direkt me dijen. Fjalët e para të Kuranit iu kushtuan pikërisht dijes si vlerë e jashtëzakonshme,

përmes së cilës njeriu kalon në një stad më të lartë. Kjo padyshim që është një shenjë e qartë se kjo fe e lartëson tejmas vlerën e dijes dhe thërret ithtarët e saj t'i japin rëndësinë e duhur asaj nëpërmes leximit, shkrimit, vrojtimit, hulumtimit dhe studimit.¹ Vetëm kështu ata mund të dallohen nga të tjerët dhe të avancojnë. Përndryshe vështirë të dallohen nga injorantët që pandehin lartësimin dhe njohjen, ndonëse në realitet nuk njohin asgjë, madje as veten e tyre!

Nuk është e rastësishme përse shpallja hyjnore rrugëtimin e saj e filloi me fjalët e dijes dhe njohjes, ngase njohja është parahyrje në qytetërim dhe civilizim, bazament i ngritjes dhe qëllim i lartë edukativ:² “Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar! Është Ai që ua mësoi pendën. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (Alek, 1-5).

Në sqarimin e këtyre ajeteve, Nedeviu shprehet: “Feja e cila nuk e harron penën modeste, madje as në momentet e para të frymëzimit; nuk e harron as në çastet e para të frymëzimit hyjnor; nuk harron të vërtetojë se rrugëtimi i dijes është i ndërlidhur me lapsin; nuk e harron penën as në veçimin në shpellën Hira që bënte aty një i Dërguar analfabet, që pranoi shpalljen hyjnore për udhëzimin e mbarë njerëzimit. Ishte ky i Dërguar që nuk kishte lidhje me penën, madje nuk dinte as si ta kapte penën. Ai asnjëherë nuk kishte mësuar për artin e të shkruarit e as të lexuarit. Si ai (i Dërguari), njeriu nuk gjen diç të

Dija është jetë për njerëzit që vuajnë nga sëmundja e padituriës, injorancës dhe pakujdesisë. Për më tepër, ajo i përngjet një llambadari që ndriçon rrugën.

ngjashëm në tërë historinë njerëzore. Nuk mund ta imagjinojmë njeriun këtë pozitë dhe gradë të lartë. Nuk mund ta imagjinojmë se shpallja do të zbriste pikërisht mbi njeriun që ishte analfabet, që i përkiste një populli e një vendi analfabet, që nuk dinin lexim e as shkrim....në kohën kur pas disa shekujve u arrit prapë lidhja mes tokës e qiellit. Kjo shpallje nuk parapriu me fjalët “adhuro”, e as me fjalët “falu”, apo me fjalë të tjera të kësaj natyre, mirëpo i parapriu me fjalën “lexo!” Fjalë që thërriste atë komunitet në lexim, ndonëse ata nuk kishin lidhje me lexim, mirëpo kjo ishte një pëlqim dhe vendosmëri se ky *ymet* që është i ngarkuar me udhëzim, edukim dhe mësim, nuk do të jetë vetëm një *ymet* i lidhur me mësim, përkundrazi do të jetë mësim (ndriçim) për botën përmes përhapjes së mësim, ngritjes së edukimit dhe lartësimit të tij.³

Erdhi shpallja hyjnore që i zbriti të Dërguarit të paarsimuar, në mënyrë që ta forconte lidhjen me Krijuesin e tij. Erdhi shpallja dhe emrin “dije” e përmendi bashkë me emrin e Zotit, në mënyrë që ta mësonte njerëzimin se pikënisja dhe fillimi i dijes, mësimi dhe leximi të bëhet në emër të Zotit...ky ajet (ajeti i dijes) për të cilin po flasim, është ajeti i një revolucionit dhe një puçi të madh në meditim, mendje dhe shpirt...

A ka dikush që lartësoi më tepër vlerën e penës në tërë historinë njerëzore se sa kjo shpallje? Kjo shpallje e përmend vlerën e saj, madje që në para hyrje të revelatës hyjnore, pikërisht në veçimin që i Dërguari bënte në shpellën Hira, në zbritjen e parë të saj nga qielli, e përmend penën që ndoshta

Erdhi shpallja
dhe emrin
“dije” e
përmendi
bashkë me
emrin e Zotit,
në mënyrë që
ta mësonte
njerëzimin se
pikënisja dhe
fillimi i dijes,
mësimi dhe
leximi të
bëhet në emër
të Zotit...


edhe nuk mund ta gesh edhe një penë të vetme nëpër shtëpitë e Mekës, apo ndoshta do ta gjenit atë në shtëpinë e Vereka ibën Nufelit, apo të ndonjë njeriu tjetër që leximin e kishte mësuar në ndonjë vend tjetër, apo ndoshta penën nuk mund ta gjeni as si përmendje në divanet e poetëve arab të kohës së injorancës, sado që i shfletoni fletat dhe sado që lexoni.⁴

Kjo shpallje një *ymet* të tërë të njohur si *ymeti* i injorancës e ktheu në *ymet* të dijes dhe njohurive. Prandaj, është absurde që ky *ymet* ta braktisë leximin e dijes, kur shkëndijat e para ishin për dije e lexim. I Madhërishmi që në rrugëtimin e parë të shpalljes, nga mesi i mijëra tematikave që flet Kurani, zgjodhi pikërisht dijen, për t'i treguar njerëzimit pikënisjen e reformimit të tij dhe rrugën që duhet të ndjekë.

DIJA I NGRIT DHE I LARTËSON NJERËZIT

Dija i ngrit dhe i lartëson njerëzit, dhe se ata falë dijes së mirëfilltë, meritojnë një vend të lartësuar tek Allahu i Madhëruar. Për çastet e tyre që i kaluan në kërkimin e dijes dhe në shpërndarjen e saj, mund ta fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe xhenetin e Tij: “...Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. Allahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (Muxhadele, 11).

Allahu i Madhëruar në një ajet në Kuran shtron një pyetje interesante, kur thotë se a janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë: “(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimin të) botës tjetër dhe



shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Zumer, 9).

Parashtrimi i pyetjes brenda këtij konteksti është shumë interesant, për faktin se përgjigja e saj është e njohur nga të gjithë. Të gjithë e dinë se mes atyre që dinë dhe atyre që nuk dinë ka dallim dhe dallimi është i madh. Por, Allahu pasi që parashtron pyetjen, vjen me një përgjigje interesante, kur thotë: “Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” Ngrit njerëzit e dijes dhe iu jep epitelin atyre se ata janë të zotët e mendjes dhe ata marrin mësim falë përgatitjes së tyre dhe diturisë që posedojnë.

Sa njerëz të padijshëm e injorantë falë rrugës së dijes dhe dituritë që morën u shndërruan në yje që shndritën mbarë globin. Ata ishin krejtësisht të panjohur gjersa nuk kishin dije. Por, kur u pajisën me dije, ata i njohu e tërë bota.

Mjeshtri i madh i penës, Ibën Sejidihi ishte i panjohur. Atë askush nuk e njihte. Që kur u pajis me dije, atë e njohën të gjithë. Ai shkroi një libër në fushën e gjuhës “*Muhassas*”, libër voluminoz në nëntëmbëdhjetë vëllime, saqë njeriu mezi e lexon atë gjatë tërë jetës së tij. Por, si e ka shkruar ai? Po të dije se Ibën Sejidihi ka qenë i verbër dhe ai diktoi tërësisht nga mendja e tij, pa iu referuar asnjë libri. Mendoni se ky mjeshtër i madh nuk kishte vuajtje? Gaboheni, ngase ai ishte i verbër dhe kishte vuajtje, por megjithatë ai nuk mbeti në vuajtje, vuajtjen e shndërroi në lumturi, sepse kënaqej kur ai diktonte për librin në fjalë. Ai u bë inspirim për njerëzimin, se edhe në vuajtje ti mund t’i shërbesh njerëzimit. Ai nuk u njoh për nga vuajtja e tij, por nga ajo që i solli njerëzimit, e që janë punimet e tij.

Po kush e njihte Serahsiun para se të merrej me shkrimet e tij të jashtëzakonshme? Ai u bë i njohur kryesisht falë librit të mirënjohur “*Mebсут*”, libër voluminoz që hyri në analet e jurisprudencës islame, saqë ata që i referohen këtij lëmi të shkollës hanefite, e kanë si referencë librin e tillë. Sikurse Serahsiu janë me mijëra e mijëra dijetarë që u bënë të njohur kryesisht falë angazhimit të tyre në dituri. Ata nuk njiheshin nga askush, por ishte dija e tyre që i njohu e tërë bota. Vepra e tyre kolosale mbeti gjurma e tyre më e madhe pas vdekjes së tyre, me të cilën ata gjithnjë përmenden e kujtohen. Ata vdiqën, por pas vetes lanë një veprimtari të madhe saqë ata gjithnjë kujtohen nga njerëzimi.

Kjo shpallje
një ymet të
tërë të njohur
si ymeti i
injurancës e
ktheu në ymet
të dijes dhe
njohurive.
Prandaj, është
absurde që ky
ymet ta
braktisë
leximin e
dijen, kur
shkëndijat e
para ishin për
dije e lexim.

Ky është thesari i pashtershëm prej të cilit vlara nuk shkëputet e as që pakësohet as me vdekjen e individit. Ai vdes, por vepra e tij e lënë e bënë në njëfarë forme të pavdekshëm. Shpërblimi i tij vazhdon t’i shkojë atij ndonëse ai e ka lënë këtë jetë. Kjo është dija dhe vlara e saj e jashtëzakonshme që i shërben individit edhe pas vdekjes së tij. Sa e sa njerëz ishin të panjohur, por dija i shndërroi në mbretër të dijes.

PËR KËRKUESIN E DIJES LUTET ÇDO GJË

I Dërguari i Allahut qëndronte me shokët e tij, i mësonte, i këshillonte dhe i edukonte ata në forma dhe mënyra të ndryshme. Vetë thëniet e tij që janë me mijëra apo me qindra mijëra, janë indikacione të qarta se ai kishte synim paqen dhe në çdo formë e luftonte injorancën. Ai një rast e qortoi shokun e tij duke i thënë se ke veprime të kohës së injorancës, vetëm pse ai bëri një veprim. Në disa tekste të tij theksohej se veprimet e kohës së injorancës i kishte varrosur, që nënkuptonte se askush nuk ka të drejtë t’i rikthejë ato. Ai kohën e injorancës dhe paditurisë e ktheu në kohë të dijes dhe ngritjes. Ai një popull të tërë të paditur, e ktheu në një popull që përhapën dije të mirëfilltë. Thuajse në çdo çast

këshillonte të tjerët që t’i rreken dijes dhe të mos mbesin të paditur. Dikush në mesin e tij një herë i përmendi dy njerëz, njëri prej tyre adhuresit e tjetri dijetar e ai tha: “Vlera e dijetarit ndaj adhuresit është sikurse vlara ime ndaj jush, e më pas tha: “Me të vërtetë Allahu, engjëjt e Tij, banorët e qiejve dhe tokave, madje edhe milingonat në vrimat e tyre dhe peshku, luten mirë për mësuesin e njerëzve.”⁵

Shumica e njerëzve të asaj kohe nuk dinin shkrim e lexim, prandaj i Dërguari i Allahut shfrytëzonte rastin dhe i nxiste të tjerët në nxënien e njohurive dhe në avancimin e tyre. Ai u tregonte atyre se për atë që kërkon dije lutet çdo gjë, ashtu siç erdhi në hadithin që e transmeton Ebu Derdaja, i cili thotë: “E dëgjova të Dërguarin e Allahut, alejhi selam, duke thënë: “Ai që ndjek një rrugë për kërkim dije, Allahu do t’ia lehtësojë atij rrugën për xhenet. Pa dyshim se engjëjt i vendosin krahët e tyre si shenjë kënaqësie ndaj kërkuesit të dijes, e për kërkuesin e dijes kërkon falje çdo krijesë në qiell e tokë, gjersa edhe peshku në ujë. Vlera e dijetarit ndaj adhuresit është sikurse vlara e hënës ndaj planetëve. Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, e pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë e as dërrhemë, por ata lënë

trashëgim dijen. E ai që e merr atë, veç ka marrë një hise të çmuar.”⁶

Kjo është vlera e dijes në Islam, ku që nga banorët e qiellit e deri tek ata të tokës, duke përfshirë të gjitha krijesat, luten dhe kërkojnë falje për kërkuesin e dijes. Rruga e dijes kërkon mund, angazhim dhe sakrificë. Asgjë nuk arrihet pa mund, prandaj edhe në hadith është përmendur rruga e dijes, që nënkupton se nëse dëshiron ta ndryshosh veten, duhet lëvizur nga vendi yt. Duhesh të largohesh nga shtëpia jote, sepse rruga e dijes nënkupton lëvizjen, angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme. Në këtë kontekst, kur dikush e ftoi imam Malikun ta mësojë djalin e një princi në shtëpinë e tij, ai tha fjalën e tij të mirënjohur: “Dituria vizitohet, e nuk të viziton!” Ai thjesht deshi t’ia jap një mësim princit se nëse dëshiron që djali yt të thellohet në dituri, atëherë ai duhet të bëjë përpjekje për dituri. Në të kundërtën, askush s’mund t’ia sjellë diturinë brenda mureve të pallatit. Ngjashëm kishte vepruar edhe imam Buhariu, kur guvernatori i Buharasë i kishte kërkuar atij të vinte t’ia mësonte fëmijën e tij, Buhariu iu përgjigj se nëse ka interesim mund t’i ndjek mësimet, por jo unë të vijë ashtu. Madje kjo përgjigje e Buhariut e kishte hidhëruar guvernatorin e Buharasë.

DIJETARËT JANË NJERËZIT MË TË ÇMUAR

Kurani i lartëson njerëzit që janë të pajisur me dije, duke i trajtuar dijetarët si njohësit më të mirë dhe të vetmit që realisht ia kanë frikën më së tepërmi Zotit, gjegjësisht si njohësit më të mirë të Tij. Allahu i lartësuar thotë: “...Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka është mëkatfalës.” (Fatir, 28).

Jo vetëm kaq, por dijetarëve iu shtua pozita e tyre tek Allahu deri në atë masë sa që i Madhërishmi e krahasoi përmendjen e dijetarëve në një vijë me emrin e Tij të Madhëruar dhe me engjëjt e tij në kontekstin e njohjes: “Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, edhe engjëjt e ata që kanë dijeni, se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit, të Urtit.” (Ali Imran, 18).

Në këtë kontekst, i Dërguari i Allahut veç kishte treguar për vlerën e madhe që bartë një dijetar i mirëfilltë, kur ai kishte pohuar se vlera e një dijetari ndaj një adhuruesi është sikurse vlera ime ndaj njerëzve të tjerë. Askush nuk mund të krahasohet me të Dërguarin e Allahut, në asnjë prej segmenteve, përveç njerëzores. Kështu është edhe me dijetarin, ku asnjë adhurues, sado i njohur të jetë në adhurimin e tij, nuk mund të krahasohet me një dijetar të mirëfilltë.

I DËRGUARI I ALLAHUT, MËSUESI NJERËZIMIT

Mësuesi më i madh që njohu njerëzimi është i Dërguari i fundit, Muhamedi a.s., i cili nuk e kishte lutur Zotin që t’i shtojë diç ashtu siç e kishte lutur Zotin që t’ia shtojë dijen e

tij, ashtu siç Allahu i Madhëruar e përmendi këtë fakt në librin e Tij: “...dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!” (Taha, 114).

Nuk ka si të mos kërkonte një gjë të tillë i Dërguari i Allahut, kur atij i ishin zbritur vargje rreth penës e dijes, madje vetë Allahu i Madhëruar ishte betuar në lapsin që nënkupton dijen:⁷ “Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë!” (Kalem, 1).

Ndonëse i Dërguari i Allahut nuk kishte pasur fatin të mësojë para se t’i vinte shpallja hyjnore, mirëpo pas shpalljes ai ishte njëri prej atyre që më së tepërmi thërriste në dije e njohuri. Madje ai aplikoi në praktikë këtë që po e themi në raste të caktuara, siç bie fjala pas luftës së Bedrit, kur një pjesë e kundërshtarëve të tij ishin zënë robër dhe pas luftës kishte mendime të ndryshme se si të veprohej me ta. I Dërguari i Allahut ndoqi një metodë efikase që nuk do ta ndiqte askush pos tij. Ai u dakordua që nëse një i zënë rob di shkrim e lexim, duhet t’i mësojë dhjetë myslimanë dhe me këtë ai e fiton lirinë. Ky mendim nuk përkonte me atë kohë. Ishte një risi që asnjëherë nuk qe praktikuar. Thjesht ishte mendim që përkonte me qytetërim dhe civilizim, e që askush para tij nuk e kishte praktikuar. Ky është indikacion i qartë se i Dërguari i Allahut e donte dijen, e luftonte injorancën në çdo formë. E donte paqen dhe e urrente luftën. Ai tërë kohën ia kushtoi arsimimit, ngritjes dhe avancimit. Në çdo vend e në çdo çast i mësonte shokët e tij me butësi, urtësi dhe përmes këshillave të ndryshme.

Ai i udhëzonte ata që të merrnin rrugën e dijes dhe u tregonte se në rrugëtimin e tyre të dijes, me vete e kanë Allahun dhe se për ta lutet çdo gjë. Ai gjithashtu i inkurajonte ata se kërkimi i dijes është i domosdoshëm për meshkuj e femra, dhe se kërkimi i dijes nuk kufizohet vetëm në vendin ku jeton, por dijen duhet kërkuar në çdo vend. Andaj nuk është e rastësishme kur ai i nxiste të tjerët që ta kërkojnë dijen edhe në vendet më të largëta që njiheshin atëherë, si Kina e të ngjashme.

Sa shumë kemi nevojë për një njeri të tillë vizionar e shëmbëlltyrë, i cili e drejtonte njeriun në gjërat e mira e të dobishme për të.

1 Abdulkerim Bekkar, *El-Muslimune bejne-t tehadidi ve-l muvaxheheh havle-l terbijeti ve-t talimi*. Bot. I-rë. Daru-l kalem, Damask, 2011m, f.131.

2 Mina Ali Es-Salus. *El-Hukuk et-talimijeh lil mer’eti fi-l islam min vakii-l Kurani ve-suneti*. Bot.I-rë, Daru-neshr, Kairo, 2002, f.68; Kutb Mustafa Sanu. *En-Nudhum et-ta’limijeh el-vafideh fi Efrikija*. Kitabu-l Ummeh. Bot.I-rë, Vizaretu-l Evkaf, Katar, 1419, nr. 63, f.16.

3 Nedevi, Ebu-l Hasen, *Muhaderatun Islamijetun fi-l fikri ve-d Da’veti*, bot. I-rë. Dar Ibën Kethir, Damask-Siri, 2001, v.I, f. 572-573.

4 Nedevi, *Muhaderatun Islamijetun fi-l fikri ve-d Da’veti*. v.I, f. 573-574.

5 Transmeton Tirmidhiu në Sunen. V.IV, f.347. nr. i hadithit 2685 dhe thotë se hadithi është autentik.

6 Ibën Maxheh në Sunen, V.I, f.81. nr. 223. Hadithi është autentik.

7 Halil El-Hudri, *Menhexhijetu-t tefkir el-ilmij fi-l Kurani-l kerim ve tatbikatuha et-terbevijeh*, f.76.

Komentimi i sures El-Fet'h (8)

PREMTIMI HYJNOR PËR FITORE DHE ÇLIRIME TË REJA PËR MYSLIMANËT

Sabri Bajgora

وَعَدَكُمْ اللَّهُ مَغَانِمَ كَثِيرَةً تَأْخُذُونَهَا فَعَجَّلَ لَكُمْ هَذِهِ وَكَفَّ أَيْدِيَ النَّاسِ عَنْكُمْ وَلِتَكُونَ آيَةً لِّلْمُؤْمِنِينَ وَيَهْدِيَكُمْ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا ﴿20﴾ وَأُخْرَى لَمْ تَقْدِرُوا عَلَيْهَا قَدْ أَحَاطَ اللَّهُ بِهَا وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرًا ﴿21﴾ وَلَوْ قَاتَلَكُمُ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلُوا الْأَذْبَارُ ثُمَّ لَا يَجِدُونَ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿22﴾ سُنَّةَ اللَّهِ الَّتِي قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلُ ۖ وَلَنْ تَجِدَ لِسُنَّةِ اللَّهِ تَبْدِيلًا ﴿23﴾ وَهُوَ الَّذِي كَفَّ أَيْدِيَهُمْ عَنْكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ عَنْهُمْ بِبَطْنِ مَكَّةَ مِنْ بَعْدِ أَنْ أَظْفَرَكُمْ عَلَيْهِمْ ۚ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرًا ﴿24﴾

“Allahu ju premtoi plaçkë të pasur që do ta fitoni, e këtë (të Hajberit) jua përshpejtoi juve. Ai i pengoi duart e njerëzve kundër jush, që kjo të ishte një shenjë (e mirë) për besimtarët dhe që t’ju udhëzonte në rrugë të drejtë. Do të ketë edhe të tjera (fitore luftime), të cilat ju ende nuk i keni arritur, e që Allahu i di sipas përcaktimit të Tij, sepse Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Nëse jobesimtarët do t’ju shpallnin luftë, do të ishin ata që do të sprapseshin, dhe pastaj nuk do të gjenin as mbrojtës, e as ndihmës. I tillë ka qenë ligji i Allahut edhe më parë, e ti në ligjin e Allahut kurrë nuk do të gjesht ndryshime. Është Ai që pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, në luginën e Mekës, pasi që jua mundësoi ngadhënjimin ndaj tyre. Allahu sheh gjithçka që veproni.” - (El-Fet’h, 20-24)

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT 24

- Transmetohet nga Enesi r.a., të ketë thënë: Në ditën e Hudejbijes, 80 burra të armatosur patën zbritur nga kodra e Ten’imit, për ta zënë në befasi të Dërguarin e Allahut, por ishin kapur (nga myslimanët). Resulullahu s.a.v.s. i kishte liruar të gjithë, dhe në shenjë të tyre ka zbritur ajeti i 24: “Është Ai që pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, në luginën e Mekës, pasi që jua mundësoi ngadhënjimin ndaj tyre...”¹

- Transmetohet nga Abdullah bin Mugaffel el Muzeni të ketë thënë: “Ishim në Hudejbije, pranë pemës të cilën Allahu e ka përmendur në Kuran, dhe derisa ishim kështu, kur befasi na dolën përpara 30 djem² të rinj, të armatosur, dhe ia mësynë drejt nesh. I Dërguari a.s. u lut kundër tyre dhe Allahu ua mori shikimin, e ne shkuam e i zumë të gjithë. I Dërguari a.s. i pyeti. “A keni ardhur në besë të ndokujt këtu? A ju ka ofruar dikush siguri?” - Për Zotin jo, - u përgjigjën ata. Atëherë Resulullahu s.a.v.s., i la të lirë, dhe në shenjë të tyre ka zbritur ajeti: “Është Ai që pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, në luginën e Mekës, pasi që jua mundësoi ngadhënjimin ndaj tyre...”³

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Në ajetet paraprake, Allahu i Gjithëmëshirshëm, flet fjalë miradije për ata që u besatuan në Hudejbije, për hir të gatishmërisë së tyre për t’u sakrifikuar në emër të lartësimit të fesë së Allahut. Për këtë arsye, Ai ua premtoi myslimanëve së pari çlirimin e Hajberit, e më pas edhe shumë fitore e çlirime të reja, deri në Ditën e Gjykimit, kurse tash, në këto



ajete, shohim vazhdimësinë e premtimeve hyjnore për çlirime dhe fitore të reja, përveç Hajberit. I Lartmadhërishmi ua bëri të qartë myslimanëve, se ndihma e Tij nuk do të mungojë, ashtu siç nuk kishte munguar asnjëherë në ndihmën dhe përkrahjen e besimtarëve të drejtë nëpër kohë. Ky është ligj i Allahut që kurrë nuk ndryshon.

KOMENT:

20. Allahu ju premtoi plaçkë të pasur që do ta fitoni, e këtë (të Hajberit) jua përshpejtoi juve. Ai i pengoi duart e njerëzve kundër jush, që kjo të ishte një shenjë (e mirë) për besimtarët dhe që t'ju udhëzonte në rrugë të drejtë.

Premtimi hyjnor për besimtarët e Njeshmërisë, se ata do të kenë fitore të mëdha në luftëra kundër armiqve, nga të cilat do të përfitonin edhe pasuri apo plaçkë të shumta, s'ka dyshim se do të realizohet nëpër kohë, deri në Ditën e Gjykimit. Nga kjo pjesë e ajetit kuptohet se bëhet fjalë për pasuritë që do t'i fitojnë myslimanët në të ardhmen, pas kthimit nga Hudejbija, sepse ata nuk hyrën në Mekë, që të merrnin pre të luftës.⁴ Sipas të gjithë komentatorëve, me fjalinë: "...e këtë (të Hajberit) jua përshpejtoi juve", nënkuptohet çlirimi i Hajberit dhe zotërimi i pasurive të shumta të hebrenjve, që iu dha krahë myslimanëve, për të vazhduar tutje në misionin e tyre të përhapjes së Fjalës së Allahut. Ndonëse ka mendime se kjo fitore e përshpejtuar është vetë Marrëveshja e Hudejbijes, megjithatë si mendim nuk ka ndonjë përkrahje nga mesi i dijetarëve.

Ky ajet po ashtu flet edhe për marrjen në mbrojtje të familjet myslimane në Medinë nga ana e Allahut xh.sh., kur myslimanët kishin marrë paqësisht rrugën drejt Mekës, për ta kryer umren, në krye me Pejgamberin a.s.. Kjo mbrojtje nënkuptonte moslejimin e duarve të hebrenjve dhe arabëve përreth Medinës, që të zgjateshin drejt familjeve të myslimanëve, përfshirë këtu pleqtë, gratë dhe fëmijët, ashtu siç i kishte penguar edhe duart e hebrenjve të Hajberit dhe të aleatëve të tyre nga fiset Esed dhe Gattafan, që t'i dëmtonin myslimanët gjatë rrethimit dhe çlirimit të fortifikatave të Hajberit.⁵ Përveç kësaj mburoje hyjnore, Allahu i Madhërishëm kishte mbjellë frikë dhe lemeri në zemrat e hebrenjve dhe aleatëve të tyre.⁶

Premtimi hyjnor për besimtarët e Njeshmërisë, se ata do të kenë fitore të mëdha në luftëra kundër armiqve, nga të cilat do të përfitonin edhe pasuri apo plaçkë të shumta, s'ka dyshim se do të realizohet nëpër kohë, deri në Ditën e Gjykimit.

Të gjitha këto përgëzime dhe mbrojtje të myslimanëve nga i Madhërishmi prej armiqve shumëfish më të fortë ushtarakisht dhe numerikisht, pa dyshim që ishin shenja të mira nga ana e Tij për besimtarët, që ata ta kuptonin se Allahu dhe i Dërguari i Tij, janë të sigurtë në premtimet e tyre. Pasi do t'i shihnin haptazi këto shenja të mëdha, e njëra prej tyre ishte edhe çlirimi i Hajberit, myslimanëve pa dyshim do t'ju shtohet edhe me tepër imani dhe do ta shijonin me tërë qenien e tyre ëmbëlsinë e imanit dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Vetëm me një besim kaq të fortë, dhe duke qenë të frymëzuar nga burimi i udhëzimit hyjnor, këta burra sypatrembur, do ta ndryshonin rrjedhën e njerëzimit, duke përhapur gjithandej drejtësi dhe dashuri në emër të fesë që Allahu e ka përzgjedhur për mbarë njerëzimin – Islamin.

21. Do të ketë edhe të tjera (fitore), të cilat ju ende nuk i keni arritur, e që Allahu i di sipas përcaktimit të Tij, sepse Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Në këtë ajet, shohim qartë një paralajmërim përgëzues për besimtarët, se në të ardhmen, ata do të korrnin fitore të reja, dhe do të zotëronin plaçka të mëdha lufte, që për momentin, nuk ishin në gjendje t'i arrinin, sepse ende ishin të preokupuar me ngritjen e themeleve të shtetit të ri, që bazohej në besimin e pastër në Zotin Një, në drejtësi dhe në trajtim të dinjitetshëm për secilin pjesëtar.

Për këto fitore madhështore të myslimanëve që do të ndodhin në të ardhmen, di vetëm Allahu, sipas Dijes dhe përcaktimit të Tij, sepse Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Lidhur me pjesën e ajetit: "*Do të ketë edhe të tjera (fitore), të cilat ju ende nuk i keni arritur...*", komentatorët e Kuranit kanë dhënë disa mendime:

- Ibn Abasi në një mendim të tij thotë se me fjalët "*Do të ketë edhe të tjera (fitore)...*", synohet Hajberi, meqë atë që ua përshpejtoi ishte marrëveshja e Hudejubijes.⁷

- Preja e luftës që u fitua në Hunejn, pasi u mund fisi i madh arab Hevazin, mendim të cilin e ka përzgjedhur Ebu Su'udi.⁸

- Çlirimi i Mekës, mendim i Katades, të cilin e kanë përzgjedhur Ibn Xherir et-Taberiu⁹, Ibn Atije¹⁰ dhe Sejid Kutbi¹¹, i cili mendim, ka një përkrahje të madhe të dijetarëve, sepse përputhet edhe me rrjedhën e ngjarjeve që trajtohen në këtë sure; dhe

- Çdo fitore dhe çlirim islam, që nga koha e zbritjes së kësaj sureje, ndër të cilat radhiten çlirimi i Hajberit, i Mekës, pastaj fitoret ndaj persianëve dhe romakëve, dhe të tjerat fitore që

do të pasojnë,¹² mendim ky që është përcjellë nga Aliu r.a. dhe Ibn Abasi r.a., e që sipas mendimit tonë është mendimi më i saktë, sepse përfshin një fushë më të gjerë kohore që zgjatet përtej shekujve, dhe që do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit.¹³ Këtë mendim e ka përzgjedhur edhe Ibn Ashuri, i cili në lidhje me këto fitore dhe ngadhënjime të myslimanëve, të premtuara nga Allahu i Madhërishëm, dhe pasi që cek edhe mendimet që u thanë më parë, thotë se në këtë ajet bëhet fjalë për fitore në të cilat do të fitohen plaçka të mëdha lufte, pakrahasimisht më madhështore së të gjitha këto që u përmendën, dhe që mbase vështirë se edhe mund t'i kenë imagjinuar myslimanët atëbotë, e ato ishin fitoret kundër persianëve dhe bizantinëve, e më vonë, tokat e berberëve, (në Afrikën Veriore), që nënkupton çlirimin dhe zotërimin e pasurive të atyre vendeve.¹⁴

Ky mendim i fundit i Ibn Ashurit, përputhet plotësisht edhe me mendimin e Muxhahidit, i cili thotë se: “Këto fitore janë çlirimet (futuhetet islame) dhe plaçka e luftës, deri në Ditën e Gjykimit.”¹⁵

22. Nëse jobesimtarët do t’ju shpallnin luftë, do të ishin ata që do të sprapseshin, dhe pastaj nuk do të gjenin as mbrojtës, e as ndihmës.

Ky ajet, i bën krenarë të gjithë myslimanët, sepse nëpërmjet tij, atyre u bëhet me dije se nëse idhujtarët kurejshë, do të tentonin t’ju sulmonin në Hudejbije, Allahu do t’ua mundësonte besimtarëve fitoren e qartë, pa kurrfarë dyshimi, kurse kurejshët do të ishin ata që do të sprapseshin të mundur e të turpëruar, pa pasur asnjë mundësi të gjenin ndonjë mbrojtës a përkrahës. Disa komentatorë të Kuranit kanë dhënë

Në shumë ajete kuranore Allahu e bën të qartë se Ai është dhe do të jetë gjithmonë në anën pejgamberëve dhe besimtarëve, të cilët i ka fuqizuar dhe ua ka mundësuar fitoren mbi armiqtë, pavarësisht numrit të tyre.

mendimin se ky ajet flet tërthorazi edhe për fiset arabe që ishin aleate të hebrenjve të Hajberit, fiset Esed dhe Gattafan, që edhe përkundër numrit të madh të tyre, as që kishin marrë guximin të lëviznin në drejtim të myslimanëve, kur këta po mbanin nën rrethim fortifikatat e Hajberit.¹⁶ Megjithatë, mendimi se fjala është për idhujtarët mekasë që po i pengonin myslimanët në krye më të Dërguarin e Allahut, të hynin paqësisht në Mekë për ta kryer umren, është më i pranuar.

23. I tillë ka qenë ligji i Allahut edhe më parë, e ti në ligjin e Allahut kurrë nuk do të gjesh ndryshime.

Ky është ligji i Allahut që kurrë nuk ndryshon që prej se ushtritë besimtare janë ndeshur me ushtritë e kufrit, për lartësimin e Fjalës së Allahut. I Madhërishmi e ka përcaktuar këtë si një ligj të pandryshueshëm të ekzistencës, se gjithmonë do t’i përkrahë pasuesit e së vërtetës, dhe do t’i poshtërojë pasuesit e së kotës.¹⁷ Madje, në shumë ajete kuranore e bën të qartë se Ai është dhe do të jetë gjithmonë në anën pejgamberëve dhe besimtarëve, të cilët i ka fuqizuar dhe ua ka mundësuar fitoren mbi armiqtë, pavarësisht numrit të tyre. Allahu xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: “Allahu e ka shkruar (në Levhi Mahfudh): “Unë dhe të dërguarit e Mi, patjetër do të ngadhënjëjmë” - (El-Muxhadele, 21); pastaj: “...Është detyrimi Ynë që të ndihmojmë besimtarët” - (Er-Rrum, 47) etj.¹⁸

24. Është Ai që pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, në luginën e Mekës, pasi që jua mundësoi ngadhënjimin ndaj tyre. Allahu sheh gjithçka që veproni.




Ashtu siç pamë edhe nga shkaku i zbritjes së këtij ajeti, 80 burra të armatosur nga idhujtarët kurejshë, krye në vete, ia kishin mësyre kampit të myslimanëve për t'i sulmuar, por përpjekja e tyre kishte dështuar, sepse ata ishin zënë rob nga ana e myslimanëve. Allahu i Madhërishëm, i pengoi duart e tyre që të arrinin të myslimanët për t'i dëmtuar ata, ashtu siç i pengoi edhe duart e myslimanëve që të mos përlyheshin me gjakun e atyre idhujtarëve, sepse myslimanët kishin ardhur të veshur në *ihrama* dhe në mënyrë paqësore po dëshironin të hynin në Mekë. E siç dihet, rregullat e të qenit *muhrim*, nuk lejojnë asnjë lloj gjakderdhjeje, edhe pse në kësi rrethanash lufta për vetëmbrojtje do të ishte plotësisht e justifikueshme. Allahu xh.sh., ua mundësoi myslimanëve neutralizimin e këtij grupi dhe i bëri ngadhënjimtarë ndaj tyre, duke i zënë robër, që pastaj t'i lironin pa kushte, duke treguar zemërgjerësinë dhe shpirtbardhësinë e tyre. Zaten, ky veprim i myslimanëve, d.t.th. lirimi i tyre pa kushte, do të ndikonte që shumë prej këtyre ta përqafojnë Islamin aty për aty, e fryti i këtyre sjelljeve fisnike do të shihej dy vite e gjysmë më vonë gjatë hyrjes triumfale në Mekë, të mbi dhjetëmijë myslimanëve.

Ky pengimi i duarve të idhujtarëve mekasë që të arrinin të myslimanët, sipas të gjithë komentatorëve është tjetër nga ai i theksuar në ajetin e -20të, në të cilin Allahu përmendi pengimin e njerëzve, kur myslimanët kishin marrë udhën e umres së Hudejbijes. Nga kjo kuptojmë se ajeti i 20-të, bën fjalë për pengimin e hebrenjve përreth Medinës si dhe hebrenjve të Hajberit së bashku me aleatët e tyre prej fiseve arabe, që të mos kishin mundësi t'i dëmtonin familjet e myslimanëve, ndërkohë që në këtë ajet, të 24-t, është e kuptueshme dhe e qartë se bëhet fjalë vetëm për pengimin e idhujtarëve kurejshë që të mos i dëmtonin myslimanët në Hudejbije.¹⁹

Ajeti përfundon me fjalët ku Allahu iu drejtohet besimtarëve se Ai sheh gjithçka që ju veproni, e në këtë rast edhe sjelljet tuaja fisnike karshi atyre që u zunë rob dhe pastaj u liru. Shkurt, kjo nënkupton që besimtarët duhet të jenë shembulli më i mirë i sjelljes fisnike, sepse vetëm kështu do të arrinin të "pushtonin" zemrat e njerëzve, në rrugën e shenjtë të përhapjes së Fjalës së Allahut në të katër anët e botës.

POROSIA E KËTYRE AJETEVE

- Allahu xh.sh. u ka premtuar besimtarëve të sinqertë, fitore të mëdha kundër armiqve, deri në Ditën e Gjykimit, dhe i përgëzoi paraprakisht për fitoren e parë të tyre, që do të ishte çlirimi i Hajberit dhe zotërimi i pasurive të hebrenjve të Hajberit dhe i aleatëve të tyre nga fiset arabe Esed dhe Gattafan.



- Allahu i Madhërishëm i pengoi duart e idhujtarëve mekasë ndaj myslimanëve, si në Hudejbije, po ashtu edhe në Hajber duke i bërë ngadhënjimtar ndaj tyre në çdo aspekt.

- Allahu u ka premtuar myslimanëve fitore pas fitoreje dhe çlirim pas çlirimi deri në Ditën e fundit të kësaj bote. Pas Hajberit, do të pasonte çlirimi i Mekës, pastaj mposhtja e fisit idhujtar Hevazin, në Hunejn, e më pas i përgëzoi edhe për fitore të tjera në të ardhmen e afërt, siç ishin mposhtja e dy perandorive më të fuqishme të kohës, Persisë dhe Bizantit, etj.

- Premtimi i Allahut se do t'i përkrahë besimtarët në çdo kohë kundër armiqve, është Ligj që nuk ndryshon në asnjë kohë.

- Allahu vigjilon mbi çdo gjë dhe i sheh të gjitha veprat e njerëzve. - vijon -

- 1 *Esbabu nuzuli-l Kuran*, f. 609 (rivajeti i Argjaniut); *Lubabu-n-nukuli fi esbabi-n-nuzuli*, f. 236. E transmetojnë Muslimi (5/195) nr. 1808 dhe 133; Tirmidhiu (3264); Nesaiu (8667) dhe (11510); Ebu Davudi (2688); Bejhëkiu në *Delail en-Nubuvveti* (4/141) etj.. - Isnadi i këtij hadithi është 'sahih'.
- 2 Në shumicën e rivajeteve ku përmendet numri i disa mekasve që tentuan ta sulmonin Pejgamberin a.s. në është shënuar se ishin 80, përveç Ibn Mugaffelit që përmend numrin 30. Megjithatë, mendimi i parë është më i pranuar nga ana e dijetarëve dhe biografëve. (Sqarim yni - S.B.).
- 3 *Esbabu nuzuli-l Kuran*, f. 610. E transmetojnë Ahmedi (4/86); Nesaiu (11511); Hakimi në *El-Mushtedrek* (2/460). Hadithi është i kategorisë 'sahih'; Shih edhe: Isam bin Abdulmuhsin el Humejdan, *Es-Sahih min esbabi-n-nuzul*, Kajro, 1999, ff. 292-293; *Fet'hu-rr-Rahman fi esbab nuzuli-l Kuran*, f. 130.
- 4 Imam Maturidiu, *Te'vilatu Ehli-s-Sunneti*, Istanbul, 2007, vëll. XIV, f. 32 (redaktuar nga Muhamed Ma'sum Vanlëogllu).
- 5 Ebu Bekr El-Xhezairi, *Ejseru-t-t-tefai*, Medinë, 1997, vëll. V, ff. 108-109.
- 6 *Et-Tes'hil li te'vili-t-tenzil, tefsir xhuz'u Ahkaf fi sualin ve xhevabin*, f. 250.
- 7 *Tefsiri i Kurtubiut*, IXX, vëll. f. 322. (Redaktuar nga Dr. Abdullah Turki).
- 8 Ebu Su'ud, *Irshadu-l akli-s-selim ila mezaja el Kurani-l Kerim*, Bejrut, pa vit botimi, vëll. VIII, f. 110.
- 9 Ibn Xheri et-Taberi, *Xhamiu-l bejan an te'vili aji-l Kuran*, vëll. XXI, f. 286. (Redaktuar nga Dr. Abdullah Turki).
- 10 Ibn Atijje el Endelusi, *El-Muharreru-l vexhiz fi tefsiri-l Kitabi-l Aziz*, Doha-Katar, 2007, vëll. VII (pjesa 26) f. 681.
- 11 *Fi Dhilali-l Kuran*, vëll. VI, pjesa 26, f. 3327.
- 12 Ibrahim bin Muhamed el Melisi, *Et-Tenasuk el mevduijju fi sureti-l Fet'h*, Mekë, 1434 h., f. 356.
- 13 Fahrur-r-Razi *Mefatihu-l Gajb*, vëll. XXVIII, f. 80.
- 14 *Et-Tahriru ve-t-tenviru*, vëll. 26, f. 181.
- 15 Ibn Kethir, *Tefsiru-l Kurani-l Adhim*, Rijad, 1999, vëll. 7, f. 341. (redaktor, Sami bin Muhamed es-Selame).
- 16 *Tefsir sureti-l Fet'h*, f. 118.
- 17 Imam Sha'ravi, *Havatiri havle-l Kurani-l Kerim*, f. 14404.
- 18 Ahmed bin Muhamed bin Axhibeh, *El-Bahru-l medid fi tefsiri-l Kitabi-l Mexhid*, Kajro, 2000, vëll. V, f. 399.
- 19 Shih më gjerësisht transmetimin nga Katadeja që e përcjell Taberiu në tefsirin e tij: *Xhamiu-l bejan an te'vili aji-l Kuran*, vëll. XXI, f. 282.

Mrekullitë historike të Kuranit (1)

SHKATËRRIMI I POPUJVE MOSBESUES E ARROGANTË

Mimoza Sinani

Kurani ka njoftuar për zbulime të rëndësishme shkencore, shekuj më parë, por mrekullitë e Kuranit nuk kufizohen vetëm në zhvillimet shkencore.

Ajetet e Kuranit përmbajnë edhe një numër të madh mrekullish që kanë lidhje me çështjet historike. Shumë fise, qytete, mbretër dhe luftëra janë përshkruar në Librin e Shenjtë. Për më tepër, kërkimet dhe zbulimet arkeologjike i kanë konfirmuar këto informacione që u njoftuan 14 shekuj më parë.

HAMANI DHE MONUMENTET E EGJIPTIT TË LASHTË

Një nga personat që përmenden në kontekst të Faraonit është “Hamani”. Ai përmendet në gjashtë vende të ndryshme në Kuran, në të cilat informohemi se ai ishte një nga ndihmësit më të afërt të Faraonit. Çuditërisht emri “Haman” nuk është përmendur kurrë në ato pjesë të Testamentit të Vjetër që kanë lidhje me jetën e Pejgamberit Musa. Ky informacion në Kuran mbështetet nga zbulimet arkeologjike të bëra shekuj më vonë.

Deri në shekullin e 18-të, shkrimet dhe mbishkrimet e Egjiptit të Lashtë nuk kanë mundur të kuptoheshin. Sistemi i shkrimit të Egjiptit të Lashtë përbëhej më tepër nga hieroglifët apo pikturat e stilizuara sesa nga fjalët dhe ishte harruar shekuj më parë.

Në vitin 1799, sekreti i hieroglifëve të Egjiptit të Lashtë u zgjidh nga zbulimi i një table të quajtur “Guri Roseta”, që daton në vitin 196 p.e.s.

Nëpërmjet deshifrimit të hieroglifëve, u zbulua një pjesë e rëndësishme e dijes: Emri “Haman” përmendej vërtet në mbishkrimet egjiptiane. Mbishkrimi i njëjtë tregonte gjithashtu lidhjen e afërt midis Hamanit dhe Faraonit. Në fjalorin “Njerëzit në Mbretërinë e Re”, që u përgatit duke u bazuar mbi përmbledhjen e mbishkrimeve, Hamani thuhet të jetë “drejtuesi i punëtorëve të minierave të gurit”.

Ajeti në Kuran, që përshkruan ngjarjen ku Faraoni i kërkon Hamanit të ndërtojë një kullë, është në përputhje të plotë me këtë zbulim arkeologjik: “E Faraoni tha: “O ju pari, unë nuk njoh ndonjë zot tjetër për ju pos meje, andaj ti o Haman, m’i pjek (tullat) nga dheu e më ndërto një kullë të lartë, ndoshta do të arrijë ta shoh zotin e Musait, sepse unë mendoj se vërtet ai është gënjeshtar.” (El-Kasas, 38).

Zbulimi i emrit të Hamanit në mbishkrimet e lashta egjiptiane zbulon edhe një herë se Kurani u dërgua nga Zoti. Kurani na përçon në një mënyrë të mrekullueshme informacione historike që nuk kanë qenë të mundura që të zotëroheshin apo kuptoheshin në kohën e Pejgamberit a.s..

VËSHTIRËSITË QË E MUNDUAN FARAONIN DHE ATA PËRRETH TIJ

Faraoni dhe njerëzit e tij të afërt ishin aq të devotshëm ndaj sistemit të tyre politeist dhe besimeve pagane saqë as mesazhi i Pejgamberit Musa, i pajisur me dituri dhe mrekulli të jashtëzakonshme, nuk mundi t’i

Sundimtari egjiptian, i njohur si Faraon, dhe oborri i tij i ishin përkushtuar së tepërmi sistemit të tyre politeist dhe besimeve idhujtare. Në të vërtetë, sipas besimeve të tyre të shtrembëruara, Faraoni ishte vetë hyjnia!

kthente nga supersticionet e tyre të pabaza. Ata madje e shpallën hapur këtë fakt. Për shkak të qëndrimit të tyre arrogant, Zoti u dërgoi atyre vështirësi, me qëllim që t'i ndëshkonte ata edhe në këtë botë. Kurani na rrëfen për këto: *“Atëherë (për shkak të mohimit) Ne lëshuam kundër tyre: vërshimin, karkalecat, rriqrat, bretkosat dhe gjakun, fakte të qarta njëra pas tjetrës, po ata mbanin kokëfortësi sepse ishin popull mëkatarë.”* (El-Araf, 133).

Ky njoftim kuranor për atë periudhë të historisë së njerëzimit është konfirmuar nga zbulimet e papiruseve të Ipueverit që i përkasin Mbretërisë së Mesme, në fillim të shekullit të 19-të. Hollësitë në papirus, që lidhen me katastrofat që e goditën popullin e Egjiptit, janë njëlloj me ato që përshkruhen në Kuran. “Murtaja është anembanë vendit. Gjaku është kudo... Vërtet, kjo ka shkatërruar çdo gjë të së djeshmes. Toka është lënë si copat e prera të fijeve të lirit... Egjipti i Poshtëm derdh lot... I tërë pallati është pa të ardhurat e tij... Vërtet, drithërat u prishën në çdo anë... Qytetet u shkatërruan. Egjipti i Sipërm u tha... Rezenca u përmbys brenda një minute.”

RUAJTJA E TRUPIT TË FARAONIT

Sundimtari egjiptian, i njohur si Faraon, dhe oborri i tij i ishin përkushtuar së tepërmi sistemit të tyre politeist dhe besimeve idhujtare.

Në të vërtetë, sipas besimeve të tyre të shtrembëruara, Faraoni ishte vetë hyjnia!

Në këtë kohë, Zoti e dërgoi Pejgamberin Musa (paqja qoftë mbi të) te populli i tij, por e urdhëroi që në besim të thërriste edhe Faraonin dhe popullin e Egjiptit. Megjithatë Faraoni iu përgjigj me shpifje dhe kërcënime thirrjeve të Pejgamberit Musa për t'i besuar Zotit. Ky qëndrim arrogant zgjati derisa

ai u përball me ndëshkimin e Zotit. Ai u përball me kërcënimin e vdekjes nëpërmjet përmytjes. Gjendja e Faraonit, i cili iu kthye besimit në atë moment, është përshkruar me këto fjalë në ajetin në vijim: *“Ne i kapërcyem Beni Israilët përtej detit, e Faraoni dhe ushtria e tij i ndoqi mizorisht dhe armiqësisht derisa e përfshi u atë përmbysja, e ai tha: “Besova se nuk ka zot tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilët, edhe unë jam nga myslimanët!”* (Junus, 90).

Por ky besim në minutat e fundit nuk iu pranua: *“Ti tani beson, ndërsa më parë kundërshtove dhe ishe njëri prej shkatërruesve! Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje. Vërtet, ekziston një shumicë njerëzish që nuk hulumtojnë argumentet Tona.”* (Junus, 91-92).

Informacioni se kufoma e Faraonit do të shërbente si një argument për gjeneratat e mëvonshme mund të vlerësohet si një tregues se trupi i tij nuk do të prishej. Trupi i Faraonit është në ekspozitën e Dhomës Mbretërore të Mumieve të Muzeut Egjiptian në Kajro.

Pikërisht ashtu sikurse është shpallur 14 shekuj më parë...

QYTETI I IRAMIT

Në fillim të vitit 1990, në shkretëtirën arabe jugore në Oman, u bë një zbulim i rëndësishëm arkeologjik. Gjatë gërmimeve u nxor nga dheu qyteti i Iremi “Ubar”, 4.300 vjet i moçëm. Gërmimet nën dunat e rërës zbuluan një qytet të fortifikuar oktagon, me përmasa të madha dhe me mure të trasha, dhjetë këmbë të larta dhe me tetë kulla të larta në qoshe. Arkeologët gjetën enë balte greke, romane dhe siriane, më e vjetra prej të cilave datonte më tepër se 4.000 vjet. Zbulimi i këtyre fakteve tregoi se ky qytet kishte qenë një qendër e rëndësishme tregtie, e ngjashme me Ubarin e





legjendave. Një rezultat befasues i gjurmëve ishte se Ubari kishte përjetuar një fund katastrofik, ashtu siç e përshkruajnë legjendat. Sipas legjendës, Ubari u shkatërrua gjatë një katastrofe rreth vitit 100 e.s. dhe u gropos nga rëra. Dëshmitë tregojnë se qyteti u fundos në një gropë që u krijua për shkak të shembjes së një shpelle të nëndheshme gurësh gëlqerorë. Përpjekjet e mëparshme për ta gjetur Ubarin në dunat e Omanit kishin dështuar.

Ajo që e bën këtë zbulim arkeologjik veçanërisht tërheqës ishte fakti se ky qytet ishte vendi ku kishte jetuar populli Ad, i përmendur në Kuran. Ishte Nikolas Klap, një regjisor filmash dokumentarë dhe një lektor i arkeologjisë, që e gjeti këtë qytet të përmendur në Kuran.

Duke qenë një arabofil dhe një regjisor fitues filmash dokumentarë, Klap kishte hasur një libër tepër interesant gjatë kërkimit të tij për historinë arabe. Libri përmendte Ubarin, një qytet të lashtë dhe gjurmët që i përkisnin atij. Që t'i lehtësohej puna për gjetjen e këtyre gjurmëve, Klap kërkoi ndihmë nga NASA për të siguruar imazhet satelitore të rajonit. Ai vazhdoi të studionte dorëshkrimet dhe hartat e lashta në Bibliotekën Huntington në Kaliforni. Ai gjeti aty një hartë të vizatuar nga gjeografi greko-egjiptian Ptoleme, në vitin 200, e cila tregonte vendndodhjen e një qyteti të vjetër në rajon dhe udhët të cilat të çonin drejt këtij qyteti. Përveç kësaj, gjurmët në

Ajo që e bën këtë zbulim arkeologjik veçanërisht tërheqës ishte fakti se ky qytet ishte vendi ku kishte jetuar populli Ad, i përmendur në Kuran. Ishte Nikolas Klap, një regjisor filmash dokumentarë dhe një lektor i arkeologjisë, që e gjeti këtë qytet të përmendur në Kuran.

hartë korresponduan me gjurmët në fotografite satelitore të marra nga NASA.

“A nuk e di ti se ç'bëri Zoti yt me Adin? Me banorët e Iremi me ndërtesa të larta? Që si ata nuk është krijuar askush në tokë!” (El-Fexhr, 6-8)/

Destinacioni final i këtyre gjurmëve ishte një vend i gjerë që kuptohet të ketë qenë dikur një qytet. Së fundi, u zbulua vendndodhja e këtij qyteti legjendar. Pas një periudhe të shkurtër, nisën gjurmimet dhe filluan të dalin në dritë mbetjet e një qyteti të vjetër. Ishin këto rrënoja që përbënin dëshminë reale se ky qytet i lashtë ishte qyteti i popullit Ad, të përmendur në Kuran, sepse ndërmjet strukturave të zhvarrosura gjatë gjurmëve u gjetën shtylla. Kjo ishte pikërisht ashtu siç është shpallur në ajetet kuranore.

QYTETET E SODOMËS DHE TË GOMORRËS

Pejgamberi Lut jetoi në të njëjtën kohë me pejgamberin Ibrahim (paqja qoftë mbi të dy). Ai u dërgua si pejgamber te fisi fqinj i pejgamberit Ibrahim. Ky fis, sikurse është shpallur në Kuran, praktikonte një perversion që nuk ishte parë kurrë më parë në botë: homoseksualizmin.

Kur pejgamberi Lut i tha popullit të tij që të hiqte dorë nga ky mëkat i madh, ata e kundërshtuan. Ata e mohuan dhe e refuzuan atë si pejgamber dhe vazhduan mënyrën e

tyre të turpshme të jetesës. Si pasojë e kësaj, fisi u shkatërrua nga një fatkeqësi të tmerrshme: *“Përkujto kur popullit të vet Luti i tha: ‘A punoni të shëmtuarën, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush’. Vërtet, ju të shtyrë nga epshet u afroheni burrave duke i lënë gratë. Po ju jeni popull i shfrenuar.”* (El-Araf, 80-81); *“Ne lëshuam mbi ata një lloj shiu (me gurë). E shiko se si ishte fundi i kriminelëve!”* (El-Araf, 84).

Qyteti i përmendur në Kuran, në të cilin kishte jetuar populli i Lutit dhe i cili ishte shkatërruar, u nxor në dritë gjatë gërmimeve arkeologjike të kohëve të fundit. Ky ishte qyteti i lashtë i Sodomës, sikurse quhet në Testamentin e Vjetër. Gërmimet arkeologjike kanë zbuluar se qyteti gjendet afër Detit të Vdekur, në kufirin e sotëm izraelito-jordanez. Zona është e mbuluar nga shtresa të mëdha sulfuri.

Kjo është pika më e rëndësishme e dëshmisë, sepse sulfuri është një element që shfaqet si rezultat i shpërthimeve vullkanike. Në të vërtetë, në Kuran gjendet një shenjë se mënyra e shkatërrimit ishin tërmetet dhe shpërthimet vullkanike. Arkeologu gjerman, Werner Keller për këtë rajon thotë: *“Bashkë me bazën e kësaj çarje të fuqishme, e cila kalon saktësisht përmes kësaj zone, Lugina e Sidimit, që përfshin Sodomën dhe Gomorrën, u zhyt një ditë në humnerë. Shkatërrimi i tyre ndodhi nëpërmjet një tërmeti të madh i cili, ka të ngjarë, të jetë shoqëruar me shpërthime, shkrepitima, lëshime të gazit natyror dhe flakërima të përgjithshme...”*

Në luginën e Jordanit, afër Bashanit, gjenden ende krateret e larta të vullkanëve të shuar, zgjatjet e mëdha të llavës dhe shtresat e thella të bazaltit që janë depozituar mbi sipërfaqen e gurit gëlqeror.

Këto shtresa të llavës dhe bazaltit janë dëshmia më e rëndësishme që tregon se dikur atje ka ndodhur një shpërthim vullkanik dhe tërmet. Liqeni i Lutit, i njohur ndryshe edhe si Deti i Vdekur, qëndron direkt sipër një rajoni aktiv sizmik; me fjalë të tjera, një brezi tërmetesh. E tërë hapësira në anën lindore të Detit të Vdekur, ku ndodheshin qytetet, është mbuluar me kripësira sulfurore dhe është vdekjeprurëse për botën bimorë dhe atë shtazore. Ai është vendi skenik i rrënimit të plotë, që qëndron si simbol i përhershëm e rrënimit.

POPULLI I SEBES PËRMBYTJA E ARIMIT

DHE

“Bashkë me bazën e kësaj çarje të fuqishme, e cila kalon saktësisht përmes kësaj zone, Lugina e Sidimit, që përfshin Sodomën dhe Gomorrën, u zhyt një ditë në humnerë.

Komuniteti i Sebes ishte një nga katër civilizimet më të mëdha që jetonin në Arabinë Jugore. Me ndihmën e teknologjisë së përparuar për atë periudhë të veçantë, populli i Sebes kishte ndërtuar digën Ma'rib dhe zotëronte një kapacitet ujitjeje tepër të madh. Kjo i kishte pajisur ata me pasuri dhe mallra të shumta. Por në vend që ta falënderonin Zotin për të gjitha këto, ata “u larguan nga Ai”. Përveç kësaj, ata refuzuan që t'ua vinin veshin qortimeve dhe paralajmërimeve që ua bënë atyre. Për shkak të këtyre vlerave të këqija morale, ata e merituan ndëshkimin e Zotit.

Në vitin 542, digat e tyre u shembën dhe përmbytja e Arimit i shkretoi të gjitha vendet e tyre. Vreshtat, pemishtet dhe fushat e kultivuara për qindra vjet nga populli i Sebes u shkatërruan plotësisht. Kjo përmbytje përshkruhet në Kuran: *“Populli Sebe pati një begati në vendbanimin e vet: kishin nga të dy anët kopshte, nga ana e djathtë (e luginës) dhe nga ana e majtë. Hani (u thamë) nga begatitë e Zotit tuaj dhe falënderojuni Atij. Qytet i mirë dhe Zot mëkatfalës. Po ata i kthyen shpinën, e Ne e lëshuam kundër tyre rrjedhën e pendës dhe dy kopshtet e tyre i shndërruam në dy kopshte me fruta të ithët, drunj të thatë dhe diçka pak bari të egër. Atë dënim ua dhamë atyre për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë, përveç mohuesit.”* (Sebe, 15-17).

Ky fakt, i shpallur në Kuran, është në përputhje të plotë me zbulimet arkeologjike. Arkeologu i krishter, Werner Keller, autor i librit “Bibla si histori”, pranon se përmbytja e Arimit ndodhi sipas përshkrimit të Kuranit dhe shkruan se ekzistenca e një dige të tillë dhe shkatërrimi i qytetit nëpërmjet shpërthimit të saj dëshmon vërtetësinë e shembullit të dhënë në Kuran.

LITERATURA

1. Werner Keller, *The Bible as History*, Bantam, 1983.
2. Thomas H. Maugh II, *Ubar; Fabled Lost City, Found by LA Teams*, The Los Angeles Times, 1992.
3. George Ostrogorsky, *History of the Byzantine State*, Nju Bransvik: Rutgers University Press, 1969.
4. Percy Sykes, *History of Persia*, London, Macmillan & Co Ltd, 1963.
5. Nicholas Clapp, *The Road to Ubar: Finding the Atlantis of the Sands*, Mariner Books, 2021.
6. Mustafa Mlivo, *Kurani përpara shkencës dhe civilizimit*, Dituria Islame, Prishtinë, 2008.

Ku është Allahu i Madhërishëm?

Mufti Muhamed ibën Adem el-Kevtheri el-Hanefi

Pyetja:

Si duhet të përgjigjet një mysliman nëse pyetet se ku është Allahu i Plotfuqishëm, meqë kjo çështje, brenda ymetit është një konfuzion i madh akaideor, nisur edhe nga fakti se dikush thotë se Ai është mbi Arsh, dikush mbi qiej, dikush kudo, etj., etj.?!

Përgjigja:

Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim

Çështja se “*Ku është Allahu xh.sh.?*” është diçka që kurrë nuk është debatuar ose bërë çështje diskutimi në mes myslimanëve përgjatë shekujve me radhë. Fatkeqësisht, nga shkaku i injorancës së thellë rreth fesë sonë, disa myslimanë të caktuar e shpenzojnë kohën e tyre të çmuar duke argumentuar mbi çështje të vogla e të parëndësishme, si dhe çështje që nuk duhen diskutuar për to, ndërsa i harrojnë përgjegjësitë dhe detyrat e kryesore të tyre.

Besimi (*akideja*) që dikush duhet të ketë lidhur me Zotin dhe Krijuesin e tij është se Allahu xh.sh., është Një, askush dhe asgjë

së është i ngjashëm me Të, asgjë nuk mund ta pushtojë e përshkojë Atë, nuk ka Zot tjetër përveç Tij dhe Ai është i Përjetshëm pa fillim dhe i Përherëshëm pa mbarim. Ai as që do të zhduket e as që do t'i vije fundi ndonjëherë dhe asgjë nuk mund të ndodhë pa dëshirën e Tij. Asnjë imagjinatë nuk mund ta konceptojë Atë dhe asnjë të kuptuar nuk mund ta përfshijë Atë. Ai është i ndryshëm nga çdo krijesë e krijuar prej Tij.

Allahu i Gjithëfuqishëm për Vetveten e Tij thotë: “*...Asnjë send nuk është si Ai...*” (Esh-Shura, 11); “*Dhe askush nuk i ngjason Atij.*” (El-Ihlas, 4).

Në sajë të këtyre ajeteve, si edhe ajeteve të tjera kuranore dhe teksteve të hadithit, njëri nga besimet më kryesore që një mysliman duhet të ketë lidhur me Allahun Fuqiplotë është ai se asnjë krijesë nuk është e ngjashme me të. Nëse Allahu xh.sh., konsiderohet të jetë i njëjtë ose i ngjashëm ose të ketë ndonjë cilësi të krijesave të Tij, atëherë kjo do të përbente *kufër* (mosbesim).

Nëse Allahu xh.sh., konsiderohet të jetë i njëjtë ose i ngjashëm ose të ketë ndonjë cilësi të krijesave të Tij, atëherë kjo do të përbente *kufër* (mosbesim).



Imam Ebu Hamid el-Gazali, Allahu xh.sh. e mëshiroftë, deklaroi: “*Kushdo që mendon se Allahu xh.sh., posedon trup të përbërë nga organe, atëherë ai është idhujtar ... Kushdo që adhuron një trup, konsiderohet mosbesimtar nga ixhmai (konsensusi) i të gjithë dijetarëve, pra i dijetarëve të hershëm (selefët) dhe të mëvonshëm (mute’ahirunëve).*” (Ilxhamu’l-Avam an Ilmi’l-Kelam, 6-8).

Nëse dikush beson se nuk ka asgjë të ngjashme me Allahun e Madhërishëm në asnjë aspekt, atëherë kjo *akide* është korrekte dhe nuk ka nevojë për diskutime dhe argumentime. Unë besoj se nuk ka ndonjë mysliman që vërtetë beson se Allahu xh.sh., është i ngjashëm me krijesat e Tij në çfarëdo mënyre, prandaj diskutimet dhe argumentimet duhet të shmangen. Po, nëse dikush beson se Allahu xh.sh., ka duar, këmbë, fytyrë, etj., ... pra të ngjashme me të krijesave të Tij, atëherë pa pikë dyshimi ky person do të del nga Islami.

Lidhur me pyetjen se “*Ku është Allahu, xh.sh.?*”, së pari, duhet të kihet parasysh se kjo nuk është një çështje për të cilën do të pyetemi në Ditën e Gjykimit. Ne kemi nevojë për njerëz që vërtetë mësojnë rreth gjërave themelore islame, në vend se të jepen në këto çështje që nuk iu takojnë. Ata që argumentojnë dhe shkaktajnë përçarje përmes çështjeve të tilla, pa dyshim se janë injorantë, madje edhe ndaj gjërave themelore të namazit, zekatit, haxhit, etj..



Nëse dikush do të thoshte se Allahu i Plotfuqishëm është gjithkund, atëherë kjo do të ishte gabim, meqë ‘gjithkund’ është e kufizuar dhe përfundon diku, ndërsa Allahu, xh.sh. është i pakufizuar.

Së dyti, kjo pyetje në vetvete është gabim. Ne pyesim lidhur me vendndodhjen e një personi që jeton brenda kohës dhe hapësirës. Për shembull, unë përfshihem në kohë, d.m.th., unë jetoj brenda kohës, si dhe kam një trup që ka nevojë të mbushë ca hapësirë.

Megjithatë, Allahu i Gjithëfuqishëm dhe i Lartmdhërishëm është Krijuesi i kohës dhe hapësirës. Nëse ne e kufizojmë atë me kohën dhe hapësirën, atëherë kjo do të nënkuptonte se ne po e ngjasojmë me krijesat e Tij duke i përshkruar Atij trup, meqë hapësira është e kufizuar. Nëse dikush do të thoshte se Allahu i Plotfuqishëm është gjithkund, atëherë kjo do të ishte gabim, meqë ‘gjithkund’ është e kufizuar dhe përfundon diku, ndërsa Allahu, xh.sh. është i pakufizuar.

Ngjashëm, të thuhet se Allahu xh.sh., është në tokë, qiell, hënë, diell, Arsh (Fron), etj., është po ashtu gabim, meqë këto gjëra janë të kufizuara dhe të kufizohet Allahu i Madhërishëm me ndonjë gjë të krijuar është *kufur*.

Imam Tahaviu, Allahu xh.sh. e mëshiroftë, në veprën e tij të mrekullueshme “*El-Akidetu’l-Tehavijje*” deklaroi: “*Ai (Allahu xh.sh.) është përtej të pasurit kufij në Qenien e Tij ose të qenit i kufizuar ose të pasurit pjesë (anë) a gjymtyrë.*

As që është i përfshirë nga gjashhtë drejtimet siç janë të përfshira të gjitha krijesat e Tij.” (fq. 9).

Imam Nesefiu, Allahu xh.sh. e mëshiroftë, ka deklaruar: “*Ai (Allahu xh.sh.) nuk është trup (xhism) e as atom (xhevher) e as diçka e formësuar (musavver) e as diçka e kufizuar (mahdud) e as diçka e numërueshme (ma’dud) e as diçka e ndashme ose pjesëtuar e as diçka e kombinuar (muterekkeb) e as që i vije fundi ndonjëherë. Ai nuk përshkruhet përmes esencës (el-ma’hije) ose përmes cilësisë (el-kejfijje) e as që zë vend në hapësirë (el-mekan) dhe koha (ez-zeman) nuk ndikon tek Ai. Asgjë nuk i ngjason Atij, që do të thotë, asgjë s’është si Ai.*” (shih Sa’du’d-Din et-Taftazani & Nexhmu’d-Din en-Nesefi, Sherhu’l-Akaidi’n-Nesefijje, 92-97).

Në përfundim, ne duhet të kemi besimin (*akiden*) se Allahu i Madhërishëm është i pastër nga hapësira dhe koha. Është gabim të thuhet se Ai është gjithkund dhe po ashtu është gabim të besohet se Ai është në (ose mbi) diçka, meqë gjithçka është e kufizuar, kurse Allahu xh.sh., është i pakufizuar. Megjithatë, ne duhet të besojmë se dituria e Tij përfshinë gjithçka dhe Ai di, sheh dhe dëgjon gjithçka.

E Allahu i Gjithëdijshëm e di më së miri!

Daru’l-Ifta, Leicester, UK.

Shqipëroi: Daim Abazi

Ruajtja e tërësisë së haditheve, pretendimet dhe realiteti

Dr. Muhamed Stublla

Mesazhi hyjnor është përmbyllur me Pejgamberin e fundit, Muhamedin a.s.. Atij, Zoti xh.sh., ia zbriti shpalljen përmbyllëse, për të gjitha kohërat dhe vendet, udhëzim për mbarë njerëzimin. Pasi që Zoti xh.sh. nuk do të dërgonte më pejgamberë, nevojën e dërgimit të tyre e zëvendësoi me ruajtjen e autencitetit apo origjinalitetit të shpalljes, kjo padyshim që ishte garanci hyjnore.

Shpallja hyjnore është realizuar përmes zbritjes tekstuale, fjalës së Allahut xh.sh., e shkruar në Mus'haf, dhe përmes haditheve, të shprehura në fjalë, vepra, pëlqime dhe veti të Muhamedit a.s.. Andaj, kur flasim për ruajtjen e haditheve, për qëllim kemi ruajtjen e atyre haditheve, të cilat kanë për tematikë aspektin fetar, apo janë esenciale për kuptimin e fesë. Muhamedi a.s.. ka thënë: "...ju jeni më kompetentë për çështjet e kësaj bote."¹ Duke pasur parasysh që kemi hadithe të sakta, të dobëta dhe hadithe të shpikura, këtu do të ndërhyjë vullneti i Zotit, duke krijuar rrethana të cilat do të pamundësojnë ndërhyrjen e dorës së njeriut për të shtuar apo larguar diçka nga shpallja hyjnore, e cila përbëhet nga Kurani dhe Suneti.

Sigurinë për pamundësinë e ndërhyrjes së njeriut në ndryshimin e shpalljes, e ka garantuar Zoti xh.sh. në Kuran ku thotë: *"Sigurisht, Ne e kemi zbritur shpalljen, dhe sigurisht, Ne do ta ruajmë atë."* (El-Hixhër, 9). Padyshim se në shpallje përfshihet shpallja në Kuran dhe ajo në hadithe. Allahu xh.sh. thotë: *"...Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm*

Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur, me shpresë që të meditojnë." (En-Nahël, 44); *"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij."* (En Nexhm, 3,4). Teksti është i përgjithshëm, që do të thotë se, tërë atë që e përcjell Muhamedi a.s. është shpallje. Andaj, si do të kuptohet tërësia e fesë dhe kuptimi i Kuranit pa hadithe? Si do të kuptohet numri i namazeve dhe forma e faljes së tij pa hadithe? Pa hadithe, si do të kuptohet vlerat e zekatit, i cili është kusht i Islamit? Nëse nuk mund të realizohet një obligim pa një parim, ai parim duhet të jetë obligim dhe i pandarë me të. Ky kuptim duhet të jetë sikurse preambulë apo parim i pa kontestuar. Çdo pretendim që atakon këtë parim, duhet refuzuar. Askush nuk mund të sfidojë apo thyej dëshirën, respektivisht garancinë e Zotit xh.sh., për të ruajtur shpalljen e fundit, pavarësisht a gjendet ajo në Kuran apo hadith. Sigurisht, sahabët ishin ata që përcollën Kuranin, dhe po të njëjtit i transmetuan edhe hadithet, andaj besnikëria e tyre në transmetimin e Kuranit, detyrimisht duhet të jetë edhe në transmetimin e haditheve.

Ata që gjykojnë apo pretendojnë se hadithet nuk janë ruajtur, përveçse një pjesë, e cila gjithashtu është e kontestuar, duhet të verifikojnë qëndrimet e tyre në dritën e këtyre parimeve, argumentet e të cilave janë të shumta dhe të pa kontestuara.

Pretendimi për humbjen e haditheve, bazuar në deklaratat e shumë dijetarëve, se ata

Sigurinë për pamundësinë e ndërhyrjes së njeriut në ndryshimin e shpalljes, e ka garantuar Zoti xh.sh. në Kuran ku thotë:

"Sigurisht, Ne e kemi zbritur shpalljen, dhe sigurisht, Ne do ta ruajmë atë."

(El-Hixhër, 9).

kanë ditur apo memorizuar qindra mijëra hadithe, numër i cili arrin deri në miliona, është argument i mjaftueshëm për të konstatuar humbjen e shumë haditheve, sepse këto shifra aspak nuk përputhen me numrin e haditheve në literaturën islame, numri i tërë haditheve nuk tejkalon pesëdhjetë mijë. Andaj, pas humbjes së shumicës së haditheve, detyrimisht duhet ta pranojmë vetëm Kur'anin. Këtë e shprehin, kinse me qëllim që të mos devijohet mesazhi hyjnor, 'ngase ata janë të shqetësuar për fatin e Islamit'.

Për ta kuptuar realitetin e këtij pretendimi apo "shqetësimin" e atyre që llobojnë për dobësinë e argumenteve përmes haditheve, rrjedhimisht për distancimin nga çdo gjë që vije nga Muhamedi a.s., do të sjellim dhe shpjegojmë argumentet të cilat do të shfaqin realitetin e këtyre pretendimeve. Patjetër që pyetjet e singerta janë të mirëseardhura, pavarësisht burimit të tyre, pasi që feja islame është e ndërtuar mbi parime shkencore të paluhatshme.

Dijetarët apo përfaqësuesit e shkencave islame, Zoti xh.sh. i bekoi me të arritura shkencore të pashembullta në historinë e njerëzimit. Ata, krahas sinqeritetit dhe angazhimit të tyre, memorizuan aq shumë tekste, që ndërlidhen me trashëgiminë apo burimet islame. Niveli shpirtëror dhe shkencor i atyre dijetarëve shkëlqen ndër shekuj. Patjetër që të arriturat e tyre ndër shekuj, paraqesin krenarinë e besimtarëve me të kaluarën e tyre, njëkohësisht, me dëshirën e Zotit, ata ishin

Kur t'i numërojmë fjalët, veprat, pëlqimet dhe cilësitë e Muhamedit a.s.; fjalët, gjykimet, mendimet e dijetarëve të përcjella nga njëqind e katërm-bëdhjetë mijë sahabë, por edhe fjalët e tabiinëve, do të kuptohet se si tërësi numri kaq i madh i haditheve është real dhe i logjikshëm.

akterë të realizimit të premtimit të Zotit xh.sh. për ruajtjen e shpalljes.

Imam Buhariu ka thënë: "Kam të memorizuara njëqind mijë (100.000) hadithe të sakta, dhe dyqind mijë (200.000) hadithe të pasakta."² Imam Muslimi ka thënë: "Librin *Sahih* e kam përzgjedhur nga treqind mijë (300.000) hadithe."³ Është transmetuar se Imam Ahmed ibën Hanbeli ka memorizuar një milion hadithe.⁴ Këto dhe shumë tekste të tjera janë dëshmi të qarta për numrin e madh të haditheve që kanë qenë në mendjen dhe zemrën e shumë dijetarëve.

Elementi apo parimi qenësor, për të kuptuar se çfarë synohet me numrin e haditheve që i kanë ditur apo memorizuar dijetarët dhe numrit të teksteve të hadithit që janë në dispozicionin tonë, është të kuptuarit e përdorimit të fjalës "hadith".

Në mendjen e besimtarëve, me fjalën hadith, përgjithësisht synohet apo vije ndër dije se për qëllim është definicioni terminologjik i hadithit, se çdo gjë që i atribuohet Muhamedit a.s. quhet hadith. Termi hadith përdoret edhe për tekstet që transmetohen nga sahabët, shokët e Pejgamberit a.s., ndërsa në terminologjinë e shkencës së hadithit quhet *hadith mevkuf*. Por, edhe tekstet e transmetuara nga tabiinët quhen hadithe, ndërsa në precizitetin shkencor të hadithit, quhen *hadith maktu*. Andaj, çdo tekst që vije nga Pejgamberi a.s., sahabët dhe tabiinët, në fushën e transmetimeve, dijetarët i quanin hadithe. Përdorimi i fjalës hadith, zakonisht



përdoret në këtë kuptim, përveç nëse pasohet me fjalën vijuese, si: merfu, mevkuf apo maktu etj.. Imam Ahmed ibën Hanbeli ka thënë: “Është vërtetuar saktësia e shtatëqind mijë e ca haditheve.” Në lidhje me këtë, Imam Bejhakui thotë: “Për qëllim janë transmetimet e sakta prej haditheve nga Muhamedi a.s., fjalëve të sahabëve dhe tabiinëve.”⁵

Nëse shfletojmë literaturën e gjeneratave të para, do të gjejmë shumë transmetime nga sahabët dhe tabiinët, të cilat i kanë quajtur hadithe. Imam Muhamed ibën el Hasan esh-Shejbani, në librin e tij, “*El Huxheh Ala Ehl-il Medineh*”, ka thënë: “Ka ardhur në hadith nga Ali ibën Ebi Talibi, i cili ka thënë: “Vdekja është borxhliu më i pa dëshiruar.”⁶ Fjala e sahabiut, në këtë rast e Aliut r.a. është quajtur hadith. Pas përshkrimit të një pjese të formës së namazit të frikës, nga Imam Ibrahim en-Nahiu, përfundon përshkrimi i transmetimit duke thënë: “Vazhdon teksti i hadithit...”⁷ Imam Ibrahim en-Nahiu është tabiin, ka lindur në vitin 47 h. dhe ka vdekur në vitin 96 h.⁸ Fjalën apo qëndrimin e tij, Imam Muhamedi e quan hadith.

Kur t'i numërojmë fjalët, veprat, pëlqimet dhe cilësitë e Muhamedit a.s.; fjalët, gjykimet, mendimet e dijetarëve të përcjella nga njëqind e katërmëdhjetë mijë sahabë, por edhe fjalët e tabiinëve, do të kuptohet se si tërësi numri kaq i madh i haditheve është real dhe i logjikshëm..

Në numërimin e këtyre haditheve merret në konsideratë çdo ndryshim në zinxhirin e transmetimit. Nëse një transmetues ndryshon, do të numërohet një hadith më shumë. Dijetarët e hadithit nuk kanë numëruar hadithet vetëm për nga teksti (metni) i hadithit, por për çdo ndryshim në zinxhir të transmetimit, kanë llogaritur hadith të veçantë.

Këtë do ta ilustrojmë me hadithin vijues: “Veprat shpërblehen sipas njetit...”⁹, versionin e njohur e transmeton Omeri r.a., prej tij Alkameh ibën Vekasi, nga ky Ibrahim et Tejmiu, prej të cilit transmeton Jahja ibën Said ... deri këtu numërohet një hadith, nëse në një transmetim tjetër nga të njëjtit transmetues hasim në ndonjë ndryshim në tekst (metën), numërohet hadith i ndarë nga ai paraprak. Ebu Ismail el Ensari el-Heraviju ka thënë: “Këtë hadith e kanë transmetuar nga Jahja ibën Seidit shtatëqind nxënës të tij, dhe numërohen shtatëqind hadithe. Kur kemi parasysh që në numërimin e haditheve përfshihet çdo rrugë e transmetuar, e cila ndryshon me ndryshimin e transmetuesve, kuptojmë se sa shumë janë hadithet nga Pejgamberi a.s., sahabët dhe tabiinët. Numërimi bëhet për çdo ndryshim në zinxhir të transmetimit dhe të metnit. Saktësia e tyre është fazë tjetër. Imam El-Xhevezeki ka thënë: “Kam numëruar hadithet dhe

Mos shkrimi i disa haditheve, kuptimi i të cilave është i ngjashëm, nuk do të thotë se ka humbur apo munguar diçka nga feja.

rrugët e tyre në sahihun e Buhariut dhe Muslimit, dhe kam gjetur rreth njëzetë e pesë mijë hadithe (25.000).¹⁰ Kushtet e këtyre autorëve në librat e tyre janë të nivelit të lartë, megjithatë përmes ndryshimeve të rrugëve të transmetimit arrin shifrën (25.000). Ndërsa numri i teksteve (mutuneve), përafërsisht është rreth dhjetë mijë (10.000). Nëse numërohen të gjitha hadithet në tërë literaturën islame, sa do të jetë totali i numrit të tyre? Megjithatë, numri i teksteve të transmetimit mbetet i kufizuar, kjo për shkak se objektivë e transmetimeve ishin hadithet bazike të rregullave apo normave fetare.

Fillimisht duhet të konstatojmë se, të gjitha hadithet të cilat janë të nevojshme që feja në tërësinë e saj të jetë e plotësuar, janë transmetuar dhe ekzistojnë edhe sot. Përndryshe do të përgënjeshtrojmë ajetin që Zoti xh.sh.

ka siguruar se e ka plotësuar dhe garantuar këtë fe, konkretisht shpalljen përfundimtare.

Dijetarët kanë shkruar hadithet kryesore në çdo temë. Zakonisht kanë shkruar dy apo tri hadithe, të cilat janë më kuptimplote në çështjen përkatëse. Imam Ebu Davudi ka thënë: “I kam shkruar pesëqind mijë (500.000) hadithe, por i kam përzgjedhur vetëm ato që janë në librin, “*Es Sunen*”.”¹¹ Suneni i Imam Ebu Davudit konsiderohet njëri ndër librat më përmbledhës dhe më i lehtë për nxjerrjen e normave. Sikurse Ebu Davudi, vepruan thuajse të gjithë dijetarët islam. Duke transmetuar hadithet më të sakta dhe përmbledhëse të secilës temë, realizohej një element tjetër i rëndësishëm, shkurtimi apo kujdesi që numri i haditheve të mos jenë voluminozë, në mënyrë që hadithet të mësohen sa më lehtë, respektivisht, të mos vështirësohet kuptimi i fesë.

Vëmendje: Mos shkrimi i disa haditheve, kuptimi i të cilave është i ngjashëm, nuk do të thotë se ka humbur apo munguar diçka nga feja. Me anulimin e disa ajeteve të Kuranit, nuk do të thotë që Kurani nuk është i plotë. Ngjashëm sikurse që Muhamedi a.s. ka ftuar shumë njerëz që ta besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, por vetëm disa nga ato versione janë përshkruar në literaturën islame, sepse ishte e panevojshme shkrimi i të gjitha rasteve të ftesave të tij për në Islam. Ndër argumentet kryesore për shkrimin e haditheve dhe saktësinë e koleksioneve veçojmë: Në literaturën e jurisprudencës islame, gjatë argumentimit gjejmë të gjitha hadithet që janë referencë për argumentim, ndërsa, shprehja apo teksti mund të jetë në versione të ndryshme, pasi që kuptimi i tekstit është objektivë e juristëve.¹² Prandaj, shumica e haditheve janë transmetuar kuptimisht. Situatë e ngjashme është në literaturën e historisë islame, tefsirit, akaidit etj.. Sigurisht rregullat apo kushtet e transmetimit nuk janë të



ngjashme me të muhadithëve. Ata fokusin e kanë në fushat përkatëse. Këto janë argumente për saktësinë e haditheve në librat e hadithit, që për tematikë kanë temat e këtyre fushave, të cilat i transmetuan dijetarët e tyre.

Vlen të potencohet se saktësinë e literaturës së hadithit, e vërtetojnë edhe dijetarët e mëvonshëm të po të njëjtës shkencë. Disa nga dijetarët shkruan hadithe të cilat paraprakisht i kanë transmetuar disa dijetarë në koleksionet e tyre, por përmes rrugëve (senedëve) të tyre, duke mos përmendur në zinxhirin e transmetimit autorin e librit, hadithet e të cilit autor i transmeton përmes rrugës apo zinxhirit personal të transmetimit, duke u takuar me ndonjë nga transmetuesit e haditheve të autorit të atij libri. Kjo tregon për saktësinë e atyre koleksioneve, për numrin e haditheve, respektivisht transmetuesve, si dhe për fleksibilitetin e shprehjeve në tekstet e tyre. Këto libra quhen “*El Mustahrexhat*”¹³. Kemi shumë El Mustahrexhat të njohura, si p.sh.:

- *Mustahrexhi i Ebu Avames*, - Jakup ibën Is’hak el-Isfraini (316 h.), botuar nga shtëpia botuese “El Mearifeh” në Bejrut, 1998, dhe nga “El Xhamia El Islamië” në Arabinë Saudite, në këtë “*El Mustahrexh*” transmetohen hadithet e Imam Muslimit në Sahihun e tij dhe gjenden (11882) hadithe.

- *Mustahrexhi i Imam Ebu Nuajmit* ndaj Sahihut të Muslimit, - Ahmed ibën Abdullah en-Nejsaburit, Liban, botoi: “El Kutub El Ilmië”, 1996. Ky botim përmban (3516) hadithe.

Ndërsa El Mustedrekatet janë libra të cilat transmetojnë hadithet sipas kushteve të autorit të ndonjë libri paraprak, në to gjenden hadithe të cilat transmetohen në ndonjë libër të caktuar të hadithit, duke i zbatuar kushtet apo rregullat të cilat autori i atij librit ka vendosur që t’i zbatojë në librin e tij, dhe të cilat nuk i ka sjell autori, edhe pse ato hadithe i plotësojnë rregullat apo parimet e tyre,¹⁴ si p.sh.: “*El Mustedrek ala es-Sahihajn*”, i Imam el-Hakimit, Ebu Abdullah, Muhamed iben Abdullah ibën Muhamed en-Nejsaburi, i botuar disa herë, dhe përmban rreth (8800) hadithe. Secili hadith konsiderohet hadith i ndarë nga të tjerët, përderisa në rrugën transmetuese ndryshojnë transmetuesit. Sikurse hapësira e shpjegimit të ishte e mjaftueshme, do të shpjegonim dhe argumentonim me shembuj praktikë. Por, nga kjo që paraqitem, do të kuptojmë mrekullinë e ruajtjes së shpalljes, konkretisht, hadithit.

1 Muslim, ibën El Haxhaxh en-Nejsaburi, *Sahih Muslim*, (Bejrut, Dar Ihja Et Turath El Arabij) vëll.4, faq. 6381, nr. 3632.

2 El Begavij, Ebu Muhamed, el Husejn ibën Mesud ibën Muhamed ibën el-Ferra, *Mesabih Es Suneh*, (Liban, Bejrut: Dar El Marifeh Litibaë ve En Nesher ve Et Tvziaë, 1987), vëll.1, faq.60.

3 Ebu El Abas, Ahmed ibën Tahir ed-Dani, *El Imeu Ila Atrah Ehadih Kiteb El Muvata*, recenoi Ebu Abdulbari, Rida Ebu Shameh el-Xhezairi, (Saudi, Riad: Mektebetu El Mearif li En Nesher ve Et Tevziu, 2003), vëll.1, fq. 263.

4 El Makdisij, Ali ibën el Mufadal ibën Ali ibën Muferrixh, *El Errbaine El Muratebetun Ala Tabekat El Errbai*, recenoi: Muhamed Salim ibën Muhamed el-Abadi, (Saudi, Riad: Dar Edvau Es Selef li En Nesher ve Et Tevzië 1414 h), vëll.1, fq. 256.

5 Ebu Zurah err-Rrazi, Ubejdullah ibën Abdulkerim ibën Jezid, *Ed Duafe Li Ebi Zurah fi Exhvibetih Ala Esileti El Berdhij*, punoi temë shkencore në këtë libër, Sadij Mehdi el-Hashim, (Saudi, Medineh El Muneverah: Amedetu El Bahth el Ilmij Bilxhamia el Islamië, 1982), vëll. 1, fq. 207.

6 Esh Shejbani, Ebu Abdullah, Muhamed ibën el Hasan ibën Ferkad, *El Huxheh Ala Ehl El Medineh*, recenoi, Mehdi Hasan el Kejlani el-Kadirij, (Bejrut: Dar Alim El Kutub, 1403), vëll.2, faq.716.

7 Referenca paraprake, vëll.1, fq. 344.

8 Ibën Sead, Muhamed ibën Sead ibën Muniaë, *Et Tabekat El Kubra*, recenoi: Muhamed Abdulkader Ata, (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmië, 1990), vëll.6, fq. 291.

9 El Buhari, Muhamed bin Ismail, *Sahih El Buari*, (Dar Tuk En Nexhah, 1422 h.) Vëll.1, faq.6, nr. 1.

10 El Iraki, Zejnudin Abdurrahim ibën el-Hasan, *Sherh Et Tebsiratu Et Tedhkirah -Elfjetu El Iraki*, (Bejrut, Dar El Kutub El Ilmijeh), vëll. 1, fq. 297.

11 Sadruddin el-Bekri, El Hasan ibën Muhamed ibën Muhamed ibën Amruk, *El Errbain min El Errbain an El Errbain*, recenoi: Muhamed Mahafudh, (Tunis: Dar El Garb El Islami) vëll.1, fq.62.

12 Ibën Rexheb, Zejnudin Abdurrahman ibën Ahmed bin Rexheb ibën el-Hasen, *Sherh Ilal Et Termidhij*, recenoi dr. Hemam Abdurrahman Seid, (Jordan, Mektebetu El Menar Ez Zerka 1987), vëll.1, fq.188.

13 Ez Zerkeshij, Bedrudin Muhamed ibën Abdullah, *En Nuket Ala Mukadimet Iben Es Salah*, recenoi dr. Zejnulabidin ibën Muhamed, (Arabia Saudite, Riad: Edva Es Sele, 1998), vëll.1, fq.229.

14 Ibën Es Salah, Utham ibën Abdurrahman, *Marifetu Envaë Ulum El Hadih*, recenoi: Abulatif el Hemim dhe Mahir Jasin el Fahel, (Bejrut: Dar El Kutub El Ilmië, 2002), vëll.1, fq.88.

Koncepti i drejtësisë sociale në mendimin bashkëkohor islam

Fitim Flugaj

Drejtësia është bazamenti mbi të cilin duhet ndërtuar një shoqëri e mirëfilltë, mirëpo, shpeshherë ndodh që për disa të ashtuquajtur intelektualë, nuk është qartë i dallueshëm termi drejtësi me termin barazi. Barazia sociale është koncept shumë më i ngushtë dhe ka të bëjë vetëm me nivelin e të drejtave të barabarta në rrafshin e lirisë së veprimit dhe pjesëmarrjes së barabartë në sferën politike dhe administrative, pa dallim gjinie, siç është rasti me ideologjinë komuniste dhe sistemin socialist. Një gjë e tillë mbetet koncept i ngushtë. Drejtësia në shoqëri ose siç njihet me termin drejtësia sociale, është një koncept më i gjerë dhe kërkon qasje më serioze. Edhe në shoqërinë tonë shqiptare, po në veçanti këtu te ne në Kosovë, partitë e ndryshme që synojnë pushtetin dhe qeverisjen e vendit, sidomos ato të krahut të majtë, vazhdojnë të këmbëjnë akuzat në mes tyre se kanë neglizhuar në arritjen e drejtësisë sociale, janë korruptuar dhe kanë akuzat të ndryshme për dukuritë negative të cilat në fakt bien ndesh me drejtësinë dhe janë kundërshtarë dhe shkatërrues të drejtësisë sociale. Në fakt, drejtësia sociale është koncept shumë i gjerë dhe kërkon shumë mund për të arritur që të jetë prezentë në shoqëri. Edhe po u realizua, ajo mund të realizohet pjesërisht nëse nuk bazohet mbi themelet e mirëfillta. Drejtësia sociale e mirëfilltë, në të vërtetë, erdhi nëpërmjet shariatit islam. Erdhi për të arritur qëllimet dhe objektivat, dhe për të sjellë interesa të mirëfillta larg çdo manipulimi e keqtrajtimit. Ajo erdhi për të shmangur të keqen dhe dëmtuesit me qëllim që të arrihet lumturia për të gjithë njerëzimin në këtë dhe në botën tjetër.

Ligji i shariatit nuk e humbi përqendrimin për të adresuar të gjitha aspektet e jetës së njerëzve, përfshirë edhe raportet midis

shoqërisë dhe ekonomisë, ligji islam ka përcaktuar rregulla, themele dhe metodologji të qartë në ekonomi dhe shoqëri, që sigurojnë drejtësi ekonomike dhe sociale në shoqëritë islame. Në këtë artikull do të flasim për konceptin e drejtësisë shoqërore dhe shtyllat e saj.

Koncepti i drejtësisë shoqërore rrjedh nga drejtësia e përgjithshme, e cila është ndryshe nga padrejtësia.

Drejtësia sociale është një qasje etike-morale dhe e përshkruar me dispozita ligjore, të cilat sigurojnë që njerëzit të cilët nëse i zbatojnë dhe nuk u përmbahen atyre ligjeve, mund ta arrijnë barazinë para ligjit, pra mund ta arrijnë barazinë ose drejtësinë sociale.

THEMELET E DREJTËSISË SHOQËRORE NË ISLAM

Nuk ka dyshim se ekziston një qasje e qartë në Islam për të siguruar drejtësi shoqërore në mesin e njerëzve, dhe më e spikatura nga kjo qasje që siguron drejtësi është konfirmimi i barazisë ndërmjet njerëzve në të drejta dhe detyra e obligime.

Të gjithë myslimanët përpara ligjit apo shariatit islam janë të barabartë, nuk kanë dallim e as nuk kanë përparësi të pasurit ndaj të varfërve, apo të fortët ndaj të dobëtëve, dhe as nuk ka fuqi dhe ndikim autoriteti mbi ata që nuk kanë autoritet, sepse kriteri i diferencimit në ligj është vetëm devotshmëria, dhe se bindja në këtë besim largon dallimet shoqërore midis njerëzve dhe arrihet drejtësi midis tyre.

Zekati është një detyrë që Allahu e ka caktuar si një e drejtë e njohur për të varfrit dhe nevojtarët në pasurinë e të pasurve. Sigurimi i të drejtave të individit në shoqëri, e drejta e individit në fenë islame është e ruajtur

Të gjithë myslimanët përpara ligjit apo shariatit islam janë të barabartë, nuk kanë dallim e as nuk kanë përparësi të pasurit ndaj të varfërve, apo të fortët ndaj të dobëtëve, dhe as nuk ka fuqi dhe ndikim autoriteti mbi ata që nuk kanë autoritet, sepse kriteri i diferencimit në ligj është vetëm devotshmëria



që kur ai është në fetus, në barkun e nënës së tij. Pra, ligji islam përfshinë shumë dispozita që kanë të bëjnë me të drejtat e tilla individuale, për shembull, trashëgimia dhe dispozitat e detyrueshme, alimonia, vakëfi dhe testamentet dhe shumë dispozita të tjera.

DIJETARËT MYSLIMANË QË ADRESOJNË DREJTËSINË SOCIALE

Një numër studiuesish dhe mendimtarësh janë marrë me çështjen e drejtësisë sociale në Islam. Një nga mendimtarët që trajtuan këtë çështje dhe që u përqendrua jashtëzakonisht shumë është Sejjid Kutbi, autori i librit *“Drejtësia shoqërore (sociale) në Islam”*. Ai në të foli për barazinë njerëzore dhe solidaritetin shoqëror, si dhe për metodat e arritjes së drejtësisë sociale përmes vetë-censurës gjatë zbatimit të dispozitave të ligjit islam në jetën private të secilit besimtar e besimtare.

DREJTËSIA SOCIALE

Shumë kombe dhe civilizime kërkojnë të mbështesin vlerat dhe ideat e tyre përmes aplikimit të një sistemi etik, të bazuar në arritjen e drejtësisë shoqërore midis njerëzve. Drejtësia sociale është një koncept gjithëpërfshirës për shumë aspekte të jetës së njerëzve, dhe aplikimi i këtij koncepti në shoqëri do të arrinte drejtësi dhe barazi midis njerëzve.

KONCEPTI I DREJTËSISË SHOQËRORE

Koncepti i drejtësisë sociale nënkupton aplikimin e një sistemi politikash dhe procedurash që u garantojnë të gjithë njerëzve qasje në të drejtat e tyre në baza të barabarta me të tjerët, pa favorizimin e një personi me autoritet, fuqi ose ndikim. Drejtësia sociale i referohet të drejtës së çdo qytetari në shtet për të marrë pjesën e tij që i takon. Edhe gjinia femërore pa dallim nga ajo mashkullore, ka të drejtë të shprehë mendimin e saj lirshëm dhe të marrë pjesë në

veprime shoqërore dhe politike, në mundësi të barabarta për të gjithë njerëzit dhe të heqë dallimet sociale dhe ekonomike midis tyre në mënyrë që ata të jenë të barabartë në të drejta dhe obligime.

Koncepti i drejtësisë shoqërore në Perëndim është debatuar gjerësisht nga studiuesit perëndimorë. Ata kanë pasur pikëpamjet e tyre për këtë çështje, përfshirë filozofin liberal, John Rawls, i cili konsideroi se ideja e drejtësisë sociale është një ide intelektuale filozofike e bazuar në një seri perceptimesh dhe teorish larg politikës. Idetë e tij ishin të bazuara në idetë e Jeremy Bentham, John Stewart Mill dhe filozofit Emanuel Kant, dhe idetë dhe teoritë e tyre u përkthyen në kërkesat e partive të gjelbra në shumë vende të botës, ku ata u përqendruan në vendosjen e parimit të barazisë mes njerëzve, dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Perëndimi ka arritur deri te koncepti i drejtësisë sociale dhe ka realizuar mjaft mirë një gjë të tillë, kryesisht e ka arritur një drejtësi sociale edhe përkundër asaj se këto shtete kryesisht janë kapitaliste dhe monarkiste. Por, natyrisht gjejmë se në shumë prej vendeve të tyre është arritur relativisht. Mirëpo ky koncept mbetet i zhvilluar mirë në rastin e shoqërive në vendet në zhvillim.

Koncepti i drejtësisë shoqërore në Islam

Islami merret me çështjen e arritjes së drejtësisë sociale përmes një sistemi gjithëpërfshirës të integruar në të gjitha aspektet e jetës së njerëzve, bazuar në shpalljen hyjnore, siç bazohet e drejta ose sheriatu islam. Islami thekson parimin e të drejtave pjesëmarrëse dhe të barabarta, duke theksuar partneritetin e njerëzve në burimet më të rëndësishme, siç janë: mjedisi, uji, ajri, kullotat dhe zjarri. Ai gjithashtu legjitimon aktet e dhurimit, siç janë: zekati, bamirësia dhe rregullon çështje të tilla si premtime, dëbime dhe vakëfe që garantojnë shoqërinë islamike të jetojë sipas standardeve më të larta të drejtësisë shoqërore dhe Islamit, apo siç njihet në disa qarqe, monopoli i dëmtuar.

DREJTËSIA NË ISLAM

Islam është i prirë të krijojë një shoqëri të dashurisë, kohezionit dhe ndërvlerësive, dhe për ta arritur këtë, ka organizuar marrëdhënie shoqërore që lidhin anëtarët e komunitetit myslimanë në bazë të drejtësisë, e cila kontrollon manifestimet e marrëdhënieve dhe sjelljeve midis të gjithë anëtarëve të komunitetit myslimanë, pavarësisht fesë apo besimit të tyre. Drejtësia përcaktohet si tërësi për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Të gjithë duhet t'i gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e obligimet e tyre, pavarësisht nga feja, raca, ngjyra apo statusi i tyre shoqëror. Drejtësia në Islam nuk zbatohet vetëm për myslimanët, por është bërë për të gjithë anëtarët e shoqërisë, pa marrë parasysh besimet e tyre.

MANIFESTIMET E DREJTËSISË NË QEVERISJE SIPAS KONCEPTIT ISLAM

- Miratimi i një politike të drejtë në fusha të ndryshme të qeverisjes dhe në mënyra të ndryshme jetese.
- Sistemi familjar, planifikimi i familjes në bazë të drejtësisë në marrëdhëniet që rregullojnë marrëdhëniet e bashkëshortëve me njëri-tjetrin, dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijët e tyre brenda sistemit të të drejtave dhe detyrave e obligimeve që përfaqësojnë karakterin dallues të familjes myslimane.
- Marrëdhëniet publike me njerëzit, qoftë në marrëdhëniet e myslimanëve me njëri-tjetrin, qoftë në marrëdhëniet e tyre me të tjerët.
- Drejtësi në transaksionet financiare: të gjitha llojet dhe format; shitja, blerja, qiraja dhe hipoteka.
- Drejtësia në punësim dhe punësimi dhe drejtësia në kriteret e shpërndarjes së pasurisë.

STANDARDET E DREJTËSISË SOCIALE NË ISLAM

Emancipimi absolut emocional kërkon jo shtrëngim në fe dhe liri të fesë dhe besimit. Islami ka punuar për të hequr pengesat që parandalojnë thirrjet njerëzore në sens të përbashkët. Në fushën e të drejtave dhe detyrave, të gjithë njerëzit janë të barabartë në këtë, duke përfshirë barazinë para ligjit. Edhe i Dërguari i Allahut a.s., nënvizoi shembujt më të mrekullueshëm të kësaj kur ai tha: *“Mirëpo, ju e dini se janë shkatërruar popuj para jush. Ata e lironin një person autoritativ nëse ai vidhte, e nëse vidhte ndonjëri që ishte i dobët (i varfër dhe jo autoritativ) e dënonin me vdekje. Pasha Atë në duart e të Cilit është jeta e Muhamedit, nëse Fatimeja, e bija e Muhamedit, vodhi do t'ia prej dorën e saj.”* (Sahihu i Buhariut). Po ashtu gjejmë shprehjen më të mirë të Omer bin el-Hatabit, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur ai e qortoi Amër ibën Asin dhe djalit e tij, shkaku i fyerjes së një kopti (egjiptian i krishterë) nga ana e djalit të tij dhe i kërkoi atij që të marrë hakun nga Amr ibën Asi dhe djalit e tij pa pasur frikë. Omeri,

Allahu qoftë i kënaqur me të, duke komentuar këtë ngjarje tha: *“Me çfarë të drejte ju i skllavëroni njerëzit kur dihet se nënat e tyre i lindën të lirë?”*

RËNDËSIA E DREJTËSISË NË ISLAM

Një nga faktorët më të rëndësishëm të përhapjes së shpejtë të Islamit, është organizimi i marrëdhënieve të bazuara në drejtësi, barazi dhe moral të lartë. Ne zbulojmë se vendet kanë hyrë në Islam pa luftuar, por vetëm nga etika e tregtarëve myslimanë në transaksionet e tyre të bazuara në drejtësi dhe barazi, ndershmëri, mëshirë e sinqeritet. Nëse shikojmë veprimet e disa individëve dhe grupeve të lidhur me Islamin sot, zbulojmë se ata individ dhe ato grupe japin një imazh të neveritshëm për Islamin.

Konstatimi se shoqëritë që kanë një barazi dhe drejtësi më të qëndrueshme janë më të mira duket i shëndoshë. Në këto shoqëri, ekonomitë funksionojnë në mënyrën më të mirë, sistemi arsimor është më efikas, mesatarisht, njerëzit janë më të shëndetshëm, jetojnë më gjatë dhe janë më të kënaqur me mundësitë e tyre në jetë. Prandaj, krijimi i një shoqërie me premisa të larta të një barazie të kënaqshme sociale, krijon mundësi që të krijohet një shtet më stabil dhe më i zhvilluar. Koncepti për të krijuar një shoqëri të barabartë, do të thotë që të ketë qasje të barabartë në arsim, paga të barabarta dhe sigurim social. Në këto shoqëri, diskriminimi i cilitdo lloj qoftë, është krejtësisht larg dhe nuk ka vend, korrupsioni është minimal dhe shumë dukuri të tjera negative nuk gjejnë hapësirë për zhvillim.

Në fund fare, pabarazia nga pikëpamja sociale është një diferencë në qasje të burimeve sociale, të rralla dhe me vlerë, duke e kuptuar në kuptimin më të gjerë, përfshirjen e të gjitha mundësive të veprimit të njeriut, qofshin ato politike, ekonomike, kulturore, sociale, etj.. Pabarazitë sociale, pra, janë rezultat i një shpërndarje të pabarabartë të burimeve brenda një shoqërie.

Pabarazitë janë qasje e gabuar në shpërndarjen e burimeve dhe të mirave të një shoqërie, që rrjedhë si pasojë e bindjeve dhe koncepteve të gabuara ndaj drejtësisë, shoqërisë, pasurisë etj.. Në të vërtetë, qasja e pabarabartë në burimet me vlerë shoqërore shpërndanë individët në grupe të ndryshme sociale sipas interesave individuale, grupe e klanore.

Literatura e shfrytëzuar:

1. العدالة الاجتماعية في الإسلام .. سيد قطب دار الشروق القاهرة 9031 • 9891 م
2. Happiness and Utility: Jeremy Bentham's Equation J. H. BURNS , Cambridge University Press Utilitas Vol. 17, No. 1, March 2005 Printed in the United Kingdom
3. A THEORY OF JUSTICE Revised Edition JOHN RAWLS the belknap press of harvard university press cambridge, massachusetts
4. Utilitarianism John Stuart Mill 1863 Batoche Books Kitchener 2001
5. Sahihu i Buhariut
6. <https://www.fes-skopje.org/al/temat/barazia-dhe-drejtesia-sociale/>
7. https://sq.wikipedia.org/wiki/Pabarazia_sociale

Gjuetia dhe normat e saj në të drejtën islame

Dr. Flamur Sofiu

Allahu i Lartësuar të gjitha begatitë që i ka krijuar në këtë univers i ka nënshtruar për njeriun që t'i shfrytëzoj, por në të njëjtën kohë ka përcaktuar mënyrat dhe rregullat e shfrytëzimit.

HYRJE

Gjuetia konsiderohet prej llojeve dhe mënyrave të fitimit, e të cilën mënyrë, Allahu i Lartësuar ia ka lehtësuar dhe mundësuar njeriut që të ushqehet prej krijesave të Tij. Në të drejtën islame janë përcaktuar normat dhe rregullat që kanë të bëjnë në përgjithësi me gjuetinë.

Për shkak të rëndësisë së njohjes së rregullave që kanë të bëjnë me gjuetinë, juristët myslimanë klasikë dhe bashkëkohorë, kanë shkruar libra dhe punime të shumta shkencore rreth gjuetisë. Nëse i shikojmë dhe analizojmë librat e jurisprudencës islame shohim se që të gjithë dijetarët kanë vendosur kapituj të veçantë që kanë shpjeguar rregullat dhe normat e gjuetisë.

Pa dyshim se Allahu i Lartësuar të gjitha begatitë që i ka krijuar në këtë univers i ka nënshtruar për njeriun që t'i shfrytëzoj, por në të njëjtën kohë ka përcaktuar mënyrat dhe rregullat e shfrytëzimit. Allahu i Lartësuar në mënyrë shumë të qartë ka thënë: "A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyese dhe pa libër ndriçues."¹

KUPTIMI ETIMOLOGJIK DHE TERMINOLOGJIK I GJUEISË

Gjuetia që në gjuhën arabe njihet si (الصيد) e që në kuptimin etimologjik d.m.th. të marrësh, ndërsa në kuptimin terminologjik nënkuptohet gjuetia. Gjuetia sipas sheriatit është: "Të gjuajturit e shtazës së egër e cila

është *hallall* për t'u ngrënë, dhe e cila gjallesë nuk mund të zihet-kapet ndryshe (përveç se më gjueti)"². Po ashtu gjuetia është lejuar edhe për ato shtazë të cilat nuk hahen,³ por mund të ketë dobi të tjera prej tyre, si f.v. leshti, dhëmbi, lëkura etj.

NORMA E GJUEISË

Gjuetia është e lejuar-*hallall* sipas Sheriatit me pajtueshmërinë e të gjithëve,⁴ kur për këtë ka mbështetje në Kuran, Sunet dhe *ixhma*. Si f.v. ajetet: "... e kur të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni..."⁵ "...thuj: "U janë të lejuara të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuar që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu..."⁶ "U është lejuar juve gjahu në det dhe ushqimi i tij, begati për ju dhe për udhëtarët..."⁷.

Si argument se gjuetia është e lejuar, ka edhe hadithe të Pejgamberit a.s., si p.sh.: rasti kur Pejgamberi a.s. i ka thënë Adij bin Hatimit: "Nëse e lëshon qenin tënd dhe e përmend emrin e Zotit, e nëse qeni e zë (gjahun) dhe e mbyt atëherë, merre dhe haje. E po që se ka ngrënë (qeni) diçka prej gjahut, atëherë mos e ha atë (gjahun), ngase atë qeni e ka zënë për vete."⁸

Gjuetia në det është e lejuar në çdo kohë dhe gjendje, ndërsa gjuetia në tokë është e lejuar gjithmonë më përjashtim kur njeriu është në *ihram*,⁹ ku për këtë thotë Allahu xh.sh.: "U është lejuar juve gjahu në det dhe ushqimi i tij, begati për ju dhe për udhëtarët, kurse gjahu tokësor u është ndaluar sa të jeni në *ihram*..."¹⁰.

Gjuetia konsiderohet veprim i urryer nëse bëhet për argëtim.

KUSHTET TË CILAT DUHET T'I PLOTËSOJË GJUEITIA PËR TË QENË HALLALL

Për të qenë gjuetia e lejuar, duhet të plotësohen kushtet që kanë të bëjnë me gjuetarin, mjetin e gjahut dhe vetë gjahun.

Kushtet që duhet të plotësoj gjuetari janë:

1. - Që gjuetari të jetë prej atyre që pranohet prerja dhe therja prej tij.¹¹ Sipas unanimitetit të të gjithë dijetarëve, gjuetia e myslimanit është *hallall*. Po ashtu gjuetia e ithtarit të Librit është *hallall*. Thënë ndryshe, edhe gjuetari duhet t'i plotësojë kushtet sikurse edhe therësi, ngase, gjuetari është në pozitë të njëjtë sikurse therësi. Këtu duhet përmendur se sipas shumicës dërmues të fukahave, përveç shafitëve, nuk i lejohet të gjuaj i çmenduri apo fëmija që ende nuk di të dalloj të mirën prej të keqes.¹²

2. - Që gjuetari të mos jetë pjesëmarrës në gjueti, therja e të cilit nuk lejohet, si adhuruesi i zjarrit, renegati, idhujtari¹³ etj.. Si, f.v. nëse *mexhusiju* e shoqëron myslimanin në gjueti ose në therje, në lëshuarën e shtazës së dresuar për gjah apo në

Të përmendurit e emrit të Allahut xh.sh. gjatë kohës së gjuetisë është kusht, sikur që është edhe gjatë kohës së therjes. E nëse nuk përmendet emri i Zotit nga harresa, gjahu i tillë lejohet të hahet.

gjuajtje me mjet, atëherë gjahu apo kafsha e therur nuk lejohet. E po që se mjeti apo shtaza e dresuar e myslimanit nuk arrin para mjetit apo shtazës së dresuar të *mexhusijut*, atëherë gjahu i tillë konsiderohet *haram*. Nga ky kusht kuptohet qartë ajo se nëse nuk dihet se cili e ka qëlluar i pari, atëherë gjahu i tillë është i ndaluar.

3. - Që të mos lihet të përmendurit e emrit të Allahut xh.sh. me qëllim në rastin e gjuajtjes apo lëshuarës së shtazës së dresuar për gjah.¹⁴ Të përmendurit e emrit të Allahut xh.sh. gjatë kohës së gjuetisë është kusht,¹⁵ sikur që është edhe gjatë kohës së therjes. E nëse nuk përmendet emri i Zotit nga harresa, gjahu i tillë lejohet të hahet. Për atë se duhet të përmendet emri i Zotit gjatë kohës së gjuetisë merret si argument ajeti: "...dhe hani, pra, atë që gjahtuan për juve dhe më parë përmendni emrin e Allahut..."¹⁶.

4. - Të mos jetë gjuetari i tokës në *ihram* për shkak të *haxhit* apo të *umres*, ndërsa gjahu i detit është *hallall* për të edhe pse është në *ihram*. Për atë se nuk lejohet për personin që është në *ihram* të gjuajë në tokë, ndërsa në det po si argument merret ajeti: "U është lejuar juve gjuetia e detit dhe ushqimi i tij, begati për ju dhe udhëtarët. E u është ndaluar gjuetia e tokës deri sa ju jeni në *ihrama*..."¹⁷.

KUSHTET QË DUHET T'I PLOTËSOJË MJETI I GJAHUT

Mjeti për gjueti mund të jetë armë ose shtazë.¹⁸

1. **Arma.** Për atë se arma është lloj mjeti për gjah, si argument e kemi ajetin: "O ju që keni besuar, gjithsesi do t'ju



*sprovoj juve Allahu me diçka prej gjahut që e arrijnë duart tuaja ose shigjetat tuaja...*¹⁹.

Kusht është që arma të jetë e mprehur, si: shtiza, shpata, shigjeta, çiftja dhe të gjitha llojet e pushkëve, në mënyrë që të mundësohet shpërthimi dhe derdhja e gjakut të gjahut. E po që se ndodhë që mjeti është i topitur dhe nuk ka mundësi shpërthimi, ose të qëlluarit e gjahut më shtizë prej së gjëri, atëherë gjahu i tillë konsiderohet si cofëtin, dhe mishi i tillë konsiderohet *haram*. Për këtë si argument është fjala e Pejgamberit a.s.: “Kur gjuan më shtizë (gjahun) dhe ngulet (në gjak), atëherë ha-ushqehu prej tij, nëse e qëllon atë (gjahun) me gjerësinë e shtizës, atëherë mos ha prej tij.”²⁰ Nëse ndodhë që gjatë gjuetisë gjahut t’i këputet një pjesë e trupit e gjahu të mbetet gjallë, pjesa e tillë është *haram* të hahet.²¹ Për këtë Pejgamberi a.s. thotë: “Çfarë do që këputet prej shtazës së gjallë ajo pjesë e këputur është *haram*.”²² Gjahu nuk lejohet të gjuhet me ato mjete me të cilat është e ndaluar të bëhet therja dhe prerja siç është: dhëmbi dhe thoi. Mu për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ju mund të hani një kafshë të therur me çdo mjet që shkakton rrjedhjen e gjakut përderisa mbi të përmendet emri i Allahut, përveç dhëmbit dhe kthetrave (nuk lejohet të përdoret). Dhëmbi është kockë dhe thoi është thika e abisinianëve (etiopianëve).”²³

2. **Shtaza.** Lejohet të bëhet gjuetia më shtazët-shpezët shqyesë që janë dresuar, si: qeni, zagari, tigri, luani, skifteri etj.. Për këtë kemi si argument ajetin kuranor: “...u janë lejuar juve ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuara që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu. Hani, pra, atë që gjahtuan për juve...”²⁴

Gjithashtu si argument mund të përmendim edhe hadithin e transmetuar nga Adij bin Hatim, i cili ka thënë: “E kam pyetur Pejgamberin a.s. për gjuetinë që e bën skifteri, e Pejgamberi a.s. është përgjigjur: “Kur ta gjahtoj për ty, atëherë haje atë.”²⁵

KUSHTET TË CILAT DUHET T’I PLOTËSOJË SHTAZA APO SHPEZA E CILA PËRDORET PËR GJAH

1. Të jetë shtaza e dresuar. Kusht se duhet më qenë shtaza e dresuar qartë vërehet nga ajeti: “...u janë lejuar juve ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të dresuar që i mësoni ashtu si ju ka mësuar juve Allahu. Hani, pra, atë që gjahtuan për juve...”²⁶

2. Që shtaza e dresuar të mos hajë asgjë nga gjahu. Për këtë si argument mund të përmendim hadithin që Pejgamberi a.s. i drejtohet Adij bin Hatimit, duke i thënë: “Kur ta lëshosh për gjah qenin e dresuar dhe më parë e ke përmendur emrin e Zotit, nëse ai e ka zënë gjahun dhe e ka mbytur, atëherë haje atë . E po qe se ka ngrenë diçka prej saj, mos e ha atë, sepse unë kam frikë se ndoshta shtaza e dresuar, atë e ka zënë për vete.”²⁷ E nëse shpendi i dresuar si skifteri etj., hanë diçka prej gjahut, gjahu i tillë lejohet të hahet ngase nuk është kusht që shpendi i dresuar të dresohet për të mos e ngrenë gjahun, por kusht te dresimi i shpendëve është që kur të thirret prej zotërisë ai t’i përgjigjet thirrjes, ndërsa kusht te dresimi i shtazëve është që shtaza të dresohet që të mos e hajë gjahun.

3. Që shtaza e dresuar të jetë shqyese.

4. Që shtaza ta shqyey gjahun dhe që gjahu të jep jetën për shkak të derdhjes së gjakut. E po qe se shtaza e dresuar e mbyt gjahun duke ngulfatur, goditur, por që nuk shkakton gjakderdhje, gjahu i tillë nuk lejohet të hahet.

5. Që bashkë me shtazën e dresuar të mos marrë pjesë edhe shtaza e pa dresuar në gjuajtjen e gjahut.

6. Që të përmendet emri i Zotit, kur të lëshohet shtaza për gjah. Për argumentimin e kësaj mund të përmendim hadithin e transmetuar nga Adij bin Hatimi, hadithi që është përmendur më lart.

KUSHTET TË CILAT DUHET TË PLOTËSOHEN PËR GJAHUN

1. Që gjahu të jetë prej gjallesave që lejohet për t’u ngrenë mishi i tyre.²⁸ Sipas hanefitëve të gjuhet shtaza që i lejohet ngrënia e mishit, po ashtu lejohet të gjuhet edhe shtaza të cilës nuk i hahet mishi, por që prej tyre ka leverdi të tjera, si f.v. leshi, lëkura, brirët. Mund të gjuhet për t’u mbrojtur nga sherri i saj (shtazës).

2. Gjahu duhet të jetë shtazë e egër, të cilën njeriu nuk mund ta zë për ta prerë. Po qe se ndodhë që shtaza e butë (shtëpiake) egërsohet, lejohet të gjuhet dhe konsiderohet *hallall* nga shkak se nuk ka mundësi për t’u zënë ndryshe.

3. Që gjahu ta jep shpirtin prej plagës së shkaktuar. E nëse gjahu e jep shpirtin prej goditjes, frikës etj., gjahu i tillë nuk lejohet të hahet.²⁹

4. Që të dihet sigurt se gjahu e ka dhënë jetën për shkak të gjuajtjes nga shtaza e

“Kur ta lëshosh për gjah qenin e dresuar dhe më parë e ke përmendur emrin e Zotit, nëse ai e ka zënë gjahun dhe e ka mbytur, atëherë haje atë . E po qe se ka ngrenë diçka prej saj, mos e ha atë, sepse unë kam frikë se ndoshta shtaza e dresuar, atë e ka zënë për vete.”

Gjahu duhet të jetë shtazë e egër, të cilën njeriu nuk mund ta zë për ta prerë. Po qe se ndodhë që shtaza e butë (shtëpiake) egërsohet, lejohet të gjuhet dhe konsiderohet *hallall* nga shkaku se nuk ka mundësi për t'u zënë ndryshe



dresuar apo nga mjeti me të cilin ka gjuajtur gjahtari. Po qe se nuk dihet sigurt se gjahu nuk e ka dhënë jetën për shkak të gjuetisë, por, fitohet dyshimi se gjahu e ka dhënë jetën për ndonjë shkak tjetër, atëherë gjahu i tillë nuk lejohet të hahet.

5. Që të prehet gjahu nëse arrihet i gjallë. Për këtë si argument kemi fjalët e Pejgamberit a.s.: “Nëse e arrin

4. Gjahu duhet të jetë prej gjallesave që lejohet ngrënia e saj, nëse arrihet e gjallë duhet të theret dhe duhet të jetë gjuetari i sigurt se mjeti i tij e ka shkaktuar mbytjen e gjahut. Po ashtu sipas hanefitëve lejohet edhe shtaza që nuk i hahet mishi, por prej saj ka dobi tjera si: lëkura, leshti etj..

të gjallë (gjahun), atëherë preje atë.”³⁰

REZYME

Si përmbledhje e gjithë kësaj që u shpjegua mund të vijmë në përfundim:

1. Gjuetia vije në shprehje atëherë kur shtaza është e egër dhe nuk mund të kapet pos duke e gjuajtur.

2. Gjuetia është e lejuar sipas pajtueshmërisë së të gjithë dijetarëve të ymetit.

3. Gjuetia ka kushtet e veta të cilat duhet t'i plotësoj për të qenë e lejuar, si:

a. kushtet që kanë të bëjnë me gjuetarin, e si kusht kryesor është që gjuetari të jetë prej atyre që lejohet të therë shtazën d.m.th. të jetë mysliman apo prej ithtarëve të Librit (i krishterë apo hebre) dhe që gjuetari të përmend emrin e Zotit.

b. kushtet që kanë të bëjnë me mjetin e gjahut. Si mjet i gjahut konsiderohet arma dhe shtaza e dresuar. Arma duhet të jetë e atillë që e shqyen vendin kur e godet shtazën dhe e shkakton rrjedhjen e gjakut, ndërsa shtaza duhet të jetë e dresuar për gjah dhe që të mos e ha gjahun për vete por t'ia sjell pronarit të vet.

- 1 Lukman, 20.
- 2 Mensur bin Idris el-Behutij, *Keshful Kinai An Metnil Iknaï*, boton Darul Fikr, Beirut 1402h, vol. VI, fq.213.
- 3 El-Kesani, *Bedaiu Sanai*, vol. V, fq.44.
- 4 En-Neveviu, *Sherhu Neveviji Ala Sahihil Muslim*, vol. XIII, fq. 78.
- 5 El-Maide, 2.
- 6 El-Maide, 4.
- 7 El-Maide, 96.
- 8 Buhariu nr. 5486.
- 9 Muhamed Uthman bin Alij ez-Zujeliju el-Hanefiju, *Tebejjunul Hakaiki Sherhu Kenzi Dekaik*, Darul Kutubul Islamiyyeti, Kajro, vëll. VI, fq. 50. En-Neveviu, *Sherhu Neveviji Ala Sahihil Muslim*, vëll. XIII, fq. 73.
- 10 El-Maide, 96.
- 11 En-Neveviu, *Sherhu Neveviji Ala Sahihil Muslim*, vëll. XIII, fq. 73.
- 12 Esh-Shirazi, *El-Muhedh-dheb fil Fikhi-sh-Shafiji*, viti i botimit 1976, vëll. I, fq. 253.
- 13 Muhamed Uthman bin Alij ez-Zujeliju el-Hanefiju, *Tebejjunul Hakaiki Sherhu Kenzi Dekaik*, vëll. VI, fq.60.
- 14 Tebejjunul Hakaik, vëll. VI, fq. 53-54.
- 15 En-Neveviu, *Sherhu Neveviji Ala Sahihil Muslim*, vëll. XIII, fq. 74.
- 16 El-Maide, 4.
- 17 El-Maide, 96.
- 18 El-Kasani, *Bedaiu Sanai*, vol. V, fq.44.
- 19 El-Maide, 94.
- 20 Muslimi, 1929
- 21 Muhamed Emin bin Umer Abidini, *Reddul Muhtar*, Alemul Kutub, 1423h/2003, vëll. I, fq. 20.
- 22 Ibën Maxheh, 3216.
- 23 Buhariu nr. 5503, Muslimi nr. 1968.
- 24 El-Maide, 4.
- 25 Ebu Davudi nr. 2851.
- 26 El-Maide, 4.
- 27 Buhariu nr. 175.
- 28 El-Kasani, *Bedaiu Sana'i*, vëll. V, fq. 36.
- 29 Muhamed bin Muhamed el-Hatib esh-Sherbini, *Mugnil Muhtaxh Ila Mearifeti Meani el-Fadhil Minhaxh*, Darul Mearifeti, 1418 h/1997, vëll. IV, fq.272.
- 30 Muslimi nr. 1929.

Parandalimi dhe obligimi i ndalimit të dhunës

Mihana Goga-Bekteshi

Secili njeri mund të jetë viktimë e dhunës. Dhuna është një fenomen që mund t'i ndodh çdokujt pa marrë parasysh moshën, kombin, përkatësinë fetare apo gjendjen ekonomike.

Islami fenomenin e dhunës e konsideron Imëkat me të gjitha vlerësimet, si në nivelin individual ashtu edhe në atë kolektiv. Aty ku problemet nuk mund të zgjidhen me komunikim dhe me dialog, aty përdoret dhe ushtrohet dhuna. Dhuna nuk është metodë për zgjidhjen e problemeve, por ushtrim i presionit dhe shtypje mbi tjetrin, nga më i fuqishmi mbi të pafuqishmin, mbi të dobëtin. Me fjalë të tjera, dhuna është përdorim i forcës në mënyrë të padrejtë, apo e njohur ndryshe si zullum. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Ndhmoje vëllain tënd, qoftë ai zullumqar ose që i bëhet zullum. O Pejgamber i Allahut, i thanë të pranishmit, do t'i ndihmojmë atij që i është bërë dhunë, por si do ta ndihmojmë atë që bën dhunë? T'ia mposhtni duart e tij, ta pengoni.”*¹

Secili njeri mund të jetë viktimë e dhunës. Dhuna është një fenomen që mund t'i ndodh çdokujt pa marrë parasysh moshën, kombin, përkatësinë fetare apo gjendjen ekonomike. Megjithatë është një fenomen që ndikon negativisht në integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social, sidomos te kategoritë e ndjeshme të shoqërisë, siç janë gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Duke qenë se dhuna shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet apo trajtohet hapur në shoqërinë tonë, viktimat përgjithësisht vuajnë në heshtje. Zoti xh. sh. në Kuranin fisnik thotë: *“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”* (Nahl, 90).

Dhuna thyen individin, familjen dhe bashkësitë, i pengon njerëzit të arrijnë



kapacitetet e tyre shoqërore. Zoti xh.sh. në Kuran na kujton: *“Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja...”* (Teube, 71).

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Myslimani është vëlla i myslimanit dhe nuk do t’i bëjë dhunë, por as nuk e braktisë atë. Ai që i gjendet në ndihmë vëllait të vet, Allahu do t’i gjendet në ndihmë atij kur ka nevojë; ai që ia heq myslimanit ndonjë problem, mundim, Allahu do t’ia heqë atij një mundim në Ditën e Gjykimit, dhe kush ia mbulon myslimanit (të metën) Allahu do t’ia mbulojë atij në Ditën e Gjykimit.”²

Modeli më i mirë për një jetë superiore familjare është Muhamedi a.s., i cili kurrë nuk ushtroi dhunë në familjen e tij, por as edhe në familjet e shokëve të tij.

NDIHMJA PËR ATË QË I SHKELET E DREJTA

Pejgamberi a.s. na ka urdhëruar shtatë (gjëra) dhe na ka ndaluar shtatë të tjera, duke i renditur: vizitën e të sëmurit, përcjelljen e xhenazes, t’i dëshirosh shëndet atij që teshtin, takthesh përshëndetjen, ta ndihmosh atë që i shkelet e drejta, të përgjigjesh në thirrjen e mikut dhe t’i bësh mirë atij që lutet me përбетim.³

Të ndihmosh të shtypurin, të mbrosh nga dhuna dhe autokracia dhe të për-

“Myslimani është vëlla i myslimanit dhe nuk do t’i bëjë dhunë, por as nuk e braktisë atë. Ai që i gjendet në ndihmë vëllait të vet, Allahu do t’i gjendet në ndihmë atij kur ka nevojë; ai që ia heq myslimanit ndonjë problem, mundim, Allahu do t’ia heqë atij një mundim në Ditën e Gjykimit, dhe kush ia mbulon myslimanit (të metën) Allahu do t’ia mbulojë atij në Ditën e Gjykimit.”

cjellësh xhenazen, është detyrë kolektive e shkallës së parë, t’ukthesh përshëndetjen njerëzve, të ndihmosh personin që lutet duke bërë be, t’i përgjigjesh thirrjes së miqve, duke përjashtuar ahengun e dasmës, bën pjesë në obligimet e myslimanit në shkallën e dytë. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Besimtari me besimtarin janë sikur ndërtesa, shtëpia, pjesët e të cilës janë të përforcuara ndërmjet veti, dhe i lidhi gishtat.”*⁴

Andaj është shumë e rëndësishme që bashkërisht si shoqëri, secili në rolin e vet të punojmë në ruajtjen familjes, rinisë e shoqërisë në përgjithësi nga pasojat e mëdha që sjell kjo dukuri. Jemi dëshmitarë të rasteve të shumta tragjike që kanë ndodhur si pasojë e dhunës, kështu që është koha që urgjentisht t’i japim prioritet kësaj çështje për ta mbrojtur, edukuar familjet tona, rininë e shoqërinë, ngase Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Mysliman i vërtetë është ai prej duarve dhe gjuhëve të të cilit janë të qetë myslimanët e tjerë.”*⁵

1 Sahihu i Buhariut, nr. 6952.

2 Koleksioni “Sahihul Buhari në gjuhën shqipe”, libri 6, përktheu: Feti Mehdiu, Prishtinë, 2000, fq. 186.

3 Sahihu i Buhariut, nr.2442.

4 Sahihu i Muslimit, nr. 2580.

5 Sahihu i Buhariut, nr.10.



(Intervistë me dr. Armend Agollin, në duart e të cilit vdiq dëshmori, hoxhë Jonuz Zejnullahu)

“Vullneti për t’i ndihmuar të tjerët, më shtyu që ta zgjedh mjekësinë”

Ëndrra e tij ishte që të bëhej doktor. Mision e kishte që t’iu ndihmonte njerëzve të tjerë, e për ta realizuar ëndrrën dhe misionin, Armend Agolli gjatë gjithë jetës së tij kishte ndjekur rrugën e dijes, edukimit dhe arsimimit, duku studiuar në katër vende të ndryshme në Evropë. Janë dy arsye kryesore që doktorin, Armend Agolli, e shtynë të bëhej mjek, njëra është dëshira e tij që të jetë pranë njerëzve të tjerë – që t’u ndihmojë dhe t’u shërbej atyre – si dhe arsyeja e dytë është problemi shëndetësor i nënës së tij. Nëna e tij kishte pasur problem me boshtin kurrizor. Aso kohe, Armend Agolli nuk kishte pasur zgjidhje për nënën e tij, sepse nuk ishte ende mjek, mirëpo sot, ai thotë se do ta dinte formulën për shërimin dhe largimin e dhimbjeve që i përjetonte nëna e tij, ditë dhe natë pa ndërprerë.

Këto janë dy arsyet që Armend Agollin e shtynë të bëhej neurokirurg.

“Humaniteti, apo ma mirë me thanë ndjenja për me ndihmu dikë, më ka shty që me zgjedh mjekësinë, sepse ka shumë degë të tjera që mundesh me i ndihmu të tjerëve mirë, por mjekësia është diçka prekëse, është një degë që direkt mundesh me i dhanë ndihmë.”

“Mundesh me dhanë ndihmë edhe si profesor, si imam, si hoxhë, mirëpo si mjek je shumë më afër, shumë ma direkt mundesh me dhanë ndihmën, kjo është prej arsyeve. Arsyeja e dytë pse posaçërisht jam marrë me boshtin kurrizor – me

BIOGRAFI E SHKURTËR E DR. ARMEND AGOLLIT

Armend Agolli lindi në vitin 1966 në Mitrovicë. Në vitin 1990, diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Gjatë periudhës 1992-1993 punoi si mjek në Turqi, ku më pas filloi specializimin në neurokirurgji, të cilin e vazhdoi në Shqipëri dhe e përfundoi më 1999. Gjatë këtij viti, që ishte vit lufte në Kosovë, shërbeu si mjek në Koshare, në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku kishte ardhur nga Suedia, në të cilën kishte shkuar më 1998. Pas luftës shkoi sërish në Suedi, ku bëri kompletimin e specializimeve me kryerjen e një subspecializimi në kirurgjinë spinale, që zgjati katër vjet. Pas mbarimit të kësaj pjese, punoi në spitale të ndryshme universitare të Suedisë, në spitalet private më eminente, siç është “Stockholm Spine Centre” etj. Në shtator të vitit 2008 u kthye në Kosovë dhe diku në periudhën mars-maj 2009 është punësuar në QKUK. Veç të tjerash, ai njihet edhe si themelues i Qendrës Spinale në QKUK. Dr. Agolli u përpoq t’i shërojë plagët e hoxhës Jonuz Zejnullahu, i cili me trimëri u fut me bomba në bunkerin me qindra ushtarë serbë.

unazat, është sëmundja e nënës time. Nëna ime ka qenë e sëmurë prej unazave dhe nuk ka mujt me ju gjet zgjidhje. Tash e di se ku ka qenë zgjidhje te rastin i nënës time, mirëpo fatkeqësisht është vonë, edhe ajo ka qenë njëra prej arsyeve, në veçanti dhimbjet e saja, që ditën dhe natën nuk ju nalshin asnjëherë. Kjo ka qenë njëra prej arsyeve që pasi kam përfunduar Fakultetin e Mjekësisë t’i drejtohem vetëm kirurgjisë spinale, apo si me thanë ma mirë, sëmundjes së unazave”, rrëfen ai.

Armend Agolli në vazhdimësi ka ndjekur rrugën e dijes, fillimisht ai diplomoi në vitin 1990/1989 në Fakultetin e Mjekësisë, mirëpo meqenëse nuk kishte kryer shërbimin ushtarak, ai ishte në përndjekje nga regjimi jugosllav. Duke parë rrethanat e tilla, ai depërtoi në Turqi për të filluar specializimin për neurokirurg në Universitetin e Marmaras në Stamboll dhe në

Spitalin Amerikan po në Stamboll. Për shkak të pamundësisë financiare për ndjekjen e shkollimit, Agolli kthehet në Kosovë, për të vazhduar mandej në Tiranë specializimin për tri vjet me radhë te profesorit Mentor Petrela, teksa në vitin e fundit, obligohet ta largojë familjen e tij për në Suedi. Por, një javë më pas ai kthehet përsëri në Kosovë për t’i shërbyer vendit, me çrast i bashkohet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në detyrat e tij mjekësore. Agolli mori pjesë në betejën më të rreptë për çlirimin e Kosovës – atë të Koshares, teksa më pas, dëshira për ta ndjekur shkollimin dhe për të specializuar në Kirurgjinë Spinale, e bëri atë të largohet



përsëri drejt Suedisë, por tashmë për ta ndjekur rrugën e dijes.

“Fatmirësisht arrita të aktivizohem, isha pjesë e UCK-së dhe isha në Koshare. Ishte një gjendje kaotike, s’kishte mundësi të vazhdoja atë që kisha dëshirë, sepse specializimin e kisha gjithmonë dëshirë kirurgjinë spinale. Atëherë s’kish mundësi të zhvillohej as Neurokirurgjia, e lëre më një specializim i tillë, s’kish as ku me msu. Kështu që unë u dashtë me shku në Suedi, dhe atje prej vitit 2001 kam fillu në spitalet suedeze dhe kam fillu specializimin, atje ma njihen diplomën e Fakultetit, mirëpo jo edhe specializimin, kështu që u dashtë me e ndjek ekstra dy vite e gjysmë specializim në neurokirurgji, mandej katër vjet e gjysmë sup-specializim në kirurgji spinale. Në Suedi kam qenë në vazhdimësi deri në 2010, pastaj këto vitet kam qenë në Kosovë dhe Suedi”, thotë ai.

Me t’u kthyer në Kosovë në vitin 2009, Agolli ishte punësuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, me qëllim që të formojë Qendrën Spinale apo qendrën ku do të operoheshin pacientët me probleme të boshtit kurrizor, kjo edhe për faktin se operimet e tilla bëheshin mjaft rrallë në atë kohë dhe bëheshin vetëm rastet më të lehta, jo ato të komplikuar.

“Kam ardh me një qëllim, që të formojmë Qendrën Spinale, apo qendrën ku do të operoheshin pacientët me probleme të boshtit

Me t’u kthyer në Kosovë në vitin 2009, Agolli ishte punësuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, me qëllim që të formojë Qendrën Spinale apo qendrën ku do të operoheshin pacientët me probleme të boshtit kurrizor.

kurrizor, kam pas në atë kohë përkrahje të mirë nga ortopedët, fatkeqësisht jo prej neurokirurgëve që i përkasim asaj dege, mirëpo fatmirësisht pasi gjeta përkrahje prej tyre atëherë edhe në sallë të ortopedisë filluam operacionet e para të boshtit kurrizor në aspektin më të komplikuar, për shkak se ma të thjeshta kanë bërë edhe më herët, mirëpo edhe kanë kryer operime rrallë, por edhe jo të nivelit të ndërlikuar.”

Agolli jo vetëm në cilësinë individuale pati një efekt pozitiv në trajtimin e pacientëve, por edhe në krijimin e kuadrove të rinj, që do t’u shërbenin pacientëve.

“Mandej me ardhjen time unë i edukova dy djem që kanë shku në Suedi bashkë me mu, që kanë marrë një edukim special, mandej edhe me mu kanë qenë pjesë në operacione që kanë marrë pjesë, ku kanë fitu përvojë dhe janë eduku, ndërsa tash funksionon Qendra Spinale në kuadër të QKUK-së”, thotë ai.

MREKULLITË NË TRUPIN E NJERIUT, SHKAS PËR SHTIMIN E BESIMIT

Studimi i mjekësisë dhe më saktësisht përvoja në operimet e pacientëve, për doktorin, ka shërbyer si një formë që e bind edhe më, për fuqinë e Krijuesit dhe mrekullitë që gjenden në trupin e njeriut. Thotë se organet në trupin e njeriut janë mrekulli në vete, sa që t’i shohësh ato për mënyrën se si

funksionojnë dhe rolin që kryejnë është e pabesueshme të mos besosh në Krijuesin dhe fuqinë e Tij.

“Është gati e pamundur të mos besosh, aq shumë ka mrekullinë në trupin e njeriut, sa që është vështirë të mos besosh, madje ka aq shumë mrekulli që nuk ka as shpjegim; shembull organi i zemrës, ku në një minutë pompohen pesë deri në shtatë litra gjak, në qoftë e shumëzon atë për 24 orë, del dikund 7 mijë e 200 litra gjak, hajde ta gjejmë një pompë të tillë që punon sot pa kurrfarë energjie, çka është karakteristikë se zemra e ka vetëmekanizmin e dirigjimit, t’i mundesh me largu zemrën dhe ajo prapë punon. Kjo është mrekulli, ku mundesh me gjet mandej shumë mrekulli të tjera që ti çuditësh ose truri që është mrekulli në veti, syri po ashtu”, thotë ai.

Ai thotë se puna e çdo dite që bën me trupin e njeriut dhe literatura që lexon, e bën t’ia shtojë edhe më shumë besimin dhe bindjen në Krijuesin. Ai thotë se për çdo operim, i mbështetet Krijuesit duke e filluar me ‘bismilah’ dhe duke e përfunduar me ‘elhamdulillah’.

“Unë besoj që ma ka shtu besimin, kam ma shumë bindje në punën që e bëjë, s’kam kurrfarë dyndje në atë se çfarë e bëjë. Çdo operacion që e bëj, e filloj me ‘bismilah’ dhe e përfundoj me ‘elhamdulillah’, kështu që kjo më mbanë dhe e di që operacioni ka me shku mirë, për shkak se e kam përkrahjen prej Zotit. Edhe nëse ndodhë ndonjë komplikim, e di që ai lart ka vendosë dhe aq ka qenë në dorën time. Unë çdoherë e them që doktori nuk ta përcakton as lindjen as vdekjen, doktori të mbron prej komplikimeve gjatë operacionit, edhe Zoti e ka çu doktorin që ti mos me vuajt, e ki sëmundjen, edhe ta ka çu doktorin që mos me vuajt. Shembull, nëse e ke tumorin ta largon tumorin, nëse e ke



Gati çerek shekulli pas lufte, doktori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Armend Agolli, e kujton në çdo detaj njërin prej ushtarëve me trimërinë më të lartë, hoxhën Jonuz Zejnullahu. Madje ai e krahason atë me figurën e njohur të Mic Sokolit.

ndonjë sëmundje tjetër është Zoti që përmes doktorit ta largon dhimbjen, na jemi rob të Zotit që përmes neve Zoti i ndihmon pacientit, po jo me ta jep ose me ta marrë jetën ne si mjek.”

RRËFIMI PËR TRIMËRINË E DËSHMORIT, HOXHËS JONUZ ZEJNULLAHU

Gati çerek shekulli pas lufte, doktori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Armend Agolli, e kujton në çdo detaj njërin prej ushtarëve me trimërinë më të lartë, hoxhën Jonuz Zejnullahu. Madje ai e krahason atë me figurën e njohur të Mic Sokolit, i cili i kishte dalë topit përball, veçse hoxhë Jonuzi për dallim u kishte hyrë në bunkerin e serbëve me bomba në duar.

“Një djalë shumë i mirë, i cili ka tregu trimëri të rrallë dhe derisa ka vdek ka qenë trim me plot kuptimin e fjalës”, kështu e kujton edhe pas gati çerek shekulli, hoxhën Jonuz Zejnullahu, doktori i UÇK-së së asaj kohe, Armend Agolli.

Ai me entuziazëm të madh flet për aksionin individual që ndërmoi hoxhë Zejnullahu më 5 maj të vitit 1999, te vendi “Rrasa e Zogut” në njërin prej betejave më të rrepta për çlirimin e vendit, në Koshare. Kujton se kishte qenë një nevojë e UÇK-së për marrjen e asaj pike, ku edhe e kishte tërhequr hoxhën të ndërmernte një aksion të tillë në mënyrë krejt individuale.

“Hoxha Jonuz, një djalë i ri diku rreth 21-vjeç, mos të gabo, një djalë me elan shumë pozitiv, një djalë shumë i mirë, i cili ka tregu një trimëri të rrallë, i cili mund të krahasohet sot me Mic Sokolin, që para sa viteve që i kishte dal topit përpara. Hoxha Jonuz Zejnullahu e ndërmoi një aksion, sepse ishte një pikë që nuk mundeshim me

marrë, ky e ndërmoi një aksion individual, pa ndihmën e askujt, pa urdhrin e askujt edhe afrohet te kerri i tyre, i hedh bombat dhe duke dalë plagohet.”

Doktori, në këtë intervistë kujton se hoxhë Jonuzi edhe gjatë shërimit, shqetësimin e tij të vetëm, e kishte se a po mund ta fitojnë luftën, për ta çliruar vendin. Veç të tjerash thotë se këtë moment do ta kujtojë gjatë gjithë jetës së tij.



“Vjen mandej transportohet dhe vjen te ne në spital. Kishte një plagë shumë të madhe që është shumë shtirë me e mjeku, ne u munduam sa kishim mundësi dhe sa kishim në kushtet e spitalit ‘Bajram Curri’, bashkë me doktor Sylë Bruqin, mirëpo ai kishte humbur edhe gjak gjatë transportit. Mirëpo deri në momentet e fundit ka qenë trim, ai deri në momentet e fundit më pyeste se a do ta fitojmë luftën, ai nuk e kishte dert që po e humb jetën. Kështu që ka qenë ndër momentet më prekëse në Koshare, ata nuk mundem me e quajft pacient, por ai është dëshmor. Hoxha Jonuz ka vdek për lirinë tonë që ne sot e gëzojmë, për këtë arsye ka qenë moment prekës dhe moment që do ta kujtojë tërë jetën”, thotë ai.

Doktori rrëfen për kohët e vështira të kryerjes së detyrës së tij gjatë viteve të luftës. Ai thotë se përveç kushteve të vështira për trajtimin e luftëtarëve të plagosur, thotë se kishte edhe civilë të shumtë që kishin nevojë për ndihmë mjekësore.

“Ka pas raste të ndryshme, na përveç që i kemi ndihmu ushtarëve, ka pas problem edhe me civilë, për shkak se nuk ka pas mjekë as për civilë, e lëre më për ushtarë në atë pjesë. Ka qenë një situatë shumë e vështirë, ku ka pas nevojë jo vetëm për mjekë, po edhe për infermierë dhe mjekë të atij profesioni, pra mjekë të luftës, se na nuk jemi kanë të specializuar për atë pjesë, mirëpo me ndihmën e Zotit ne i kemi kry një detyrë të mirë. Në krahësim me zonat e tjera, kemi pas mbështetje prej spitalit ‘Bajram Curri’, kohë pas kohë kemi pas edhe prej Shqipërisë dhe Kryqit të Kuq”, thotë ai.

**KUSH ISHTE HOXHA QË U DHA
LAMTUMIRËN SHOKËVE PËR TË RËNË
SHEHID**

Jonuz Zejnullahu lindi më 12 maj 1975 në Skyfteraj të Vitisë, nga babai Qazimi dhe nëna Hava. Shkollën fillore e kreu në Skyfteraj, kurse të mesmen në Medresenë “Alaudin” të Prishtinës (1995-1994). Sa ishte medresist shërbeu si imam në Vuthaj të Malit të Zi. Gjatë shërbimit si imam, binte ndesh shpeshherë me regjimin serb të asaj kohe, sepse në tubimet e tij, ai si imam, u fliste për nevojë e masivizimit të rezistencës së armatosur, kërkonte të reagohej e të mos nënshtrohej. Pas kthimit nga studimet, hoxha organizoi mbledhjen e të mirave materiale për UÇK-në. Ditën që filluan bombardimet e NATO-s, Jonuz efendiu ishte nisur për në Shqipëri, ku u inkuadrue në radhët e UÇK-së në Brigadën 138 “Agim Ramadani”.

Në radhët e UÇK-së shërbente edhe si përkthyes. Ditën e rënies së tij, më 5 maj 1999, te vendi “Rrasa e Zogut” në Koshare, hoxhë Zejnullahu u përshëndet me shokët, mori dy bomba në duar, hyri në bunkerin serb dhe aty hodhi në ajër shumë ushtarë serbë. Në këtë aksion u plagos rëndë dhe, nga plagët e marra, vdiq në qytetin e Bajram Currit. Për trimërinë e tij, komandanti Rrustem Berisha, kishte deklaruar: “Lindi Mic Sokoli i shekulli II”. Jonuz Zejnullahu ishte varrosur në Bajram Curr - Shqipëri, dhe me vonë është rivarrosur në varrezat e dëshmorëve në Viti.

Emrin e Jonuz Zeinullahut e mban sot me krenari shkolla e mesme teknike e Vitisë, si dhe një rrugë e qytetit pranë Këshillit të Bashkësisë Islame të Vitisë.

Intervistoi: Agron Canolli

Shkollat myslimane në Britani të Madhe

Daut Dauti

Në vitin 1983, në Londër, u themelua shkolla e parë fillore islamike me iniciativë të këngëtarit të njohur, Jusuf Islam (më parë i njohur me emrin Cat Stevens), i cili më 1978, qe konvertuar në mysliman.

Sot në këtë shtet ekzistojnë mbi 100 shkolla të këtilla me diku rreth 15.000 nxënës.

21 nga këto shkolla financohen nga shteti.

Në vitin 1983, në Londër, u themelua shkolla e parë fillore islamike me iniciativë të këngëtarit të njohur, Jusuf Islam (më parë i njohur me emrin Cat Stevens), i cili më 1978, qe konvertuar në mysliman. Themelimin e kësaj shkolle e përcollën vështirësi të shumta, por më në fund ligdhënësi britanik nuk mundi ta refuzojë regjistrimin për shkak se në këtë vend ekzistonin shkolla të tjera religjioze, siç janë ato protestante (anglikane), katolike, hebreje, etj.. Kjo shkollë u bë e njohur edhe si e para nga ato islamike që në Britani të Madhe mori financim nga fondi i qeverisë në vitin 1998.

Pas kësaj shkolle fillore u hapën edhe shkolla të tjera, kryesisht ato të mesme, që e ndoqën këtë shembull. Sot në këtë shtet ekzistojnë mbi 100 shkolla të këtilla me diku rreth 15.000

nxënës. Natyrisht që numri i nxënësve është kryesisht i përbërë prej myslimanëve, por i karakterit shumë etnik, pasi që myslimanët e Britanisë së Madhe kanë prejardhje nga shumë vende të ndryshme të botës. Numri i këtyre shkollave u rritë edhe për shkak se Mbreti Charles III, atëherë princ, i përkrahu këto institucione edukative e arsimore dhe filloi t'i vizitonte.

Këto shkolla sot gjenden kryesisht në pjesët urbane, por disa, madje tejet të suksesshme, edhe në ato rurale ku funksionojnë me sistemin e konvikteve. Shumë nga këto shkolla kanë filluar si grupe të vogla me nxënës entuziastë të përqendruara rreth xhamive, e që më vonë janë zhvilluar në institucione që zbatojnë program edukativ islamik dhe sekular së bashku. Natyrisht, që kur flasim për



këto shkolla duhet ta kemi parasysh se nuk është fjala për medrese. Numri i medreseve në Britani të Madhe është diku rreth 2000 dhe llogaritet se po kaq xhamia ekzistojnë në këtë vend. Por, këto medrese të dedikuara për fëmijë (numri i tyre që i vijojnë këto mësimet është 250.000), nuk e kanë kuptimin e shkollës së mesme, medrese që njihen në Kosovë apo gjetiu në Ballkan. Medresetë britanike ofrojnë vetëm mësimet suplementare bazike religjioze (islamike).

Një problem tjetër që është paraqitur me shkollat në fjalë ka qenë financimi i tyre. Prandaj, në fillim ato të gjitha kanë qenë të vetëfinancuara nga komuniteti mysliman, apo disa kanë qenë private. Sot, nga më shumë se 100 të këtyre shkollave ekzistuese, 21 financohen nga shteti. Për Britaninë kjo nuk është diçka e re e as ndonjë lajm i çuditshëm kur dihet se shteti financoi mbi 4700 shkolla të Kishës Anglikane, 2100 katolike, 33 hebrenj dhe 28 metodiste. Siç shihet, numri i shkollave myslimane të financuara nga buxheti shtetëror është i vogël në krahasim me shkollat e tjera, por këto institucione janë të vogla nga numri, por edhe më të reja nga koha e formimit apo funksionimit.

Sidoqoftë, fushata e myslimanëve britanikë për shtimin e numrit të këtyre shkollave, sikur edhe për ngritjen e kualitetit mësimor, përqendrohet në nevojën për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë sekulare, e cila nuk e përjashton aspektin multireligjioz dhe multietnik të llojit karakteristik britanik.

Ka kohë që në Britani të Madhe shkollat që tregojnë rezultate të shkëlqyeshme kanë qenë ato katolike. Këto shkolla janë të vjetra dhe janë themeluar shekuj më herët si rezultat i angazhimit të Kishës Katolike për arsimimin e katolikëve që dikur kanë qenë të diskriminuar. Edhe sot, organizimi i tyre është ndër më të mirët dhe me program adekuat, e të cilat janë bërë atraktive edhe për nxënësit jokatolikë që dëshirojnë t'i vijojnë mësimet në këto shkolla, ku konkurrenca për regjistrim është e madhe.

Por, me lajmërimin e shkollave myslimane, situata ka ndryshuar. Tashti më nuk janë vetëm shkollat katolike që e kryesojnë listën e më të mirave, por janë edhe ato myslimane. Në vitin 2019, në listën e 20 shkollave më të mira në vend, 8 nga këto kanë qenë myslimane. Kriteri i këtij klasifikimi është marrë suksesit të përparimit akademik që kanë treguar nxënësit në këto shkolla sikur edhe ai i mëvonshëm në nivelin universitar.

Suksesi i shkollave myslimane ka bërë që ky lloj i arsimit të rritet dhe myslimanët të mburren. Ky fakt është me rëndësi

Në vitin 2019,
në listën e 20
shkollave më
të mira në
vend, 8 nga
këto kanë qenë
myslimane.

pasi që sot llogaritet se në Angli dhe Uells (pa Skocinë, pasi ata kanë sistem tjetër të arsimit) ka rreth 4 milionë myslimanë. Shprehur ndryshe, kjo shifër paraqet rreth 7% të popullsisë dhe me tendencë të rritjes së vazhdueshme.

Siç u tha edhe më lart, në programet e këtyre shkollave shihet se fokusimi në lëndët islamike bëhet së bashku apo krahas me lëndët sekulare të kurrikulës shtetërore. Pra, është krijuar një harmoni mes këtyre dy fushave, e cila gjë bënë me dije se britanikët e përkatësisë religjioze myslimane janë të interesuar që të përparojnë në vendin e tyre, duke mos e përjashtuar aplikimin e njohurisë dhe edukatës myslimane. Më tutje, këto shkolla kanë dëshmuar se nxënësit që dalin nga to, janë të përgatitur për punësim dhe vazhdim të shkollimit universitar sikur edhe për jetë të përditshme e të pavarur në

shoqërinë britanike. Prandaj, pos kurrikulës, rëndësi të posaçme i është kushtuar edhe disiplinës, aftësisë apo kualifikimit adekuat të mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të shkollave. Me fjalë të tjera, ekziston një numër i konsiderueshëm i faktorëve apo kushteve të përmbushura që kanë rezultuar në suksesin e këtyre shkollave.

Në programin e njëres nga këto shkolla, e cila quhet *The British Muslim School* (Shkolla Myslimane Britanike), thuhet: “Me objektin dhe pajisjet tona shkollore moderne, *The British Muslim School*, ofron zgjedhje të mëdha për prindërit, nxënësit dhe studentët që të shkëlqejnë në jetën e tyre të moshës së pjekurisë. Asetet tona më të mëdha qëndrojnë në njerëzit tanë – një ekip i studentëve entuziastë, ekipi edukativ arsimor, në qeverisjen e shkollës dhe në përkrahjen e prindërve.”

Pasi që këto shkolla u treguan efektive, para disa viteve ky ishte edhe një shkak që mundësoi keqpërdorime. Shkolla të këtilla u hapën me të madhe, apo siç thuhet u shumuan si kerpudhat pas shiut. Por, pasi që disa kishin për qëllim fitimet financiare, duke e lënë pas mënyrën arsimuese, shumë prej tyre dështuan dhe qeveria u detyrua t'i mbyllte. Madje, në disa prej tyre u lajmërua edhe problemi i Islamit radikal. Por, Bashkësia Islame e Britanisë, nën të cilën udhëheqje apo rrjet janë shumica e këtyre shkollave, ka intervenuar duke i evituar problemet dhe duke e kthyer balansin e arsimit religjioz me atë sekular.

Sfidat e arsimit dhe edukimit të brezit të ri në një botë të trazuar

Nada Dosti

Sistemi arsimor dhe edukimi shkencor duhet të rikonceptohet në mënyrë të tillë që studentët të kenë mjete më të mira për të dalluar njohuritë e besueshme nga pretendimet e rreme, faktet alternative, dezinformatat dhe të tjera informacione që qarkullojnë në internet.

“Jetojmë në një botë të trazuar” - kjo shprehje sa aktuale aq edhe klishe. Me siguri e kanë thënë edhe brezat para nesh kushedi sa herë, e përsëri duket se i përshtatet më shumë se kurrë kohës sonë.

Meme apo *reels* të ndryshme nëpër rrjetet sociale ironizojnë situata qesharake se si mund të duket në një të ardhme të afërt procesi mësimor nëpër klasa dhe auditorë, ku nxënës e studentë për të sfiduar sistemin, për t’ia hedhur mësimdhënësve, thonë dhe veprojnë në të tilla nivele që vite më parë as nuk do imagjinohej dot një situatë e tillë. Disa prej tyre identifikohen si diçka apo dikush tjetër, disa të tjerë në emër të lirisë së shprehjes flasin dhe veprojnë çfarë iu thotë mendja, duke lënë pa zgjidhje mësimdhënësit në fjalë, të cilët, po në të njëjtët skenarë ironizues, duke u ndjerë nën presion të shoqërisë, iu shkojnë nga pas nxënësve dhe studentëve, sepse nuk duan të duken të prapambetur, e akoma më keq kur hiqen se besojnë dhe veprojnë dhe vetë me të njëjtat parime si brezi që kanë përballë.

SISTEMI ARSIMOR NË NJË BOTË POSTMODERNE

Jetojmë në botën postmoderne, një realitet i ri i kohëve tona që vjen me sfidat e veta, ndoshta dhe të paqena për brezat e mëparshëm. I mirë ose i keq, njihet për qëndresën që ka ndaj një përkufizimi të saktë, aq sa disa ia mohojnë koherencën si shkollë mendimi.

Por që mos të lodhemi për të gjetur një përkufizim, postmodernizmi mund të kuptohet nga dy aspekte kryesore me të cilat karakterizohet:

E para, ai inkurajon idenë se shoqërisë sonë, që sa vjen dhe bëhet gjithnjë e më pluraliste, do

t’i duhej të pranojë dhe t’u vërë veshin shumësisë së zërave: rrëfimet për gjininë, minoritetet etnike, orientimet seksuale dhe traditave kulturore. Kështu mendimtarët postmodernë nxitën lexuesit ta vinin në pikëpyetje dhe ta dekonstruktin gjuhën, gjuhën e imazheve, institucionet dhe dijen e transmetuar, dhe të shtronin kështu pikëpyetje se si munden fjalët, rrëfimet, arti dhe arkitektura të vendosin forma pushteti dhe “hegemonie”, të cilat përndryshe ne nuk do t’i dallonim. Andaj mund të themi se postmodernizmi lindi si nevojë për gjithëpërfshirje, diversitet, liri personale dhe të drejta civile.

E dyta, kjo shkollë mendimi, jo fort kompakte, bëri çmos për ta dëmtuar nocionin e së vërtetës. Trualli i tyre i natyrshëm ishte ironia, e sipërfaqshmja, tëhuajësimi dhe fragmentizimi. Filozofët postmodernë parapëlqenin ta konsideronin gjuhën dhe kulturën si fenomene politike që pasqyronin ndarjen e pushtetit mes klasave, racave, gjinive dhe seksualitetit, dhe jo si ideale abstrakte të filozofisë klasike.

E nëse gjithçka është “konstrukt shoqëror”, atëherë kush do të përcaktonte se çka është e vërtetë dhe e pavërtetë? Pikërisht në këtë pyetje dua që të ndalemi në këtë shkrim. Sfida më e madhe që ka nisur të tronditë dhe të shkund nga themelet sistemin arsimor dhe shkencën, është pikërisht nocioni i së vërtetës, i së vërtetës mbi dijet e marra, mbi teori dhe teorema të ndryshme shkencore, mbi artin dhe letërsinë.

Sipas Höttecke dhe Allchin, në epokën tonë të rrjeteve sociale, sistemi arsimor dhe edukimi shkencor duhet të rikonceptohet në mënyrë të tillë që studentët të kenë mjete më të mira për të dalluar njohuritë e besueshme nga pretendimet e rreme, faktet alternative,

dezinformatat dhe të tjera informacione që qarkullojnë në internet. Sipas këtyre autorëve, është e nevojshme të zgjerohet përmbajtja e asaj që njihet si Shkenca Natyrore dhe të fillohet të punohet me nocionin e “...shkencave natyrore në shoqëri...”, që përfshinë aspekte të mënyrës se si shkenca i komunikohet publikut, ndërmjetësimin e saj, mekanizmat e komunikimit dhe manipulimit etj..

Thënë këtë, lindin pyetje të ndryshme se a ka më ende kuptim të mësuarit e teorisë së revolucionit në ditët e sotme? A kanë më kuptim dhe rëndësinë e dikurshme dhënia e detyrave hulumtuese? Kur një student përballet me qindra mijëra informacione nëpër internet, si mund të dallojë ato të saktat, dhe mbi të gjitha si mund të arrijë të selektojë informacionet e rëndësishme për hulumtimin e vet?

Pra, thënë në fjalë të tjera, i gjithë sistemi arsimor, kurrikulat dhe metodat e mësimit duhet të shkundoen nga themelet, të zhbëhen dhe ribëhen për t’iu përshtatur këtij rendi të ri shoqëror.

Përveç postmodernizmit, i cili vjen me sfidat e veta siç është dhe post-truthi, i cili mund të përkufizohet si një gjendje shoqërore që kërcënon besimin në shkencë dhe mendimin kritik të njerëzve. Sistemi arsimor në të ardhmen e afërt, po/do të kërcënohet nga shumë sfida të tjera të cilat lidhen me zhvillimin e vrullshëm të teknologjisë, më konkretisht, sfida më e madhe do të jetë Inteligjenca Emocionale.

SFIDAT QË IA SJELL NË SISTEMIN ARSIMOR

Inteligjenca Artificiale shtron horizonte të reja për sistemin arsimor të sotëm, dhe për këtë s’ka dyshim, por bashkë me to sjell edhe shumë sfida të cilat do/po e tronditin sistemin arsimor dhe duket se shumë mësuesdhënës i ka gjetur pa përgatitur. Duke lënë mënjatë gjendjen e panikut, duhet që menjëherë të merren masa që ky sistemi i sotëm arsimor të mund t’i mbijetojë, të paktën (se për ta përballuar me sukses është thajse e pamundur), gjithë këtij zhvillimi teknologjik të vrullshëm që ka kapluar këtë njëzetvjeçarin e fundit. Ndër sfidat kryesore është çfarë do të bëhet me rolin e mësuesdhënësit? Po me provimet, testet, rezultat e testeve online apo sistemet e tjera të koduara që deri dje nuk mund të hakroheshin? Dhe akoma më tragjike, cili do të jetë roli i sistemit arsimor që deri dje kishte për synim të përgatiste brezat e ardhshëm me informacione dhe sjellje baze për të mbijetuar në një shoqëri? Përse mund t’i duhet shkolla dikujt që çdo përgjigje, çdo dije të mundshme mund ta arrijë brenda pak sekondave falë një tastiere të telefonit?

Përveç këtyre pikëpyetjeve, sfidat kryesore do të mbeten mungesa e personelit të pajisur më aftësi teknologjike ose trajnimi i mësuesdhënësve me aftësi të tilla, mjete dhe infrastrukturë të mjaftueshme për të mos lejuar hakerim dhe për të diktuar plagjiaturën, politika shtetërore dhe politika të brendshme të shkollës për të sistematizuar të dhënat dhe për të mbrojtur çështjet etike të cilat cenohen me përdorimin e



IA, dhe të gjitha këto në një kohë rekord, madje dhe në vende të pazhvilluara apo të varfra, ku fatkeqësisht nëpër shkolla ende s’ka një laborator të mirëfilltë me kompjuterë dhe me sistem interneti të shpejt dhe të fuqishëm.

PËRFUNDIMI

Sa u përket sfidave të lidhura me botën postmoderne në përgjithësi dhe post-truthi-in në veçanti, për të rikthyer besimin në shkencë dhe në sistemin arsimor duhet që ligjërimi shoqëror dhe qytetar të përfshihet si pjesë e strategjive epistemologjike të propozuara në arsim, duke marrë parasysh mbi të gjitha identitetet kulturore dhe epistemologjitë e njerëzve, si dhe ndërveprimet e tyre shoqërore dhe botëkuptimet ku ata banojnë.

Ndërsa në lidhje me sfidat që Inteligjenca Artificiale sjell në arsim, kërkohet një dialog urgjent mes aktorëve të ndryshëm, si qeveritë, ministrinë e arsimit, ekspertë të teknologjisë së informacionit, organizata të shoqërisë civile, si dhe akademikë që të bashkëveprojnë për përgjigje urgjente ndaj këtyre sfidave, duke sjell udhëzime, mundësisht kurrikula të reja, tekste të reja dhe një formatim të përgjithshëm të të gjithë sistemit arsimor për t’i mbijetuar kësaj epoke para se të jetë vonë për brezat e sotëm dhe brezat e ardhshëm.

Bibliografia

- D’Ancona, M. (2017) Post-Truth: The New War on Truth and How to Fight Back
- Erika. (2023). The future of AI in education Opportunities and Challenges. *The Data Scientist*. <https://thedata scientist.com/the-future-of-ai-in-education-opportunities-and-challenges/>
- Feinstein, N. W., & Waddington, D. I. (2020). Individual truth judgments or purposeful, collective sensemaking? Rethinking science education’s response to the post-truth era. *Educational Psychologist*, 55(3), 155–166. <https://doi.org/10.1080/00461520.2020.1780130>
- Höttecke, D., & Allchin, D. (2020). Reconceptualizing nature-of-science education in the age of social media. *Science Education*, 104(4), 641–666. <https://doi.org/10.1002/sce.21575>
- Valladares, L. (2021). Post-Truth and education. *Science & Education*, 31(5), 1311–1337. <https://doi.org/10.1007/s11191-021-00293-0>

Kërkimi i diturisë, vlera dhe kujdesi

Azmine Kukaj

Motivoni fëmijët që të jenë kërkues të diturisë, duke pasur kujdes se çfarë stimujsh përdorni. Stimuloni ata që të rrisin nivelin e përgjegjësisë, duke iu rikujtuar atyre se secili nga ne ka një mision për të përmbushur në këtë jetë, dhe ne nuk jemi krijuar kot.

Kur vjen gushti, mendja e secilit nga ne kudothëton shpirtërisht në shtator, atëherë kur edhe nis fillimi i vitit shkollor. Shtatori sikur i jep gjallëri edhe rrugëve. Na ngjallet një ndjenjë kthimi në normalitet. Preokupimi me librat e mjetet didaktike kthehet në prioritet, e ëndrrat për suksese të reja na e mbizotërojnë qenien tonë. Kërkimi i diturisë është temë që zhvillohet vazhdimisht, prandaj edhe janë shkruar libra të shumtë për këtë. Por çfarë në fakt duhet të kemi parasysh kur flasim për kërkimin e diturisë?

“Allahu i ka ngritur në shkallë të larta ata të cilët besuan prej jush dhe atyre të cilëve iu është dhënë dija, Allahu është i lajmëruar se çfarë punoni ju.” (Muxhadele, 11).

Kërkoni diturinë që nga lindja e deri në frymën e fundit, sepse kjo është porosi nga i Dërguari i Zotit. Është vërtetuar shkencërisht se edukimi i hershëm është shumë i rëndësishëm për njeriun, e posaçërisht edukimi i fëmijëve në 7 vjetët e para të jetës së tyre, është themel për formësimin kognitiv dhe social të tyre. Fëmijët që ndjekin programe cilësore para klasës përgatitore përfitojnë shumë

rezultate pozitive, duke përfshirë aftësi më të mira gjuhësore e komunikative, shkrim-lexim, zgjidhje të problemeve në matematikë e të tjera, dhe pikërisht ata fëmijë kanë një këmbë në atë që duket të jetë aftësia më thelbësore për t’u zhvilluar në moshën katër vjeçare: “vetëkontroll i fortë”.¹

Njeriu në moshë të hershme ngjason me një arkë të zbrazët. Varësisht se çfarë i ofrojmë atij, si iu përqasemi atij, ai do të mbushet me vlera të tilla, dhe formësimi njerëzor do të jetë proces që është në linjë paralele me qasjen që tregojmë ndaj tij.

Nëse fëmija rritet në ambient të zhurmshëm, konfliktuoz, edhe pse natyrshmëria e pastër e tij do ta luftojë një ambient të tillë, gradualisht, ai do të fillojë të adaptojë këtë ambient sikur një normalitet, dhe do t’i përvetësojë këto sjellje të të rriturve duke i shndërruar ato në vlera të tij personale. Hulumtime të ndryshme kanë treguar se shumica e sjelljeve të fituara në fëmijëri formësojnë strukturën e personalitetit, zakonet, besimet dhe vlerat e individit në moshën madhore.²



Andaj të dashur prindër dhe mësimdhënës, jo rastësisht, porosia profetike se edukimi ynë fillon 20 vjet para se të lindim ne, është shumë me rëndësi të zbatohet te vetja jonë, së pari të edukohemi ne, e pastaj krejt natyrshëm kjo edukatë do të përcillet edhe te fëmijët tanë.

Motivoni fëmijët që të jenë kërkues të diturisë, duke pasur kujdes se çfarë stimulsh përdorni. Stimuloni ata që të rrisin nivelin e përgjegjësisë, duke iu rikujtuar atyre se secili nga ne ka një mision për të përmbushur në këtë jetë, dhe ne nuk jemi krijuar kot.

Shpesh shoh prindër, por edhe arsimtarë që përdorin stimul material për të nxitur fëmijët të lexojnë dhe të arrijnë suksese të larta shkollore. Pajtohem që fëmijët të shpërblehen për sukseset e arritura, por nuk është aspak në rregull që stimujt material të shndërrohen në qëllim dhe arsye se pse ata duhet të lexojnë. Në fakt shtrohet pyetja se çfarë po bëjmë ne me këtë formë motivimi? Ne po arrijmë t'i bindim ata të lexojnë, të arrijnë suksese, por ajo që nuk po shihet në këtë rrugëtim, e që është më e rrezikshmja, është se ne po rrisim intelektual egoist, të cilët brumosen në besimin se janë 'elitar' që meritojnë standard të lartë jetese. Materializmi po bëhet forcë dominuese që tërheq drejt synimeve jetësore dhe s'le vend për ndërgjegjësim social. Gradualisht, në kërkim të materiales, është shumë e lehtë rrëshqitja. Ja një shembull! "Një ditë takova një djalosh që shiste misër të pjekur në rrugë, nga kalkulimet e tij matematikore që bënte me klient, e pashë se ishte një djalë shumë i zgjuar. Duke e përgëzuar për zgjuarsinë, e pyeta: "Ku e sheh veten në të ardhmen?" Ma ktheu: "futbollist". Mirë them, por pse futbollist? Mua më dukeni shumë i zgjuar dhe mendoj se mund të arrini shumë. Pse të mos e përfundoni ndonjë fakultet, mund të bëheni inxhinier, menaxher biznesi, apo ndonjë pozitë tjetër. 'Thaaa me një lojë të fituar unë t'i blej krejt menaxherët e inxhinierët, ma ktheu."

Rikujtojani në radhë të parë vetes suaj, e pastaj edhe fëmijëve apo nxënësve tuaj se ne jemi kërkues të diturisë, sepse ne kemi mision në këtë botë, dhe atë duhet ta përmbushim në mënyrën më të mirë. Ua rikujtoni atyre se përmbushja e misionit në mënyrën më të mirë duhet të jetë forca dominuese që na udhëheq në kërkimin e diturisë, dhe kjo forcë nuk guxon as të zbehet as të ndërpritet para se të ndalen rrahjet e zemrës dhe frymëmarrja jonë.

Kur jemi te rikujtimi dhe këshillimi, keni kujdes! Mos të bëhet zëri juaj irritues në veshët e fëmijës apo nxënësit tuaj. Nëse ti ke ndaluar së lexuari, nëse ti ke ndaluar kërkimin e diturisë; mosha juaj edhe mund të jetë 50 vjeçare, edhe 80 vjeçare, ti në mënyrë automatike e ke shndërruar këshillën tënde në irritim, sepse fëmija, nxënësi nuk merr komanda robotike, ai merr shembuj, kopjon dhe pason veprimet.

Shpesh kemi dëgjuar thënien: "Dy njerëz nuk i xhelozojnë arritjet tuaja, prindi dhe mësimdhënësi." Sa e bukur do të ishte tabloja kur prindi dhe mësimdhënësi janë nxënës aktiv

Mësoni fëmijët tuaj se forcën e karakterit e determinojnë kërkimi i vazhdueshëm i diturisë, përqafimi i sfidave, durimi dhe toleranca.

duke lexuar dhe kërkuar njohuri të reja, e pastaj fëmija apo nxënësi duke ndjekur rrugën e tyre, ua kalon në dituri. Kjo po që është shpresa për një botë më të mirë.

Vlerat e një njeriu të mirëformuar nuk i tregojnë vetëm arsimimi.³ Përveç leximit, ne formohemi edhe nga ambienti social, bisedat, sjelljet, ndërveprimet.

Fjalorit që fëmijët tanë, nxënësit tanë i ekspozohen, gradualisht do të shndërrohet në vlerë që do të brendësohet nga ata gjatë jetës. Keni kujdes çfarë bisedash bëni në prani të tyre! Kur diskutoni plane të së ardhmes suaj në prani të fëmijëve, keni kujdes çfarë synimesh po prezantoni në sy të tyre, nëse ju harroni të lidhni synimet jetësore me përgjegjësinë sociale, me misionin jetësor, të tillë mesazh do të përcillni edhe te fëmijët

tuaj. Komunikimet që bëni për njeri-tjetrin dhe me njëri-tjetrin, fëmijët do t'i regjistrojnë ato si një përvojë, dhe pastaj në atë mënyrë do ta shohin botën. Jemi dëshmitarë se edhe ne vetë, jo rrallë, botën e shohim si të padrejtë e mizore. Kjo është edhe si rezultat i pasqyrimeve dhe përvojave që kemi kaluar ne në moshën e re.

Nëse duam që fëmijët apo nxënësit tanë të bëhen të arsimuar dhe të edukuar mirë, le t'i edukojmë ata në frymën e virtyteve të larta njerëzore, duke u bërë ne shembull që të na pasojnë, duke iu dhënë lirinë të na kritikojnë, të përngjeshëm në veprimet që bëjnë dhe të vetëdijshëm në rolin dhe përgjegjësinë kognitive dhe sociale që mbajnë.

Leximi na bënë më të mirëkuptueshëm dhe tolerant. Sa më shumë të dini për botën, aq më shumë liri ndjeni në mendjen tuaj, sepse kupton se ka këndvështrime të ndryshme dhe kjo është krejt normale.⁴

T'i rikujtoj vetes në radhë të parë, e pastaj edhe fëmijëve dhe nxënësve tanë, se ne jemi autorët e librit tonë që përcakton kualitetin e jetës sonë, kalimin e dinjitetshëm nga kjo botë, dhe ky libër i shkruar nga vetë ne, mbanë shifrën e derës së përjetësisë. Referencat për këtë libër që shkruajmë i zgjedhim ne. Në versionin përfundimtar të këtij libri, s'mund të hedhim fajësi për rrethin, shoqërinë, kohën, apo rrethanat.

Për të qenë autor të një libri të shkëlqyeshëm, i cili determinon vendin tonë në përjetësi, duhet të jemi lexues aktiv, çdoherë në kërkim të dijes së dobishme. Fundja, njohuritë e marra, veprimet e kryera, do të regjistrohen në librin final që përfundimisht do të përcaktojë kush jemi dhe ku përfundimisht do të shkojmë.

¹ Familja dhe ndikimi i saj te fëmijët dhe shoqëria, B. Halili <https://www.kultplus.com/opinione/familja-dhe-ndikimi-i-saj-tek-femijet-dhe-shoqeria/> 9 korrik, 2019.

² Robert. B Wirts, The Importance of Education, 2018.

³ Suzanne Bouffard, THE MOST IMPORTANT YEAR, Pre-Kindergarten and the Future of Our Children, 2017

⁴ Nimra Basit, 15 Reasons Why Knowledge Is Important, July 2023.

Arsimi, ky mision që nuk ecën dot para pa edukim

Bardha Kqiku-Luma

Arsimi i vetëm pa besimin si prijës dhe mbështetës në rrugën e kësaj bote të madhe dhe të mistershme, nuk e sjell edukimin e mirëfilltë dhe lumturinë e shumëkërkuar dhe si i tillë nuk mund ta rregullojë jetën në çdo aspekt.

Zoti i Gjithësisë e krijoi njeriun në formë të kompletuar, ashtu që gjithçka që ekziston në këtë univers të jetë në dobi të tij, por dhe ai të jetë në shërbim dhe mbrojtje të mjedisit që e rrethon. Me anë të mendjes dhe punës së vazhdueshme, ai (njeriu) çdoherë ka qenë në krye të çdo gjëje. Zbulimet, hulumtimet dhe secila arritje tjetër e ka ngritur atë në aspektin shkencor dhe intelektual, por jo gjithmonë e ka përsosur edhe në aspektin shpirtëror, moral dhe edukativ.

Dituria dhe ngritja arsimore me të vërtetë e ka lehtësuar aspektin financiar dhe ekonomik të njeriut, ka kursyer kohën e humbur, ka kthyer hekurin dhe xehet e tjera në pasuri dhe madhështi, ka afruar vende dhe popuj përmes rrugëve dhe mjeteve të ndryshme transportuese dhe komunikative. Mirëpo ky arsim i vetëm pa besimin si prijës dhe mbështetës në rrugën e kësaj bote të madhe dhe të mistershme, nuk e sjell edu-

kimin e mirëfilltë dhe lumturinë e shumëkërkuar dhe si i tillë nuk mund ta rregullojë jetën në çdo aspekt. Arsimi si i vetëm nuk mund ta largojë egoizmin dhe cinizmin e njerëzve, tendencat që e çojnë në të keqen, sjelljet dhe shumëçka tjetër, prandaj është e nevojshme që njeriu të ketë lidhje me besimin në mënyrë që të jetë i arsimuar dhe edukuar njëkohësisht. Allahu në Kuran thotë: “...Allahu do t'i ngre në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija.” (El-Muxhadele, 11).

Njeriu ka nevojë për dituri që ta njohë Krijuesin e gjithë kësaj mrekullie, pastaj veten si njërën ndër mrekullitë e kësaj krijimtarie të përsosur. Konditat dhe rregullat të cilat na i mëson Islami na bëjnë që ne të kemi sjellje të matur dhe të hijshme me çdokënd, pa dallim se a është qenie njerëzore, kafshë, bimë apo ndonjë gjallesë tjetër. Andaj Allahu xh.sh. në librin e Tij na thotë: “...Thuaj a janë të



barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”
Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”
 (Ez-Zumer, 9).

Me këtë ajet, Zoti i Plotfuqishëm, krahason në formë pyetëse këto dy kategori njerëzish. Dhe në një ajet tjetër, Ai na e bënë më të qartë këtë krahasim duke thënë: *“Nuk janë të barabartë i verbëri dhe ai që sheh. Dhe as errësirat e drita. E as hija me vapën. E nuk janë të njëjtë as të gjallit e të vdekurit, Allahu bën të dëgjojë atë që do, e ti nuk mund ta bësh të dëgjojë ai që është në varr.”* (Fatir, 19-22).

“Injoranca i përngjan verbërisë, ndërsa dituria shikimit, injoranca është si errësira, ndërsa dituria si drita, injoranca i përngjan vapës vrasëse, ndërsa dituria hijes shpëtuese, injoranca është vdekje, ndërsa dituria jetë. Nuk ka mundësi që dy të kundërta të bashkohen në një vend.”¹

Gjithashtu edhe i Dërguari i Allahut na ka porositur në marrjen e diturisë duke thënë: *“Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman.”*²

Arsimi së bashku me besimin na mësojnë që kur gjendemi në fatkeqësi dhe probleme të ndryshme t'u bëjmë ballë atyre me durim dhe qetësi, e jo të dalim jashtë kontrollit dhe jashtë arsyes, duke përdorur medikamente dhe droga të ndryshme për qetësim dhe për harresë (ashtu siç e shohim në botën tonë moderne). Ky arsim me besim na forcon anën morale dhe shpirtërore, psikike dhe mendore.

Allahu xh.sh. në një ajet kuranor thotë: *“E kur e godet njeriun ndonjë e keqe (ndonjë dëm apo fatkeqësi), ai e lut Zotin e vet duke kërkuar ndihmë vetëm prej Tij...”* (Ez-Zumer, 8), apo ajeti tjetër: *“Thuaj: “O robërit e Mi që keni besuar, kini frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e Allahut është e gjerë, ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”* (Ez-Zumer, 10).

Arsimi është domosdoshmëri e individit dhe shoqërisë, mirëpo ne jemi dëshmitarë të shumë rasteve të cilat na tregojnë se edhe pse njeriu ka arritur shkallën më të lartë arsimore prapëseprapë ka rënë pre e cytjeve dhe ligësive, dhe në të shumtën e rasteve u është nënshtruar atyre, duke bërë shkatërtime në tokë dhe në vetë njerëzimin. Madje, me një arsim të tillë ai mund të bëhet edhe më i rrezikshëm për

Arsimi së bashku me besimin na mësojnë që kur gjendemi në fatkeqësi dhe probleme të ndryshme t'u bëjmë ballë atyre me durim dhe qetësi, e jo të dalim jashtë kontrollit dhe jashtë arsyes, duke përdorur medikamente dhe droga të ndryshme për qetësim dhe për harresë.

shoqërinë, sepse fiton njohuri që e ndihmojnë për të arritur te qëllimet personale në dëm të shoqërisë, ngase ndërgjegjja atë nuk e qorton, andaj është në gjendje që të gjitha të ligat t'i veprojë, kur e di se askush nuk po e shikon e po ashtu as ligji nuk arrin ta dënojë. Për këtë, Allahu xh.sh. thotë: *“Por jo, ai është plot argumente të qarta në zemrat e atyre që u është dhënë dituria, e argumentet Tona nuk i mohan kush pos të shfrenuarve.”* (Ankebut, 43).

Arsimi i vërtetë është ai arsim i cili udhëzon në besim të vërtetë, të drejtën e mbron dhe sjelljet e njeriut i përmirëson, moralin e tij e ngrit për të mirë, dhe punon gjithmonë në dobi të shoqërisë. Kështu, me të, pajis veten tënde me bukurinë e diturisë, me sjellje korrekte dhe me moral të lartë, me shpirt qetësinë e vazhdueshme, me qëndrimi plot respekt, me përlulësinë (ndaj Krijuesit), modestinë (ndaj njerëzve), përqendrimin në rrugën e drejtë e të qartë, duke rigjallëruar kështu të brendshmen dhe të jashtmen (me këto kualitete), dhe duke lënë të gjitha karakteristikat të cilat i kundërshtojnë ato.³

Ai mundëson formimin e një individi me vlera të kompletuara dhe në dobi të vetës dhe shoqërisë njerëzore. Ne çdoherë themi se botës i nevojitet paqe, dashuri e afërsi më e madhe mes njerëzve, duke i parë çrregullimet dhe shkatërrimet që po ndodhin në mesin tonë çdo ditë e më shumë. Mirëpo në anën tjetër, ne nuk po punojmë aq sa duhet që kjo botë të përmirësohet dhe të largohen të këqijat dhe të ndytat që po shkaktohen po nga vetë ne (njerëzit). Andaj arsimi dhe edukimi janë dhe duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, sepse vetëm kështu mund të

ecim përpara dhe mund t'i ofrojmë botës qetësi dhe zhvillim. Feja islame është e tillë që mundohet të largojë dhe të parandalojë çdo ves dhe çdo të keqe nga individi dhe shoqëria, duke iu ofruar atyre një program, i cili përmban gjithçka që nevojitet, si në aspektin edukativ, arsimor, moral, shpirtëror, etik-njerëzor etj..

Zoti i Gjithësisë thotë: *“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe.”* (El-Maide, 3).

1 Dr. Jusuf el-Kardavi, *“Jeta hyjnore dhe dituria”*, Prishtinë, 2014, fq. 64.

2 Sunenu Ibën Maxhe, nr.224.

3 Bekër Ebu Zejd, *“Stolia e kërkuesit të diturisë”*, Prishtinë, 2010, fq. 27.

Kriza e arsimit në (peri)udhën digjitale

Ilaz Hajra – Lumi

Sfera e arsimit gjendet përballë një hovi të zhvillimit teknologjik, jo rrallëherë i pamëshirshëm, i imponueshëm dhe krijues i varëshmërisë. Aq dinamik di të jetë, saqë nuk bëhet fjalë për largim a ndalim nga të gjitha format e ekspozimit ndaj saj, por mund të mendohet vetëm kufizimi apo menaxhimi me/në të.

Koha dhe hapësira vijimisht përgjatë gjithë rrjedhës historike janë mvëshur me kontekstin, i cili ka pasqyruar besimin, mendësinë dhe kulturën e epokave, popujve, fiseve, vendeve, grupeve, e të ngjashme. Kundruall gjykimit, mbi kontekstin vend dhe kohë, kanë rezultuar interpretime të ndryshme, madje polarizime të thella që kanë përfunduar në ndarjen në shtresa të llojllojshme shoqërore, e që ka çuar deri në lindjen e krizave sociale.

Kësisoj, edhe sfera e arsimit gjendet përballë një hovi të zhvillimit teknologjik, jo rrallëherë i pamëshirshëm, i imponueshëm dhe krijues i varëshmërisë. Aq dinamik di të jetë, saqë nuk bëhet fjalë për largim a ndalim nga të gjitha format e ekspozimit ndaj saj, por mund të mendohet vetëm kufizimi apo menaxhimi me/në të. Pra, edukimi medial si koncept duhet të promovohet jo vetëm brenda çarqeve akademike e institucioneve arsimore apo organizatave joqeveritare, mirëpo çdo familjeje i takon të formojë individë të vetëdijshëm dhe të edukuar medialisht.

Koha e ekspozimit para mjeteve teknologjike, qasja e lehtë dhe e shpejtë, si dhe kreativiteti i ambalazhuar i aktuales si normale janë shkaqe të cilat na shpijnë drejt një krize arsimore, ndonëse më shumë edukative, në (peri)udhën digjitale. Ndaj, mohimi i këtij realiteti, shmangia nga teknologjia, pakujdesia dhe neglizhenca karshi këtyre faktorëve paraqet rrezikun e të jetuarit me një botë paralele, imagjinare e fiktike, njëlloj si shndërrimi në krijesa robotë.

(Peri)udha digjitale është e pashmangshme, ani pse e menaxhuar. Menaxhimi i mirëfilltë e ndihmon tejmasë sistemin arsimor, i motivon të gjithë akterët brenda sistemit, si dhe vë në pah potencialin e secilit prej tyre. Mosmenaxhimi ose thënë më saktë të dalët nga kontrolla e këtij koncepti prodhon dëme të pariparueshme, sa ndikon edhe në personalitetin e njeriut, qasjen dhe konceptin e tij ndaj jetës, e kështu me radhë.

Ashtu si çdo krizë tjetër, edhe kriza në arsim, vë në pah katër elemente fundamentale: shpirtëroren, njerëzoren, emocionale dhe të gabuarën. Derisa, roboti që nuk ka shpirt, s'është njeri, s'ka emocione, është i pagabueshëm, përgjigjet saktë në çdo pyetje, kemi njeriun i cili ka shpirt dhe leksionin e mbështjellë me një frymë që i jep gjallëri temës e përmbajtjes, emocionohet varësisht situatave e rrethanave në të cilat ndodhet, si dhe gabon, për të treguar se ne mësojmë nga njëri-tjetri, ai që jep dije mëson nga nxënësit e tij, këtu shfaqet modestia, pafundësia e dijes, komponenta e ndërveprimit, eliminimi i një autoriteti të pakontestueshëm, etj..

Për fund, Inteligenca Artificiale duhet të përdoret për të ndërtuar njohuritë, dijet, shkathhtësitë, kompetencat, zotësitë dhe shprehitë individuale, gjithherë me qëllim që t'i shërbejmë shoqërisë. Konsiderimi i Inteligjencës Artificiale si klimaks i çfarëdo lloj zhvillimi mund të na dërgojë në humbjen e humanes, shpirtërores, emocionale dhe gabimit si mangësi që sjellë modesti. Me fjalë të tjera, dehumanizimi ka vetëm një rrugë, e ajo është tjetërsimi i botëkuptimit dhe perceptimit të njeriut për veten e jetën.

Frika nga dështimi i madh në arsim

Entela Hidri

Ku po dështon arsimi në vendin tone? Ku kemi gabuar? Çfarë duhet ndryshuar që arsimi të rimëkëmbet dhe rinia mos ta braktisë vendin?

“Kur isha e re kisha ëndrra. Nga banka e shkollës dola me fjali Donkishoteske se do ta rregulloj botën, kurse tani mendoj se kam nisur të kem vetëm dëshira... Mësues, ndihmës dhe pedagoge, ndihmojeni arsimin dhe shkollën, ndihmojini fëmijët tanë ta duanë vendin dhe veten, mos na i detyroni fëmijët të shkojnë...”

Arsimimi në çdo vend që ende s’e ka mbyllur ciklin e tranzicionit, ashtu si edhe në Shqipëri dhe kudo, ka sfidat dhe vështirësitë e veta, por pyetja që lind dhe vështirësia e vërtetë është: “A do të dimë t’i marrim reformat dhe hapat e duhura?!”, që sigurisht se kemi dëgjuar e lexuar shumë për problemet, sfidat dhe perspektivat e arsimit në përgjithësi dhe të arsimit shqip në veçanti. Mirëpo, a e dimë rëndësinë e tyre?

Arsimi nuk është vetëm kushte, mësimdhënie, dosje dhe fead-back. Arsimi funksionon dhe është i tillë edhe kur të gjithë funksionet e tij në përmbajtjet dhe kushtet e nevojshme të funksionojnë sa më mirë. Shpesh implementohen dhe zbatohen strategji afatshkurtra, të cilat për pak vite rindryshohen pa parë ende fryte dhe produkt.

Një ndër pikat e dobëta të arsimit është anësia partiake. Për shkak të kësaj anësie ne shikojmë trajtime të diferencuara dhe paaftësi profesionale të mësimdhënësit, që si rrjedhojë ndrydhen meritokracinë në arsim, mbysin personalitetin dhe paaftësojnë individin në fjalë. Pastaj ndikojnë edhe te vendimi në gjetjen e universiteteve. Në Shqipëri së fundmi po shkollohen vetëm fëmijët e shtresës së mesme dhe të ulët ekonomike, si rrjedhim, te ky nivel nis edhe standardi intelektual i nxënësve sot, dhe i klasës së të shkollluarve nesër.

Fakti që një mësues si profesionist hyn në pazare me shifra për notat, pra në parim, një notë që duhej vështirësish të fitohej, mundet lehtësisht të blihet, pra na duhet të marrim vendime se si dhe ku do kategorizojmë problematikat. Pyetja që lind natyrshëm është nëse ka rënë sistemi dhe se ky vend, a mos e ka bazën të arsim që është i korruptuar, si hallka e parë e çdo sistemi.

Buxheti i shtetit për pagat e mësuesve duhet të ngrihet patjetër, pasi pagat e ulëta dhe pamjaftueshmëria ekonomike i hap derën tolerimit dhe mitmarrrjes.

Arsimi shqiptar ka nevojë për ndryshime radikale, si fillim në burokracirat e dosjeve, më pas në përmirësimin e vetë sistemit arsimor, pra duke nisur që nga ndërtimi i kurikulave të sakta, të qarta shkencërisht dhe nga ana metodike, pastaj duhet të qartësohet pjesa e zbatimit lëndor-kurikular dhe ndër-lëndor. Qytetërimet e ndryshme gjënë e parë që kanë forcuar, investuar, paguar dhe mbështetur është arsimi. Në fakt, politikat arsimore duhen implementuar, testuar dhe ruajtur në plane afatgjata, s’mund të ndërrosh strategji çdo 5 vjet. Që arsimi të përmirësohet, duhet t’i rri larg politika dhe investimet e saj militante. Arsimi do kërkim shkencor, zbatim shkencor dhe shumë DIJE. P.sh. studentët shqiptarë bëjnë studime dhe hulumtime të kopjuara, jo mirëfilli shkencore, si rrjedhojë ata e mësojnë profesionin kur dalin në punë dhe jo gjatë universitetit. Ka ardhur koha që arsimi mos të shihet më si e mirë monetare, financiare dhe kaq, por si e mirë e përgjithshme që ofrohet dhe vilen fryte. Shqiptarët largohen për t’u shkollluar jashtë, sepse këtu s’ka as arsim, as nivele as shkence, as meritë dhe as vjelje të mirash. “Kur do të ndali eksodi?” - lind pyetja. Kur politika t’i rri larg arsimit me militantizëm.

Arsimi nuk është vetëm kushte, mësimdhënie, dosje dhe fead-back. Arsimi funksionon dhe është i tillë edhe kur të gjithë funksionet e tij në përmbajtjet dhe kushtet e nevojshme të funksionojnë sa më mirë.



“Vendi përballet me një kolaps shokues të politikave arsimore, por edhe të shoqërisë në tërësi.” Haris Vongli, pedagoge.

Në fakt, një tjetër problem që lind dhe nuk merr dot zgjidhje, sepse është problem global, është edhe teknologjia dhe telefonat bashkë me rrjetet sociale, por a e zgjidhim dot ne këtë problem me marrjen e celulareve në shkollë? Nuk besoj ashtu, pasi ne sjellim dhe kemi edhe faktet e një telefoni të dytë. Nëse mësuesi e shikon arsimin si mision dhe mësimdhënien si art, atëherë ai do t'i angazhojë aq shumë fëmijët sa ata do ta duan më shumë dijen reale se atë virtuale. Këtë e them nga eksperiencia ime mbi 20 vjeçare në drejtim arsim të mesëm dhe universitar.

Para 4 vjetësh kam kryer një studim se si mund t'i përdorim dijet dhe teknologjinë, ku disa nga metodat janë edhe përdorimi i e-bookeve, përdorimi i klasave virtuale ku detyrat hidhen edhe për nxënësin e pavëmendshëm i cili si di ato, jepen edhe instruksione shtesë në ndihmë të procesit të të nxënës. Nga ana tjetër ne kemi edhe kryerjen reale dhe hulumtimet e tregut dhe të lëndëve me anën e teknologjisë, vërtet do të harxhojnë orë të tëra me teknologjinë, por jo në komunikime nonsens dhe në humbje dhe zbrazje emocionale dhe mendore, por edhe me anën e studimit, hulumtimit dhe përmbushjes arsimore. Duam, apo nuk duam, ne duhet t'i japim krah dhe jetë teknologjisë, sepse jemi në epokën digjitale, ku robotizimi dhe teknologjia po e bëjnë jetën dhe erën e re.

Në nivelin studiues e akademik, ne kemi mbetur në nivelin e kopjimit, si në legjislacione ashtu edhe në kurikula nga vende të ndryshme të botës dhe Evropës, por ne e dimë mirë se ne kemi nevojë për rrënjësime në themele të sistemit arsimor shqiptar. Ne nuk prodhojmë dot specialist të lartë dhe akademike të vërtetë. A ka më artistë që prodhojnë art të shëndetshëm? Studiues që ndërmarrin studime serioze? A ka

më salla plot që ndjekim me kërshtëri një pësjtjellim kimik, një risi, një gjetje?

Ndërrimi me themel në arsim do të vijë kur ne t'i bëjmë disa pyetje esenciale vetes:

Çfarë i duhet një nxënësi në jetë? Për çfarë po e përgatit arsimi ynë? A i vlen dhe a i njihet ky arsim në jetë? A i njihet në botë, pse nuk njihet, a del i lumtur dhe profesionist nga ky arsim? A arrin të shkollohet në profesionin që do? E shumë pyetje të tilla si më lartë.

Arsimi shqiptar nuk njihet në botë pasi që, nuk ka botë akademike dhe studime të mirëfillta, nuk përgatit profesionistë, drejtohet nga të paafte dhe më e rëndësishmja në Shqipëri, askush nuk ndihmohet të shkollohet në vendin e duhur, si dhe nuk funksionon këshillimi i karrierës.

Madje një ndër pikat më gri është fakti se ne nuk pranojemi në Evropë për shkak edhe të dështimit të mirëfillt në arsim.

Arsimi dështon edhe për shkak edhe të mosfunksionimit të duhur të hallkës psikologji, si nga ana e viteve akademike, ku duhen më shumë lëndë psikologjike, jo libra dhe dije skolasitike, por reale. Funksionimi i suksesshëm i kësaj hallke bën që të kemi mirëqenie më të mirë të nxënësve dhe si rrjedhojë më shumë produktivitet. Një hallkë tjetër ku arsimi nuk ka funksionuar si duhet është shtimi i shkresave dhe ulja e cilësisë. Mësuesi mbytet në shkresa e në dosje dhe s'ka më kohë e hapësirë për cilësi mësimdhënieje.

Të prodhosh dije është një gjë dhe të fabrikosh dëftesa dhe diploma, është një gjë tjetër. A do të mundemi dot ndonjëherë ne të prodhojmë arsim dhe siguri? A do të mundim vallë në dekadat që vinë t'i mbajmë shqiptarët këtu dhe ta bëjmë këtë vend, sepse ne e dimë në 10 vjetët e fundit ata që largohen më së shumti janë studentët, që do të thotë rinia, që do të thotë... Në rastin konkret themi se shpresa vdes e fundit, se dritë shikojnë vetëm utopistët.

Një minutë zi për arsimin shqiptar dhe për fëmijët e Shqipërisë që dergjen rrugëve të botës në rendje të një jete, ndoshta më të mirë ose vetëm jetë...

Bibliografia:

- Mimiza Ndoj, “Arsimi në Shqipëri”, Tiranë, 2017.
- Save the children, “Zhvillimi i Arsimit Gjithëpërfshirës në Shqipëri, një vështrim konciz”.
- Analizë e rezultateve të Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve 2000-2012, “Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri”, Tiranë, 2015.
- Raport studimor përballimi i sfidave të arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri, Tiranë, 2016.

Web:

- <https://www.balkanweb.com/arsimi-ne-shqiperi-pedagogia-skemat-kane-deshtuar-per-kaq-vite-basha-do-te-nderhyjme-urgjentisht-per-tju-mbeshtetur-me-trajnimet-e-praktikat/>
- <https://www.portalishkollor.al/news/arsimi-parauniversitar-terma-dhe-perkufizime>
- <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/arsimi-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>
- <https://www.balkanweb.com/emigracioni-boshatis-shkollat-ne-shqiperi-nxenesit-ne-arsimin-parauniversitar-rane-me-37/>

Kuttabet, institucionet e para shkollore në historinë islame

Fatime Hafiz

Para Islamit, arabët i kushtonin vëmendje të veçantë rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre, duke u përpjekur t'u jepnin bazat e arsimit, shkrimit dhe leximit. Me ardhjen e Islamit, vlera e diturisë u ngrit lart, u nxitën pasuesit e fesë islame të mësonin fenë e tyre, e po ashtu t'u mësonin atë edhe fëmijëve të tyre. Xhamitë ishin qendrat e para arsimore ku merrej dija fetare, mësohej përmendsh Kurani, si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët e vegjël. Kjo është edhe periudha ku do të shikojmë mësues të cilët do të punonin vullnetarisht për t'u dhënë dijen brezave të parë myslimanë. Por do të vërejmë se mësimi i fëmijëve të vegjël brenda xhamisë nuk do të vazhdojë gjatë, për shkak se ata nuk e mbanin pastër xhaminë. Për këtë arsye, atyre u qe caktuar vend i veçantë jashtë xhamisë, ku mund të merrnin diturinë fetare, ndërsa në xhami jepej mësim për të rriturit si dhe kryhej falja e namazeve ditore. Vendi në të cilën fëmijët filluan të merrnin diturinë fetare u quajt KUTTAB - KETATIB. Fillimisht kuttabet ishin të pakta në numër, por me zgjerimin e kufijve të shtetit islam, filluan të shtoheshin edhe ato, me qëllim që t'u mësonin myslimanëve të rinj fenë e re islame.

Kuttabet gjatë sundimit të Salahuddin el Ejubit do gjenin përhapje të gjerë dhe do të luanin rol të rëndësishëm për të edukuar dhe arsimuar brezat e rinj me frymën sunite, duke u bërë barrierë kryesore kundër arsimit shiit, i përhapur gjatë asaj kohe në Egjipt dhe Sham.

Kuttabet ishin cikli i parë arsimor që ndiqnin fëmijët e vegjël të cilët nisin udhëtimin e

tyre në fushën e arsimit. Qëllimi i tyre kryesor ishte mësimi përmendsh i Kuranit dhe krahas kësaj, mësohej edhe shkrim-leximi.

KUTTABET NË ATË KOHË ISHIN DY LLOJESH:

Lloji i parë ishin kuttabet private, ku prindërit dërgonin fëmijët e tyre për të mësuar në bazë të një pagese të caktuar, ose mund të ishin edhe kujdestarë të cilët ishin të ngarkuar që të përkujdesen ndaj fëmijëve. Kuttabet nuk zhvilloheshin kurrë brenda xhamive, duke pasur parasysh këshillat dhe vërejtjet e shumta për t'i shmangur fëmijët prej xhamive, meqë fëmija nuk mund të durojë për kohë të gjatë nevojat personale dhe mund ta ndotë xhaminë; ashtu si edhe mund të shkarravisë dhe të nxijë muret. Për këtë, Imam Maliku ka thënë: "Nuk e shikoj të lejuar (vajtjen e fëmijëve në xhami) meqë nuk mund t'i mbajnë gjatë nevojat fiziologjike."

Kuttabet duhet të zgjidheshin në vende të dukshme, ku kalonin kalimtarë të shumtë dhe të ishte e lehtë për t'i kapur syri, jo nëpër rrugica dhe larg syve të njerëzve.

Kuttabet kanë pasur rregullore të tyre të brendshme për t'u zbatuar prej fëmijëve. Personi kujdestar mbi fëmijët brenda kuttabet, kishte për detyrë të ruante ekuilibrin mes fëmijëve të cilët vinin prej familjeve me gjendje ekonomike të ndryshme prej njëritjetrit, për të mos lejuar që të binte në sy pabarazia ekonomike-sociale mes fëmijëve. Nuk lejohej që fëmijët të merrnin ushqim me vete, si dhe nuk lejohejshin paratë për të blerë

Me ardhjen e Islamit, vlera e diturisë u ngrit lart, u nxitën pasuesit e fesë islame të mësonin fenë e tyre, e po ashtu t'u mësonin atë edhe fëmijëve të tyre.

gjërat që u duheshin gjatë qëndrimit në shkollë, sepse kjo ndikonte negativisht te fëmija i varfër, i cili mund të kthehej në shtëpi zemërtlyer dhe i pakënaqur me të ardhurat e prindit të tij. Nëse ndonjë prej fëmijëve donte të hante, merrte leje dhe shkonte në shtëpi i shoqëruar. Në këtë mënyrë, fëmija i varfër nuk shikonte se çfarë hante fëmija i pasur. Nuk lejohej për fëmijët e pasur të merrnin dekkah (tavolinë e vogël) me vete.

Një prej rregullave të forta brenda kuttabeve ka qenë që të gjithë fëmijët që merrnin pjesë, duhej të kishin sjellje pozitive. Nuk lejohej asnjë i cili mund të sillte probleme në lidhje me moralin, sepse kjo mund të ndikonte negativisht te fëmijët e tjerë, dhe pasi ta merrnin vesh njerëzit jashtë shkollës, binte reputacioni i kuttabeve, gjë e cila mund të sillte pakësimin e numrit të nxënësve apo vinte edhe deri në mbyllje të saj. Askush prej prindërve nuk do të donte që fëmija i tyre të ndikohej prej ndonjë fëmije të çrregullt.

Mbikëqyrësi i shkollës duhej të ushtronte kontroll të rreptë për të mos lejuar fëmijët të merreshin me lojëra në vend se të mësonin. Shitësit nuk lejoheshin të qëndronin përpara shkollës për të mos tërhequr vëmendjen e fëmijëve, si dhe nuk lejohej të flisnin me kalimtarët, por të merreshin vetëm me mësim.

Kuttabet nuk merreshin vetëm me procesin mësimor, por pranë tyre kishte edhe mjekë, të cilët kontrollonin fëmijët nga ana e shëndetit. Në rast se ndonjë fëmijë rezultonte i sëmurë, lajmërohej familja. Kontrollet ishin më të rrepta gjatë periudhave të epidemive.

Personi
kujdestar mbi
fëmijët brenda
kuttaves, kishte
për detyrë të
ruante
ekuilibrin mes
fëmijëve të cilët
vinin prej
familjeve me
gjendje
ekonomike të
ndryshme prej
njëri-tjetrit, për
të mos lejuar që
të binte në sy
pabarazia
ekonomike-
sociale mes
fëmijëve.

Fëmijët ishin të moshave të ndryshme, kishte prej tyre edhe fëmijë të vegjël, të cilët ishin të paaftë të mbanin edhe sendet e tyre, dhe e kishin të pamundur të bënin rrugën vajtje-ardhje për në shkollë. Për këtë arsye caktohej një përgjegjës, i cili i merrte fëmijët nga shtëpia për në shkollë dhe anasjelltas. Shoqëruesi i fëmijëve duhej të ishte burrë i martuar.

Lejohej marrja e dhuratave prej mësuesve në rast se ndonjë fëmijë kishte dëshirë t'i dhuronte diçka mësuesit, por ishte rreptësisht e ndaluar për mësuesin t'u kërkonte fëmijëve t'i bënin dhurata në formë materiale apo monetare.

Mësuesi duhej të ishte jo vetëm hafëz i Kuranit, por duhej të dinte shumë mirë shkrimin dhe matematikën, ngase prindërit i dërgonin fëmijët në shkollë për të marrë dije prej mësuesve, krahas mësimin të Kuranit. Mësuesi duhej të ishte me moral të lartë, i martuar dhe i ndjeshëm. Nuk lejohej për të pamartuarit të hapnin kuttabe për t'i mësuar fëmijët, vetëm nëse ishte i moshuar.

Duke qenë se fëmija në këtë moshë ka si model mësuesin, kushtet ishin të rrepta në përzgjedhjen e mësuesve, të cilat duhej të zbatoheshin kur zgjidhej mësuesi. Një mësues i mirë, e reflekton këtë te fëmijët të cilët i mëson dhe edukon.

Mësuesi duhej të kishte akide/besim të pastër. Kështu, dijetari El Subki, këshillonte: "Prindërit në radhë të parë duhet të interesohen për akiden/besimin e mësuesit të fëmijëve të tyre, sepse një mësues me akide/besim të prishur, prish edhe fëmijët."



Mësuesi duhej të ishte besnik, ruajtës i amanetit, duhej t'i mësonte dhe edukonte fëmijët sa më mirë, të ishte i butë, i ndjeshëm me ta, si dhe të ishte për ta si një prind.

Lloji i dytë i kuttabeve ishin ato ku mësonin fëmijët jetimë, fëmijët e të varfërve si dhe të ushtarëve të varfër. Shpenzimet e tyre mbuloheshin prej të ardhurave të vakëfeve të caktuara për këtë punë.

Ky lloj mësimi mori vëmendje të posaçme gjatë gjithë sundimit të dinastisë ejjubiane dhe memalikëve. U ndërtuan kuttabe të shumta me qëllim që të arsimohej ajo shtresë e shoqërisë, e cila e kishte të pamundur t'u ofronte fëmijëve të tyre arsim, siç ishin jetimët, fëmijët e të varfërve apo edhe të papunëve. Ndihamë që merrte fëmija në këto kuttabe mund të ishte monetare, por mund të ishte dhe në forma të tjera. Ndihamë mund të përfitonte edhe familja në rast se familja nuk kishte tjetër person ku të mbështetej përveç fëmijës derisa të rritej dhe të ishte i fuqishëm për të fituar prej punës së tij.

I pari që ndau copë toke vakëf për këta fëmijë të vegjël është Salahuddin el Ejubi. Historia ka sjellë rastin kur Salahuddini dëgjoi një fëmijë të vogël të lexonte bukur Kuranin. Dhe kjo ka hyrë si rasti i parë në histori në Egjipt ku ndahet një copë tokë vakëf "për hir të jetimëve dhe të varfërve". Kjo shërbeu si shembull për njerëzit më pas. Makriziu do të shënonte se në vitin 580 hixhri, gjykatësi El Fadl, ndërtoi medresenë e tij në të cilën mësoheshin dije të ndryshme fetare dhe shkencore. Anash saj ndërtoi kuttaben ku mund të mësonin Kuranin, shkrimin dhe matematikën fëmijët jetimë; gjithashtu edhe Emir el Kamili ndërtoi kuttaben. Po kështu Makriziu, në veprën e tij rreth historisë së Kajros, përmend medresenë dhe kuttaben e ndërtuar në rrugën El Nihasin (sot Muezzeddin Ilahi) prej Zahir Bebras. Ajo mbulonte të gjitha shpenzimet për fëmijët, si ato monetare, ashtu edhe ato në veshje, dhe atë, dy herë në vit, në verë dhe në dimër. Pas kësaj, gjatë periudhës së sundimit të memalikëve, fillon dhe merr përhapje të gjerë ndërtimi i kuttabeve private prej sundimtarëve të të gjitha rangjeve. Pranë çdo xhamie apo medreseje, hankave dhe zavijeve, do ndërtohej edhe një kuttabe për jetimët dhe të varfrit. Jo vetëm që u



Lejohej marrja e dhuratave prej mësuesve në rast se ndonjë fëmijë kishte dëshirë t'i dhuronte diçka mësuesit, por ishte rreptësisht e ndaluar për mësuesin t'u kërkonte fëmijëve t'i bënin dhurata në formë materiale apo monetare.

ndërtuan kuttabe të reja, por edhe pranë xhamive të para, u bënë shtesa të cilat u kthyen në kuttabe. Në fund të çdo dite mësimi, mësuesi dhe fëmijët që mësonin në këto kuttabe, bënin dua për bamirësin që ua kishte mundësuar mësimin. Por do të shikojmë edhe raste kur bamirës para se të vdisnin, kishin ndërtuar kuttaben pranë tyre për të tyre dhe kishin lënë si amanet që me ujin ku laheshin rrasat në të cilat kishin shkruar fëmijët Kuranin, të vaditej varri i tyre.

Fëmijët jetimë që zgjidheshin për të mësuar në këto kuttabe ishin prej familjeve myslimane, të cilët kishin dëshirë që fëmija i tyre të mësonte. Në disa raste, në disa kuttabe, zgjidheshin fëmijë jetimë, të cilët vinin prej familjeve me njëfarë pozite. Numri i fëmijëve që mësonin ishte i caktuar prej personit i cili mbulonte të gjitha shpenzimet e tyre. Në fillim pranoheshin fëmijët jetimë, dhe në rast se mbeteshin vende bosh plotësohej me fëmijë të varfër.

Siç e shikojmë, bamirësit i kushtonin rëndësi mësimi të Kuranit prej jetimëve dhe kuttabet ishin pikërisht institucioni i duhur për ta përbushur këtë mision.

Përktheu: Klodiana Xhaferraj

Kontributi i Ibën Shatirit (1304 – 1375) për zhvillimin e shkencave

M.sc. Artan S. Mehmeti

Ibën Shatiri ishte njëri ndër shkencëtarët më të mëdhenj gjatë historisë, i cili dha një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe modernizimin e shkencës. Me intelektin e tij arriti të krijoi shtigje të reja për kuptimin dhe interpretimin e astronomisë për gjeneratat që do të vinin shekuj më vonë.

Ebu'l Hasan Alauddin Ali ibën Ibrahim Shatiri lindi në Damask të Sirisë. Ai ishte një astronom, matematikan, inxhinier, zbulues dhe inovator, i cili më punën e tij dha një kontribut të madh edhe në gjeografi, përkatësisht kozmografi. Pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi duke punuar si *muvaqqit* në xhaminë qendrore të *emevive* në Damask.

Ibën Shatiri ishte njëri ndër shkencëtarët më të mëdhenj gjatë historisë, i cili dha një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe modernizimin e shkencës. Me intelektin e tij arriti të krijoi shtigje të reja për kuptimin dhe interpretimin e astronomisë për gjeneratat që do të vinin shekuj më vonë. Në kërkim të dijes, ai në moshë të re vizitonte qendrat shkencore si në Aleksandri, Kajro etj.. Në Kajro studioi astronominë dhe matematikën. Megjithatë, formimin intelektual dhe afirmimin i arriti në Damask, ku zhvilloi veprimtarinë e tij shkencore.

Puna shkencore e Ibën Shatirit shënoi kthesë në astronomi, si dhe mund të konsiderohet si revolucion shkencor para se të ndodhte renesanca. Për dallim nga astronomët e tjerë të kohës së tij, ai nuk mbështetej shumë në parimet teorike të kozmologjisë, filozofisë natyrore apo fizikës së Aristotelit, por Ibën Shatiri u angazhua në punimin e një modeli i cili përputhej më tepër me vërtetimet empirike, e që ishte esenca e konceptit të tij planetar. Për dallim nga astronomët e mëhershëm, ai në përgjithësi nuk kishte vërejtje filozofike ndaj astronomisë së Ptolomeut. Pavarësisht se kishte admirim për punën e tij, dhe në pamundësi që t'i anashkalonte hapësirat e



Ibën Shatiri

mospërputhjes së të dhënave të tij me të dhënat e Ptolomeut, ai vazhdoi si shkencëtarët e tjerë arabë me kritika ndaj astronomisë së Ptolomeut, ku këto kritika i ilustroi me shembuj konkretë nga vërtetimet e tij.

Ibën Shatiri ishte astronomi i parë që e prezantoi eksperimentimin në teorinë planetare. Këtë e arriti pasi që i testonte vazhdimisht modelet e Ptolomeut. Kur asnjë prej modeleve të Ptolomeut nuk përputhej me të dhënat që ai i fitonte nga vërtetimet e bëra, atëherë Ibën Shatiri e formulonte modelin e tij origjinal, i cili ishte konform me ato vërtetime. Edhe pse për sistemin e tij ka rezerva se mund të jetë gjeocentrik, ai i eliminoi ekuantin dhe ekscentrikën e Ptolomeut, kurse detajet matematikore të tij ishin identike me ato të

Kopernikut që janë paraqitur në veprën “*De Revolutionibus*”. Koncepti i Ibën Shatirit mbi planetët, si dhe teoria mbi lëvizjen e Hënës nuk kanë dallim me konceptet që i atribuohen Kopernikut rreth 150 vjet më vonë, e për këtë arsye besohet se modelet e tij u adaptuan nga Koperniku në modelin heliocentrik. Po ashtu, dihet se edhe diagramet e Kopernikut për modelin e tij heliocentrik përfshirë edhe shënimet e pikave ishin pothuajse identike me diagramet dhe shënimet e përdorura nga Ibën Shatiri për modelin e tij planetar. Gjithashtu është e evidente që Koperniku përdori të njëjtin koncept të lëvizjes së planetëve për të prezantuar modelin e tij planetar me Diellin në qendër, e që na bën të kuptojmë se Koperniku ishte në dijeni për punën e Ibën Shatirit.

Në veprën e tij të njohur me titull “*Kitab nihajet 'is-su'āl fi tas'hih 'il-usul*”, në mënyrë rrënjësore riformoi modelet e Ptolemeut për Diellin, Hënën dhe planetët, duke bërë prezantimin e vet për Diellin, Hënën dhe planetët. Në këtë prezantim Ibën Shatiri i eliminoi të gjitha ekscentrikat, epiciklet dhe ekuantet në modelin hënor dhe e nisi vektorin (lidhja teorike që mendohet se gjendet midis boshtit dhe qendrës-një vektor për çdo planet) nga pika e mesit të etapës; në këtë veprim ai përdori parimin e rrethit “Çifti Tusi” të Et-Tusit. Veçanërisht modeli i tij i Merkurit është shumë më i rëndësishëm; në këtë model është marrë për bazë një epicikël më i vogël sesa ai i Ptolemeut. Përpjekja e tij për të paraqitur një model më të mirë për lëvizjen e Hënës në krahasim me paraardhësit e tij pati një sukses të mrekullueshëm. Përderisa modelet e shkollës Maragha ishin po aq të sakta sa ishte edhe modeli i Ptolemeut, modeli planetar i Ibën Shatirit ishte modeli i parë që arriti të jetë më superior ndaj modelit të Ptolemeut, për sa i përket përputhshmërisë më të madhe me faktet shkencore. Një tjetër arritje e tij është edhe ndarja e filozofisë natyrore nga astronomia, dhe refuzimi i modelit të Ptolemeut, i cili kishte më tepër baza filozofike sesa shkencore.

Një punim tjetër shumë me rëndësi i Ibën Shatirit është libri me titull “*Zixhu Ibën Shatir*”, që ndryshe njihet edhe si “*Ez-zixh 'ul xhedid*”. Në këtë libër ai shpjegon disa probleme, teori dhe modele astronomike të bazuara në eksperimente, vrojtime dhe përfundime. Këtë libër Ibën Shatiri e shkroi më urdhër të Sulltan Muratit I (sundues osman nga viti 1360 deri më 1389). Në parathënie, Ibën Shatiri përmend burimet nga të cilat ai është bazuar gjatë shkrimit të këtij libri, e që janë: Maslama ibën Ahmed el-Maxhriti, Ibën el-Hajthem, Muhamed ibën Huseini nga Granada, Nasiruddin et-Tusi,

Në territoret e Shamit, Egjiptit, Perandorinë Osmane, si dhe vendet e tjera islame, librat e Ibën Shatirit mbi astrolabin për shekuj më radhë shërbyen si pikë referimi, duke u bërë të domosdoshëm për përcaktimin e kohëve të namazit të myslimanët.

Mu'ajjeduddin el-Urdi, Muhijiddin el-Magribi dhe Kutbeddin esh-Shirazi.

Ibën Shatiri gjithashtu ka shkruar për hartën yjore, si dhe konstruktoi astrolabin të cilin e quan instrumenti universal. Këtë instrument ai e përshkruan në veprën e tij të titulluar “*El-Eshatu el-lami'atu fi'l-'ameli bi'l-'alet'il xhami'ah*”. Një komentim të kësaj vepre e ka bërë astronomi dhe inxhinieri i famshëm osman, Teki'uddini, i cili e kishte futur në përdorim instrumentin universal të Ibën Shatirit në observatorin Ed-Din të Stambollit gjatë viteve 1577-1580. Vlen të theksohet se një astrolab dhe instrument universal që Ibën Shatiri e kishte konstruktuar kanë mbijetuar deri në kohët moderne.

Në territoret e Shamit, Egjiptit, Perandorinë Osmane, si dhe vendet e tjera islame, librat e Ibën Shatirit mbi astrolabin për shekuj më radhë shërbyen si pikë referimi, duke u bërë të domosdoshëm për përcaktimin e kohëve të namazit të myslimanët. Përveç punimeve ku bëhet fjalë rreth konstruktimit të instrumenteve të reja astronomike që kishte zbuluar vetë, ai




Modeli hënor i Ibën Shatirit

këtyre instrumenteve iu kishte bashkangjitur edhe manuale që tregonin mënyrën përdorimit të këtyre mjeteve.

Nga zbulimet e instrumenteve të shumta astronomike nga myslimanët, një vend shumë të rëndësishëm zë edhe instrumenti që njihet si përmbledhësi, të cilin së pari e kishte konstruktuar Ibën Shatiri. Ky instrument u quajt kështu sepse ishte shumë funksional dhe shërbente për shumë qëllime. Instrumenti në mes të tjerash përmbante në vete një alhidade dhe orën diellore polare. Më vonë gjatë kohës së Renesancës në Evropë, ky instrument u bë shumë i njohur. Ai gjithashtu kishte zbuluar edhe lloje kuadrantësh të rinj, siç ishte Kudranti i përsosur (er-rub et-tamm), të cilin e përshkruan në librin e tij me titull *“En-naf’ul-ammi fi’l-‘ameli bi’r-rubb’it-tamm”*. Një model të kuadrantit që ai e kishte konstruktuar për shejh Ali ibën Muhamed ed-Darbandin, është i ruajtur deri më sot në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Ibën Shatiri po ashtu ka shkruar edhe disa libra të tjerë në fushën e astronomisë, si dhe përdorimit të instrumenteve astronomike si: *“Risalet ‘ul-istralab”*, *“Muhtasar fi’l-amali bi’l-istralab”*, *“Idahu ‘ul-mugibi fi’l-ameli bi’r-rub’il-muxhib”*, *“Risalet Nuzhat as Samis fi el-Amel bi ar-Rubi el-Xhamia”*, *“Risalet Kifajet el-Kunua fi el-Amel bi ar-Rubi el-Maktua”* etj..

Një ndër shumë kontributet që Ibën Shatiri i dha zhvillimit të shkencës së astronomisë është përlllogaritja që i bëri pjerrtësisë së boshtit të Tokës. Në vitin 1365 ai arriti të demonstronte me një saktësi të lartë se këndi i pjerrtësisë eliptike të boshtit të Tokës është 23 shkallë e 31 minuta. Kurse vlera e saktë është kalkuluar nga shkencëtarët e shekullit XX, e cila ishte e mundur të bëhej vetëm nëpërmjet kompjuterëve, është 23 shkallë e 31 minuta e 19.8 sekonda. Nga kjo kuptojmë që vlera që kishte dhënë Ibën Shatiri dallon për vetëm 19 sekonda e 8 të qindtat nga përlllogaritja e bërë përmes teknologjisë bashkëkohore që posedojmë ne sot.

Përveç koncepteve planetare dhe përlllogaritjeve astronomike, Ibën Shatiri dha kontribut të jashtëzakonshëm edhe në konstruktimin e instrumenteve astronomike, duke bërë në këtë drejtim avancime substanciale. Ai konstruktioi orë të mrekullueshme diellore për xhaminë emevite në Damask. Instrumenti që ndodhet tash në këtë minare, është kopje identike, e cila është punuar në fund të shekullit XIX, kurse fragmente nga instrumenti origjinal ruhen në kopshtin e Muzeut Kombëtar në Damask të Sirisë. Orët diellore antike tregonin kohën me orë jo të barabarta, ato ndryshe quheshin edhe orë të përkohshme të cilat ndryshonin sipas stinëve. Çdo ditë ishte e ndarë në dymbëdhjetë segmente të barabarta, si rrjedhim i kësaj orët ishin më të shkurtra në dimër e më të gjata gjatë verës. Ideja për të përdorur orët me gjatësi të njëjtë kohore gjatë tërë vitit, ka qenë zbulim i Ibën Shatirit në vitin 1371, dhe kjo ishte bazuar në zhvillimet e bëra në trigonometri nga El-Bataniu. Ora e tij diellore ishte e punuar nga mermeri,



Modeli i Ibën Shatirit për paraqitjet e Merkurit, duke treguar shumëzimin e epicikletave në një ndërmarrje të Ptolemeut

kishte madhësinë 2x1 metra dhe kishte një sistem shenjash të gdhendura në mermer, që i mundësonte muvekitit ta lexonte kohën ekuino-ksale, që nga agimi e deri në mbrëmje. Ky koncept i orëve diellore u paraqit në Perëndim 100 vjet më vonë. Ora diellore me përmasa më të vogla, pjesë të instrumentit “Përmbledhësi i Ibën Shatirit”, tani gjendet në Aleppo. Ai është i përforcuar për një kuti që quhet “Sanduk ‘ul-xhavakit” (arka e thesarit), e cila ka përmasat 12x3cm. Ky instrument përdorej për të përcaktuar kohët e namazeve, si dhe për të përcaktuar meridianin lokal dhe drejtimin e Kibles.

Burimet

- Prof. dr. Fuat Sezgin, Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup 2015, f. 140-145.
- Halima Al-ghrari, arkitektët e mendimit shkencor në qytetërimin islam. Vula nga biografitë e dijetarëve myslimanë në periudha të ndryshme, Nga arabishtja në anglisht e përktheu: Abdulaziz Hauaria, Përktheu nga gjuha angleze: Ernal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. B-O-O-K-S, (botimi i dytë) Tiranë 2020, f. 40-44.
- Kontributet muslimane në qytetërimin botëror, përgatitën për botim: M. Basheer Ahmed, Md; Ambasador Syed A. Ahsani; Dilnawaz A. Siddiqui, Phd, përktheu: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimin Islam (AIITC), Tiranë 2019, f. 143-144.
- The Solar and Lunar Theory of Ibn ash-Shatir A Pre-Copernican Copernican Model By Victor Roberts *, Published by: The University of Chicago Press on behalf of The History of Science Society (<https://www2.kenyon.edu/Depts/Math/Aydin/Teach/Fall13/128/PreCopernican.pdf>), (parë për herë të fundit më 25/06/2020).
- https://islamsociology.org/RASI/BEA/Ibn_al-Shatir_BE.html, (parë për herë të fundit më 26/06/2020).
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Ibn_Shatiri, (parë për herë të fundit më 25/06/2020).

Vështrim historik mbi legjitimitetin e kalifatit osman

Ma. Agon Krasniqi

HYRJE

Çështja e kalifatit osman është një ndër çështjet më të diskutueshme mbi bazën e legjitimitetit të saj, se a ishte një kalifat i cili pranohej nga të gjitha shtetet islame, si dhe ky kalifat, a kishte bazë të legjislacionit islam mbi parimet sheriatike. Fillimisht, shteti osman, ishte ngritur mbi suazat e saj që njihet, mes kombinimit të sheriatit dhe urfit (zakonit) turk.¹ Ky kombinim solli edhe bazën e ngritjes së kanunnameve (kodeve), të sulltanëve osman, siç është kodifikimi ligjor i Sulltan Mehmet Fatihut, Selimit I, Sylejmanit I, etj..

Osmanët gjatë shekujve XIV-XVI, si rezultat i sukseseve të tyre ushtarake dhe organizimit shoqëror, kulturor dhe administrativ të saj, luajtën rolin e lidërshit të myslimanëve në botë. Ky parim i tyre mbi bazën e kulturës lidhej për ngritjen e një qytetërimi osman, mbi atë të grumbullimit të dijetarëve islamë në trevat ku sundonin osmanët. Kështu themi se osmanët iu përmbytën qëndrimit se dijetarët kërkojnë medrese, medresetë kërkojnë qytet, qyteti kërkon shtet dhe shteti kërkon një qytetërim. Nga ndërlidhja mbi parimet e dijetarëve osmanë, u skicua edhe legjitimiteti i kalifatit osman, ku disa koncepte më poshtë që do trajtojmë janë specifike kryesore se pse sot ne e njohim shtetin osman, si kalifat.

LIDERSHIPI OSMAN GJATË SHEK. XIV-XVI, HAP DREJT NGRITJES SË KALIFATIT

Lidershipi osman që daton nga shekulli XIV, ndikoi që të ngrihej kalifati osman në shekullin XVI, konkretisht në vitin 1517.

Murati i parë e përdori selinë e kryeqytetit të tij (Edrenesë), me titullin *Daru-l Halife* apo selia e kalifatit, në letrën që i dërgoi beut të Karamanit në vitin 1365.



Sulltan Murati I

Megjithatë ky lidërship osman, kërkonte edhe titullin e kalifit, që shpeshherë përdorej edhe nga sulltanët para Selimit të parë. Hera e parë që u përdor nga osmanët nocioni kalif² ishte në periudhën e Muratit të parë, i njohur si *Hydavendigâr*. Murati i parë e përdori selinë e kryeqytetit të tij (Edrenesë), me titullin *Daru-l Halife* apo selia e kalifatit, në letrën që i dërgoi beut të Karamanit (Karamanogullarëve) në vitin 1365. Kjo ngritje e titullit të kalifit për herë të parë nga Murat Hydavendigari, ndikoi që Hani i Hordhisë së Artë, Khanëbek Hani, t'i referohej Muratit si *Sulltanul Guzat vel Muxhahidin apo Zilullah* (pozitë e kalifit) dhe në anën tjetër Isfendijar beu i Kastamonit t'i referohej si *Hazret-i Hilafet-i menkabet* (pozitë tjetër që përdorej për një kalif). Lidërshipi osman që do të konkretizohej edhe me push-

timin e Konstandinopojës më 29 maj 1453³, ndikoi që myslimanët të lidheshin plotësisht me shtetin osman edhe në pozitën e kalifit, pavarësisht se si kalif zyrtar qëndronte ai i memlukëve. Si rezultat i këtij lidheshi, Kemal Pasha Zade apo Ibën Kemali, i referohet Sulltan Mehmet Fatihut si kalif. Referime të tjera si kalif të sulltanët osmanë i gjejmë edhe në periudhën e Bajazitit të dytë, ku nga emiri i Horasanit cilësohej si kalif, po ashtu edhe nga ana e Jakup Shahut.⁴


Koha se kur daton kalifati osman, si datë e cila shënon edhe fillimin e këtij kalifati, është viti 1517, ku Selimi i parë (1512-1520), ushtroi pushtetin mbi Egjiptin,⁵ ku kjo shënoi edhe fundin e sundimit të kalifit Al Mutawakkil,⁶ i cili sipas një transmetimi i dorëzoi zyrtarisht postin e kalifit, Selimit të parë në xhaminë e Aja Sofisë.⁷ Megjithatë si zyrtarizim i kalifatit osman, shënohet edhe hytbeja në emër të Selimit të parë në qytetin e Kajros në vitin 1517, ku këndohet hytbe në emër të tij, me titullin *Hadimu'l Haramejn esh-Sherifejn*.⁸ Si ngritje e kalifatit shënohet edhe bashkimi i Hixhazit në mënyrë të vullnetshme, ku sherifi i Mekës dhe i Medinës, i dorëzoi çelësat e dy vendeve të shenjta (Mekës dhe Medinës), Sulltan Selimit të parë. Kjo situatë erdhi si

Koha se kur daton kalifati osman, si datë e cila shënon edhe fillimin e këtij kalifati, është viti 1517, ku Selimi i parë (1512-1520), ushtroi pushtetin mbi Egjiptin, ku kjo shënoi edhe fundin e sundimit të kalifit Al Mutawakkil.

rezultat i një sulmi që pritej të realizohej nga portugezët dhe bota arabe e shihte shtetin osman, si shtetin e vetëm që mund t'i shpëronte ata. Kështu periudha e sukseseve ushtarake, por edhe të zbatimit klasik administrativ në vendet ku sundoi shteti osman, ndikoi që arabët të shihnin këtë shtet si ideal për të qeverisur vendin e tyre dhe në anën tjetër ta mbronin nga sulmet e vendeve krishtere, kryesisht të flotës detare spanjolle dhe asaj portugeze. Kështu momenti kur sherifi i Mekës, më 17 korrik 1517, dorëzoi çelësat e Mekës dhe Medinës, shënoi edhe fillimin e një epoke të re për osmanët.⁹

ATRIBIMI I TITUJVE DHE NGRITJA E LEGJITIMITETIT TË KALIFATIT OSMAN

Mbi bazën e sheriatit islam, kryesisht sipas sunizmit, kalifi duhej të rridhte nga familja e kurejshëve, duke u bazuar në hadithin *al-aimma min- Kurejsh* (kreu i myslimanëve duhej të ishte nga kurejshët),¹⁰ ndërsa sipas shiave, kalifi duhej të ishte nga familja e Ehli Bejtit, që rridhnin nga kalifi i katërt i Islamit, Aliu. Megjithatë osmanët, për ngritjen e kalifatit osman, nuk ishin të lidhur nga asnjëri parim. Vlen të theksohet se kjo formë e



përzgjedhjes e kishte humbur rolin nga koha e pushtimit të Bagdadit nga ana e mongolëve në vitin 1258.¹¹ Në këto rrethana, osmanët krijuan një model të ri të legjitimitetit të kalifatit të tyre.

Konceptet bazë që legjitimuan kalifatin osman, lidhen ngushtë me konceptet historike dhe fetare. Nga konceptet që përdorën osmanët janë *hilafet-i ulja* (më i larti prej sundimtarëve) si dhe *hilafet-i kubra*, çka konceptohej si mbrojtja e të gjithë botës islame. Osmanët duke u mbështetur në konceptin e *hilafet-i ulja*, *hilafet-i kubra*, *hilafet-i ruj-i zemin*, ngritën në fund një standard të përgjithshëm të legjitimitetit të kalifatit, ku ia mbështetën *immamat-i uzman* apo titulli “udhëheqësi më i lartë ndër myslimanët”. Ky titull, *immamat-i uzma*, ndryshe njihet si udhëheqësi i myslimanëve pas profetit Muhamed, apo kalifi i shtetit islam.¹² Një mbështetje tjetër e legjitimitetit të kalifatit osman, duke u bazuar edhe mbi parimet e jurisprudencës islame nga shehulislamët e shtetit osman, është edhe titulli *hadimul el Haramejn* apo shërbëtori i dy vendeve të shenjta, Mekës dhe Medinës.¹³ Këto aspekte të përgjithshme ishin një model i kohës për ngritjen e kalifatit osman. Me këtë themi se osmanët krijuan një model të ri të përzgjedhjes së kalifit dhe legjitimitetit të këtij kalifi. Ky model mbështetej në pozitat e atribuuara si *hilafet-i ulja*, *hilafet-i kubra*, *hilafet-i ruj-i zemin*, *immamat-i uzma* dhe *hadimul el haramejn*, tituj këto që legjitimuan pozitën e kalifit dhe kalifatin osman, mbi jurisprudencën islame të kohës, nga shehulislamët osmanë.

KONKLUZION

Lidershipi osman i shekujve XIV-XVI, ndikoi që të jetë shteti më i lartë në mesin e shteteve islame të kohës. Ky lidship solli edhe supremacinë e shtetit, që në vitin 1517 do të merrte të drejtën e kalifatit. Legjitimiteti i këtij kalifati kishte si ndërlidhje të kaluarën historike ww, pasi shumë sultanë osmanë ia dhanë epitetin vetvetes si kalif, apo edhe u quajtën kalif nga sovranë të vendeve të ndryshme. Kjo vërehet me Murat Hydavengidar, i cili i pari përdori termin kalif dhe kryeqytetin e tij (Edrenen), si qendër e kalifatit. Kjo u përdor edhe nga sultanë të tjerë osmanë, si Mehmet Fatihu dhe Bajaziti i dytë. Megjithatë përdorimi i titullit kalif nuk sintetizonte kalifatet zyrtare që njihen në histori, por si një term i cili tregonte supremacinë e tij mbi sovranët e tjerë myslimanë. Kjo supremaci më pas ndikoi që në vitin 1517, të shpallej edhe kalifati osman.

Lidershipi osman i shekujve XIV-XVI, ndikoi që të jetë shteti më i lartë në mesin e shteteve islame të kohës. Ky lidship solli edhe supremacinë e shtetit, që në vitin 1517 do të merrte të drejtën e kalifatit.

Legjitimiteti i kalifatit u arrit si rezultat që mënyra klasike e përzgjedhjes së kalifit nuk ndodhte si më parë. Kjo ndikoi që osmanët të cilët nuk rridhnin nga familja e kurejshëve, të legjitimonin kalifatin e tyre mbi titujt që ia atribuuan vetvetes, çka i bënë ata si udhëheqësit më të lartë të myslimanët. Kështu ky atribut i titujve shënoi ngritjen e kalifatit osman dhe ky shtet tashmë nuk ishte një shtet që mbronte tokat kufitare të tyre, por të drejtat e myslimanëve në të gjithë botën, duke u thirrur mbi parimin e kalifatit islam.

1 Kombinimi ndërmjet shariatit dhe urfit apo zakonisht turk dallohet kryesisht të kodifikimet ligjore të sultanëve osmanë. Shembull i zakonit të përbashkët turk dhe shariatit islam specifikohen në aspektet administrative, kulturore si dhe mënyrës së konceptit të shtetit në shtetin osman. Shih: Halil Inalxhik dhe Günsel Renda. *Qytetërimi Osman I*, Tiranë: Alsar, 2016, f. 164.

2 Nocioni kalif apo halife, konceptohet si udhëheqës i botës islame.

3 Kjo formë e lidshipit osman, me pushtimin e Kostandinopojës më 29 maj 1453, ndikoi masivisht në ngritjen e Sulltan Mehmet Fatihut, si udhëheqësi më i lartë ndër myslimanët. Nga ajo që ofron kronika e Tursun Beut (kronist i periudhës së Mehmet Fatihut), është edhe vargu i shkruar poetik si “*Ai Muhamed u bë me vullnet të të vërtetit mëshirë për botërat; ky Mehmet u bë hije e mëshirës së Zotit mbi popullin*”. Tursun Bej, *Kronikat e Tursun Beut Tarihi Ebu'l-Feth*, (Tiranë: Idk, 2011), f. 45! Kështu përmes ndikimit të kronistëve të kohës, duke iu referuar të kaluarës së hershme islame, u ngrit një lidship i ri i një udhëheqësi mysliman mbi suazat e kalifit.

4 Mehmet Maksudoglu, *Historia Osmane dhe Institucionet*, (Tiranë: Alsar, 2019), f. 237-238.

5 Në përgjithësi Sulltan Selimi i parë i dha fund zotërimeve Memlukes që shtriheshin nga Egjipti i sipërm deri në Anadollin Qendror, ku përfshinin edhe Palestinën dhe Sirinë. Shih: Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, (Tiranë: Dituria, 2004), f. 29! Ky sukses bëri që shtrirja e shtetit osman, të përfshinte edhe skajin e lartë të sundimit të memlukëve dhe përmes saj të arrinin pozitën e kalifit islam.

6 Në kohën e memlukëve kemi ndarjen e pozitës ndërmjet sultanit memluk dhe kalifit. Kalifi vinte nga dinastia e Abasidëve ku i fundit nga ta ishte Al Mutawakkili, ndërsa sultani i fundit ishte sultan Tumani, i cili do mposhte nga Selimi i parë, njëjtë sikurse edhe paraardhësi i tij, Sulltan Al Gawri.

7 Halil Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye Studime mbi Perandorinë Osmane periudha klasike (1302-1606) zhvillimi politik, institucional e ekonomik*, (Tiranë: Fan Noli, 2021), f. 168.

8 Maksudoglu, *Historia Osmane*, f. 234.

9 Halil Inalcik, *Perandoria Osmane periudha klasike 1300-1600*, (Tiranë: Dituria, 2013), f. 47-48.

10 Inalxhik dhe Renda. *Qytetërimi Osman I*, f. 110.

11 Inalxhik, *Devlet-i 'Aliye*, f. 168. Vlen të theksohet se me pushtimin mongol të qytetit të Bagdadit, i erdhi fundi edhe kalifatit Abasid dhe ky kalifat do bartej te memlukët, të cilët udhëhoqën deri në vitin 1517, ku pas saj filloi edhe udhëheqja e kalifatit osman, kalifat ky që solli njëzetë e nëntë kalifë.

12 Inalxhik dhe Renda. *Qytetërimi Osman I*, f.110-111.

13 Sipas disa transmetimeve të kronikave të kohës, Sulltan Selimit të parë iu ofrua një pozitë e quajtur Hakim El Haramejn apo udhëheqës i dy vendeve të shenjta, megjithatë ai iu mbështet pozitës Hadimul el Haramejn apo shërbëtor i dy vendeve të shenjta, fjala për Mekën dhe Medinën. Kjo pozitë ishte krijuar nga periudha e kalifatit Abasid.

Jeta e fakihut dhe muhadithit të njohur bashkëkohor Muhamed Teki Osmanit

Blerton Bahtiri

Diobend është një qytezë e vogël ku ka lindur Teki Osmani. Në këtë qytezë ekziston një medrese e madhe e quajtur Daru'l-Ulum Diobend, e cila ofron arsimim islam. Qyteza e Diobendit u bë e famshme si "Ezherul Hind" për shkak të pranisë së kësaj qendre arsimore islame.

PREJARDHJA

Emri i tij i plotë është Muhamed Teki Osmani b. Muhamed Shefi' Muhamed Jasin b. Halife Tahsin Ali b. Mijanxhi Imam Ali b. Mijanxhi Hafiz Kerimullah b. Mijanxhi Hajrullah b. Mijanxhi Shukrullah.¹ Ai lindi në vitin 1943 në qytetin Diobend të qytezës Seharenpur në Uttar Pradesh të Indisë.²

Nofka Osmani në familjen e Teki Osmanit është trashëguar nga babai te djali. Edhe pse supozohet se ata janë nga familja e halifit të tretë, hz. Othman b. Affanit r.a., nuk ka asnjë dëshmi autentike historike në lidhje me këtë. Babai i Teki Osmanit, Muhamed Shefi' (v. 1976) thotë që prejardhja jonë është nga prejardhja (soji) i hz. Othmanit r.a. Muhamed Shefi' këtë nofkë e nga dëgjuar nga brezat e tij të mëparshëm dhe këtë e përdorë si argument të mjaftueshëm.³

RRETHI KU KA JETUAR

Diobend është një qytezë e vogël ku ka lindur Teki Osmani. Në këtë qytezë ekziston një medrese e madhe e quajtur Daru'l-Ulum Diobend, e cila ofron arsimim islam. Qyteza e Diobendit u bë e famshme si "Ezherul Hind" për shkak të pranisë së kësaj qendre arsimore islame.⁴

Daru'l Ulum Diobend u themelua më 15 Muharrem 1283/360, maj 1866 në Diobend, një qytezë e Seharanpur, nga tre persona të quajtur: Muhamed Abid Hysejin, Mevlana Zulfikar Ali dhe Mevlana Fazlu'r-Rahman Osmani. Kjo medrese sot në botën islame



është bërë e njohur me emrin Darul Ulum Diobend dhe nxënësit që diplomohen prej saj quhen "Diobendi". Disa vjet pas themelimit të këtij vendi, Mevlana Kasëm Nanutevi erdhi këtu nga vendi i quajtur Mireth dhe mori kontrollin e medresesë dhe bëri një përpjekje të madhe për themelimin e medresesë. Këto shërbime, të cilat ai i kreu më vonë, bënë që ai të quhej themelues i medresesë.⁵

Medresetë Diobend, si medresetë dhe institucionet e tjera të ngjashme në botën islame, i plotësojnë nevojat e tyre me ndihmën e njerëzve dhe përmes fondacioneve. Që nga themelimi i medresesë e deri në ditët e sotme, studentë myslimanë nga jashtë Indisë erdhën nga qytete të ndryshme dhe u arsimuan në këtë medrese.⁶

Kjo medrese, e cila ka përgatitur mijëra dijetarë, intelektualë dhe thirrës islam, është edhe medreseja ku u shkollua edhe shejhu i njohur, Teki Osmani. Kjo medrese ka një pozitë të rëndësishme në drejtim të fillimit dhe rritjes së edukimit të tij shkencor. Për të mbushur boshllëkun e mundshëm që do të ndodhë pasi Pakistani të fitojë pavarësinë e tij, disa mësues të medresesë Darul Ulum Diobend u caktuan të migrojnë në Pakistan. Babai i Muhamed Teki Osmanit, Muhamed Shefi, ishte në mesin e atyre që iu dha misioni i emigrimit në Pakistan. Pas pavarësisë, Muhamed Shefi migroi në Pakistan me djalin e tij, Teki Osmanin, dhe u vendos në Karaçi. Në kohën e migrimit, Teki Osmani ishte vetëm pesë vjeç. Teki Osmani e filloi shkollimin e parë në medrese në moshën tetë vjeçare, në medresenë Darul Ulum të themeluar nga babai i tij Muhamed Shefi në Karaçi ku dhe atje vazhdoi shkollimin e tij.⁷

FAMILJA E TIJ

Muhamed Teki Osmani lindi në një familje fetare me traditë shkencore në qytezën e Diobendit. Familja e Teki Osmanit shquhej për shërbimet e tyre shkencore. Këtë e tregon edhe fjala “Mijanxhi”, e cila është ngjitur me emrat e kësaj familjeje. Fjala “Mijanxhi” në gjuhën urdishte (gjuha zyrtare në Pakistan) do të thotë mësues dhe profesor.⁸

Gjyshi i Osmanit, Muhamed Jasini, ishte një dijetar që jetoi mes viteve 1856-1936. Ishte ndër nxënësit e parë që studioi shkencat islame në vitet e para të themelimit të Medresesë Diobend. Muhamed Jasini mori trajnime nga mësues të mëdhenj si, Jakup en-Nanotevi, Sejjid Ahmed ed-Dehlevi, Mahmud ed-Dijobendi. Ai mori arsimin e tij për letërsinë persiane nga poeti i famshëm Mirza Galip Hindi dhe arriti një pozitë të rëndësishme. Në medresenë Diobend Darul Ulum u bë i famshëm për mësimin e kurseve të gjuhës dhe letërsisë persiane. Madje, atij iu dha zyra e kreut të mësuesve të degës së letërsisë persiane. Ai u kushtoi rëndësi botimeve dhe shkruante artikuj në revista dhe gazeta. Ai ka shumë vepra që lidhen me mësimdhënien persiane. Shumë nga stërgjyshërit e tij ishin edhe mësues medreseje.⁹

Babai i Teki Osmanit, Muhamed Shefi, lindi më 24 janar 1897. Ai ishte një dijetar, jurist dhe politikan i arsimuar. Muhamed Shefi luajti një rol të madh në edukimin dhe prirjen e Teki Osmanit drejt edukimit shkencor.¹⁰ Teki

Në hyrjen e librit “*Tekmiletu Fethi’l-Mulhim bi Sherhi Sahihi’l-Imam Muslim*”, ai përmendi qartë se është pjesëtar i medhhebit hanefi dhe argumentoi se është e detyrueshme të imitohet (taklid) një imam nga katër medhhebet.

Osmani, në një konferencë në Turqi, tha se kur nuk e dinte ende se çfarë ishte shkencë (dituria), hyri në bibliotekën e babait të tij dhe hapi librat; ai deklaroi se i mësoi emrat e librave, autorët e librave etj. dhe si rrjedhojë ai kishte deklaruar që iu është krijuar dashuria për librat. Babai i tij e këshilloi që gjuha e tij të ishte e butë, jo e ashpër, kur ai shkruante refuzime ndaj sekteve devijuese (batil). Pas kësaj këshille, ai rishikoi të gjithë librat e tij dhe përdori një gjuhë të butë dhe dashamirëse. Një këshillë tjetër e babait të tij që pati shumë ndikim është edhe kjo: “Biri im! Imagjino çdo çështje që shkruan në këtë kuadër! Shkruaj për çështje që mund t’i mbrosh kur thirrësh në një gjykatë për ta argumentuar atë. Nëse nuk je në gjendje ta argumentosh çështjen tende në gjykatat e botës, mos harro se do të jesh i pafuqishëm edhe në Ahiret”. Më pastaj Teki Osmani në shkrimet e tij të mëvonshme gjithmonë ka vepruar me këshillën që ia ka dhënë babai i tij.


Teki Osmani është rritur në një familje të përkushtuar ndaj dijes e shkencës. Teki Osmani, i cili u rrit në këtë mjedis shkencor, lindi interesimi i madh për shkencën e dijen. Allahu xh.sh. i dhuroi Teki Osmanit një memorie të fortë, aftësi të thellë kuptueshmërie, lehtësi në memorizimin dhe një karakter të fortë e të qartë. Këto veçori e ndihmuan Teki Osmanin të thellohej në shkencë.¹¹

Teki Osmani bashkë me familjen e tij, në vitin 1948 emigroi në Pakistan. Myslimanët në atë vend bënë një përpjekje të madhe që Pakistani të shpallte pavarësinë e saj. Vlen të përmendet se në vitin 1906 është formuar

Lidhja Myslimane Indiane për të mbrojtur të drejtat politike të myslimanëve në Indi.¹² Pasi që myslimanët u përçmuan nga hindusët dhe u trajtuan si qytetarë të klasit të dytë nga britanikët në kohën sa ata e sundonin Indinë, ata fituan pavarësinë e tyre si rezultat i përpjekjeve të unitetit mysliman dhe Pakistani u krijua si një shtet i pavarur islamik.¹³

MEDHHEBI I TIJ

Teki Osmani u rrit në një mjedis të dominuar nga shkolla Diobend, e cila është pjesëtare e medhhebit hanefi. Në hyrjen e librit “*Tekmiletu Fethi’l-Mulhim bi Sherhi Sahihi’l-Imam Muslim*”, ai përmendi qartë se është pjesëtar i medhhebit hanefi dhe argumentoi se është e detyrueshme të imitohet (taklid) një imam nga katër medhhebet.¹⁴



JETA SHKENCORE E TIJ

Sa ishte duke u ndërtuar Darul Ulum në Karaçi, Osmani mori arsimin e parë në persisht dhe urdisht nga nëna dhe kunati i tij. Pas krijimit të Darul Ulum ne vitin 1951, ai u regjistrua atje. Ai ishte vetëm tetë vjeç kur filloi medresenë dhe ishte ndër nxënësit e parë të kësaj medreseje të re.¹⁵

Osmanit i pëlqente të punonte dhe e shfrytëzonte kohën e lirë. Në ditë festash, ndërsa nxënësit tjerë shkonin për të luajtur, ai shkonte në bibliotekë dhe merrej me libra dhe bënte detyrat që i jepte babai.¹⁶

Shkollimin e mesëm e kreu për tetë vjet. Në vitin 1959 hixhri/1379 gregorian, përfundoi shkollën e mesme me sukses shembullor. Mësimet që mori në shkollën e mesme përfshinin pothuajse të gjitha shkencat e sheriatit dhe shkencat alije-transcendentale (Ulumul Alije).¹⁷

Arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, Osmani i kreu në Medresenë Darul Ulum Diobend të Karaçit, të cilën babai i tij e themeloi në vitin 1951 dhe u diplomua në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, duke u diplomuar i pari për hadith. Pas përfundimit të shkollës së mesme në Darul Ulum, ai filloi të jepte mësim në Darul Ulum kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç. Në të njëjtën kohë, së bashku me vëllain e tij të madh, Muhamed Rafi, u regjistruan për specializim në seksionin Ifta në Darul Ulum. Ai studioi në seksionin ifta për dy vjet nën mbikëqyrjen e babait të tij, Muhamed Shefi' dhe Veli Hasanit. Më pas ai u diplomua në atë specializim në vitin 1961.¹⁸

MËSUESIT E TIJ

Muhamed Shefi' Ed-Diobendi (v. 1976): Teki Osmani studioi fikh dhe ifta nga babai i tij; Ai nga babai i tij lexoi librat: "Shemailin" e Tirmidhiut dhe "Muvettanë" e Malikut.

Ekber Ali (v. 1977): Osmani lexoi Sahih-i Muslim, Tefsiru'l-Xhelalejn dhe libra të ndryshëm prej tij.¹⁹

Nur Ahmed (v. 1986): Ai mësoi të lexonte Kuranin e shenjtë dhe urdu prej tij.²⁰

Veli Hasan (v. 1994): Prej tij ka lexuar disa libra për gjuhën arabe dhe fikh.²¹

Muhamed Rijayetullah (v. 1999): Ai lexoi Sunenin e Ibën Maxhes prej tij.²²

LIBRAT E TIJ

Dua t'i shënoj vetëm veprat ne lëmin e fikhut dhe të hadithit. Veprat të cilat i ka shënuar ne lëmin e fikhut janë:

"Taklid fi midhan", "Ahkamu'l-Itikaf", "Ahkamu'dh-Dhebah", "Usulu'l-Ifta ve Adabuhu, Fetvaj-i Osmani".

Ndërsa veprat që i ka shënuar në lëmin e hadithit janë:

"Ders-i Tirmidhi", "Huxhijetu'l-Hadith", "Tekmiletu Fethi'l-Mulhim".

1 Lokman Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, Dârul-Kalem, Bejrut 2002, fq. 11.

2 Muhammed Teki Osmani, *Sünnetin Değeri ve Bağlayıcılığı*, Mehmet Özşenel (çev), İFAV Yay., İstanbul 2017, fq.2.

3 Muhammed Şefi' Osmani, "*Muhammed Teki Osmani*", Belâğ Dergisi, Nr. 1, fq. 80.

4 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 12.

5 Zaferullah Daudi, *Pakistan ve Hindistan'da Hadis çalışmaları*, İnsan Yay., İstanbul 1995, fq. 291.

6 Mehmet Ali Büyükkara, *Çağdaş İslami Akımlar*, Klasik Yay., İstanbul 2016, fq. 87-88.

7 Enver Konukçu, "*Karaçi*", Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, v. 24, Türkiye Diyanet Vakfı Yay., İstanbul 1998, fq.95.

8 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 13-14.

9 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 14-15.

10 İhsan Şenocak, "Hintli Bir Hakim'in Ufkunda: Nasıl Alim Oldular?" *Hüküm Dergisi*, Nr. 51, 2017, fq. 10.

11 Muhammed Teki Osmani, *Tekmiletu Fethi'l-Mulhim bi Sherhi Sahihi'l-Muslim*, v. 4, Darul-Kalem, Damask, 2006, fq. 13-14.

12 Azmi Özcan, "*Pakistan*", Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, v. 36, Türkiye Diyanet Vakfı Yay., İstanbul, 2007, fq. 147.

13 M. Naeem Qureshi, "*Hindistan Müslümanları Birliği*", Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, v. 18, Türkiye Diyanet Vakfı Yay., İstanbul, 1998, fq. 111.

14 Osmani, *Tekmiletu Fethi'l-Mulhim bi Sherhi Sahihi'l-Muslim*, v. 4, fq. 20. Ja vlen të ceket se ky libër mësohet në Turqi, në medresetë të cilat vazhdojnë mësimin me usul të vjetër. Nëse do e cekemi njërin prej medreseve, ajo është edhe medreseja İFAM, e cila gjendet në pjesën e Detit të Zi në Turqi. Posaçërisht në qytetin Samsun.

15 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 25.

16 Shefi' Osmani, "*Muhammed Teki Osmani*", Belâğ Dergisi, Nr. 2, fq. 1065.

17 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 37. Ulumu Alije janë: gramatikë arabe, sintaksë (nahv), logjikë (mantek), belagat, sarf.

18 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 37.

19 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 28.

20 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 30.

21 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 29.

22 Hakim, *Muhammed Teki Osmani*, fq. 31.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOORDINATOREN E RE TË TIKA-S NË KOSOVË, ZNJ. FULYA ASLAN

Më 24 gusht 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim koordinatoren e re të Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim në Kosovë (TIKA), znj. Fulya Aslan.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje znj. Aslan, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në detyrën e saj të re. Më pas, ai e njohu atë me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin e mirë që ka BIK-u dhe TIKA. Ai tha se falë këtij bashkëpunimi janë restauruar disa objekte të trashëgimisë fetare islame në vend, për çka Myftiu Tërnavë u shpreh tejet falënderues ndaj kësaj Agjencie. Myftiu Tërnavë tha se deri më tani kanë pasur një bashkëpunim shumë të mirë me të gjithë koordinorët e mëparshëm, dhe se shpresojmë se një



bashkëpunim të tillë do ta kemi edhe me znj. Aslan, e cila tashmë është në krye të TIKA-s në Kosovë.

Nga ana e saj, znj. Fulya Aslan, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për bashkëpunimin e mirë të deritanishëm që kanë pasur, duke pohuar kështu se një gjë e tillë do të

vazhdojë edhe në të ardhmen, pra edhe gjatë udhëheqjes së saj.

Agjencia TIKA përgjatë viteve të fundit ka restauruar disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë fetare islame në Kosovë.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 24 gusht 2023, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj të rregullt, të cilën e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Fillimisht ai falënderoi anëtarët e Kryesisë për punën dhe

angazhimin e tyre të dhënë, duke kërkuar nga ta që të vazhdojnë edhe më tej punën për të mirën e besimtarëve tanë.

Kryesia e BIK-ut, pasi shqyrtoi dhe debatoi për raportet, miratoi raportin

për haxhin 2023 dhe raportin për kurbanin 2023, e po ashtu shqyrtoi dhe miratoi lëndë të ndryshme, si dhe mori vendime në bazë të kompetencave të cilat i takojnë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NJË GRUP STUDENTËSH NGA TURQIA

Më 31 gusht 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një grup studentësh nga Turqia, të cilët udhëhiqeshin nga znj. Hacer Karagul. Kjo vizitë erdhi falë bashkëpunimit të mirë që ka Bashkësia Islame e Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje studentëve, e më pas i njohu ata për bashkëpunimin që ka Bashkësia Islame e Kosovës me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, kryesisht në fushën e trashëgimisë kulturore, humanitare e sociale, e tashmë së fundi edhe në shkëmbimin e studentëve në dy vendet tona. Myftiu Tërnavë, ndër të tjera potencoi rëndësinë e vizitave në mënyrë që të vazhdohet edhe më tej miqësia dhe dashamirësia që kanë dy popujt ndërmjet vete.



Në emër të studentëve, znj. Hacer Karagul, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, si dhe gjithë ekipin që janë angazhuar këto ditë për pritjen e studentëve. Ajo tha se energjia dhe pozitiviteti që kanë treguar studentët kosovarë gjatë vizitës së tyre në Turqi, ka bërë të mundshme që të vazhdohet edhe më tutje ky projekt i vizitave studimore të ndërsjella.

Në qershor të këtij viti, falë bashkëpunimit të mirë ndërmjet dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë, një grup studentësh nga Kosova qëndruan për vizitë disa ditore në disa qytete të Turqisë.

KRYESIA E BIK-UT MBAJTI TAKIMIN TRADICIONAL ME BASHKATDHETARËT TANË

Më 1 gusht 2023, nën organizimin e Drejtorisë për Diasporë në Kyrësinë e BIK-ut, u mbajt takimi me bashkatdhetarët tanë që gjenden në diasporë. Në këtë takim u vlerësua lart roli dhe kontributi i bashkatdhetarët tanë dhënë për vendlindjen në përgjithësi dhe për institucionin e BIK-ut në veçanti.

Në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë, të pranishmit i përshëndeti zv.kryetari i Kryesisë së BIK-ut, Ahmet ef. Rama, i cili ndër të tjera falënderi mërgatën e cila ka një meritë të çmuar për ngritjen infrastrukturore të Medresesë.

Drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, në fjalën e tij potencoi se: "S'ka dyshim se ju jeni në shtëpinë tuaj. Ky vend ku ne qe sa vite po organizojmë këtë takim, është një vatrë edukimi dhe është shtëpia e të gjithëve, juaja dhe jona. Nga këtu kanë dalë mesazhe paqeje dhe dashurie!"

Në fjalën e tij, drejtori i Medresesë, Fadil ef. Hasani, shprehu një falënderim të veçantë për kontributin e vazhdueshëm të bashkatdhetarëve tanë



për ngritjen infrastrukturore të Medresesë, si dhe para tyre shpalosi edhe të arriturat dhe sukseset e kësaj shkolle.

Këtë takim e përshëndetën edhe kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, Mehas ef. Alija, kryetari i Unionit Mysliman Shqiptar në Austri, Vahidin ef. Behluli dhe kryetari i Unionit të Qendrave Islame

Shqiptare të Gjermanisë, Mensur ef. Halili, për të cilët Drejtoria e Diasporës e BIK-ut ndau nga një mirënjohje për bashkëpunimin dhe kontributin e vazhdueshëm dhënë për institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në fund, para të pranishmëve u kënduan edhe disa ilahi nga kori i Medresesë, si dhe u shtrua dreke për të gjithë të pranishmit.

SHEFI I KABINETIT TË MYFTIUT TËRËNAVA, MR. BESIM EF. MEHMETI, U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRI I ÇËSHTJEVE FETARE TË ARABISË SAUDITE

Më 13 gusht 2023, shefi i kabinetit të Myftiut Naim ef. Tërëna, mr. Besim ef. Mehmeti, gjatë qëndrimit të tij në Arabinë Saudite, u prit në takim të veçantë nga ministri i Çështjeve Fetare, dr. Abdulatif al Sheikh.

Besim ef. Mehmeti, përcolli përshëndetjet e Myftiut Tërëna, duke falënderuar kështu ministrin për ftesën dhe mundësinë e pjesëmarrjes në këtë Konferencë. Ai gjithashtu falënderoi Mbretërinë e Arabisë Saudite për përkrahjen e ofruar për Kosovën në periudha dhe sfera të ndryshme.

Nga ana e tij, ministri saudit, fillimisht i dëshiroi z. Mehmetit mirëseardhje në këtë Konferencë, e më pas përcolli përshëndetjet për Myftiun e Kosovës, Bashkësinë Islame dhe popullin e

Kosovës. Ai shprehu përkushtimin e Ministrisë që ai drejton për thellimin e

bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.



U MBAJT KONFERENCA “KOMUNIKIM DHE INTEGRIM”

Nën kujdesin e mbretit të Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz al Saudit, Ministria e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, më 13 dhe 14 gusht, ka mbajtur Konferencën e komunikimit me departamentet e çështjeve islame, fetvasë, bashkësitë islame dhe si motrat në botë me titull “Komunikimi dhe integrimin”. Kjo Konferencë rreth vetes ka mbledhur ministra, myftinjë, udhëheqës fetarë, kryetarë të bashkësive fetare nga rreth 85 vende të ndryshme të botës. Në këtë Konferencë, Bashkësinë Islame të Kosovës, e përfaqësoi shefi i kabinetit të Myftiut Naim ef. Tërëna, mr. Besim ef. Mehmeti.

Në fjalën e tij përshëndetëse para të pranishmëve, ministri i Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, dr. Abdulatif bin Abdulaziz al Sheikh, shprehu falënderimet e tij të sinqerta për Kujdestarin e Dy Xhamive të Shenjta, për mbështetjen e madhe që i ofrojnë Ministrisë në fusha të ndryshme. Ai më pas falënderoi pjesëmarrësit në këtë Konferencë, duke theksuar këtu se organizimi i saj synon t'i forcojë lidhjet e komunikimit dhe integritetit midis departamenteve të çështjeve fetare për t'i përforcuar parimet e modernitetit dhe mesatares. Po ashtu kjo Konferencë



synon promovimin e vlerave të tolerancës dhe të bashkëjetesës ndërmjet popujve, rëndësinë e nevojshme për t'iu përmbajtur Kuranit dhe Sunetit të Profetit, promovimin e unitetit ndërmjet myslimanëve, luftimin e ideve ekstreme, si dhe mbrojtjen e shoqërisë nga ateizmi.

Gjatë dy ditëve të saj, në Konferencë u diskutuan këto tema:

Përpyjekjet e departamenteve të çështjeve fetare, fetvave dhe bashkësive islame në botë për të qenë në shërbim të Islamit dhe myslimanëve, si dhe promovimi i unitetit islam;

- Komunikimi dhe integrimi ndërmjet realitetit dhe aspiratave;
- Përpyjekjet për të promovuar vlerat e tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet popujve;
- Përmbajtja ndaj mësimëve kuranore dhe profetike;
- Moderniteti dhe mesatarja në mësimet kuranore dhe profetike;
- Përpyjekjet në luftën kundër ekstremizmit dhe terrorizmit;
- Përpyjekjet për të mbrojtur shoqërinë nga ateizmi.

TAKIMET E KËSHILLAVE TË BI-SË ME BASHKATDHETARË

Me qëllim, pritjen e bashkatdhetarëve tanë, Këshilli i BI-së së Gjilanit, Malishevës dhe Gjakovës, organizuan takime për t'iu uruar mirëseardhje në vendlindje. Takimet u oranzizuan si vijon:

Më 2 gusht 2023, Këshilli i BI-së së Gjilanit, nën organizimi e kryetarit, Naim ef. Aliut. Këtë takim e përshëndeti edhe imami Xheladin ef. Leka, imam në Zvicër.

Më 3 gusht 2023, Këshilli i BI-së së Malishevës, nën organizimi e kryetarit Sead ef. Paqarizit.

Ndërkaq, më 7 gusht 2023, në Gjakovë u organizua një takim i tillë, nga Këshilli i BI-së së Gjakovës, nën organizimi e kryetarit Valon ef. Myrta, ku në emër të bashkatdhetarëve, foli imami Enis ef. Hoxha, i cili jeton dhe vepron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këto takime, pjesëmarrës ishte edhe drejtori për diasporë në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, i cili kërkoi nga bashkatdhetarët që të japin sa më shumë kontribut në qendrat dhe unionet që ata i kanë në diasporë, në mënyrë që fëmijët e tyre ta kenë një edukim sa më të mirë.



TAKIMET E DREJTORIT TË DIASPORËS NË KRYESINË E BIK-UT, EKREM EF. SIMNICËS

Më 17 gusht 2023, drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, priti në takim kryetarin e Unionit Shqiptar Mysliman në Austri, Vahidin Behlulin. Ai fillimisht i uroi mirëseardhje në institucionin e BIK-ut, duke potencuar kështu përkushtimin e Drejtorisë që ai udhëheq për një bashkëpunim sa më të mirë me qendrat dhe unionet që funksionojnë në diasporë.

Nga ana e tij, kryetari Behluli, falënderoi drejtorin Simnica për pritjen dhe për interesimin dhe gatishmërinë për të qenë sa më pranë bashkatdhetarëve. Ai tha se si Union, mbesim të përkushtuar që të kemi marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë me Bashkësinë Islame të Kosovës.

Ndërkaq, më 22 gusht 2023, drejtori Simnica, vizitoi në banesën e tij, kryetarin e xhamisë shqiptare "Bashkimi" në Kehl-Strasbourg të Gjermanisë, z. Murat Uka.

Drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, në bisedën e tij, theks të veçantë i kushtoi vlerës së xhamisë në mërgatë, e në veçanti xhamisë "Bashkimi", si dhe punës dhe veprimtarisë së institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai e uroi z. Uka për blerjen e objektit për xhami. Në shenjë respekti dhe nderi, drejtori Simnica, i dhuroi kryetarit Uka një dhuratë me



libra. Z. Uka falënderoi drejtorin Simnica për vizitën, ndihmën e BIK-ut dhe nderin e ofruar, duke lutur Zotin për një mirëqenie sa më të mirë.

KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 17 gusht 2023, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, mbajti mbledhjen e radhës, të cilën e kryesoi drejtori i këtij instituti, prof. Sabri ef. Bajgora.

Në këtë mbledhje u diskutua rreth organizimit të Konferencës ndërkombëtare me titull “Historiku, roli, rëndësia, arkitektura dhe trajtimi i xhamive në trojet shqiptare”, e cila parashihet të mbahet më 30 dhe 31 tetor të këtij viti.



U MBAJTËN GARAT E NJOHURIVE FETARE NË NIVEL VENDI



Nën organizimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, të shtunën, më 26 gusht 2023, në Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë u mbajtën garat tashmë tradicionale të njohurive fetare me nxënësit nga e gjithë Kosova.

Mbi 90 garues iu bashkuan kësaj gare për njohuritë e tyre në Kuran, akaid, fikh dhe histori islame, ndërsa në fund fitues të kësaj gare u shpallën nxënësit nga Prizreni, teksa në vendin e dytë u renditen nxënësit nga Fushë Kosova

dhe në vendin e tretë nxënësit nga Prishtina.

Për nxënësit këto gara janë të rëndësishme dhe shprehen se për to janë përgatitur tash e disa kohë.

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, tha se për Bashkësinë Islame të Kosovës, çështja e mësim-besimit është prioritet kryesor dhe jo vetëm, për këtë arsye një gjë e tillë është masivizuar në të gjithë Kosovën.

Drejtori i Medresesë, Fadil Hasani, tha se ndjehet i lumtur që po sheh fëmijë të interesuar dhe të përgatitur në çështjet fetare islame.

Gara e njohurive të përgjithshme fetare organizohet tash e 11 vjet, me nxënës nga gjithë vendi, të cilët marrin pjesë në këto gara. Përveç aspektit garues, ky organizim ka për qëllim që të nxisë të rinjtë të rrisin njohurit fetare nga fushat kryesisht islame.



Libri “Hera e parë në Mekë” është i mbushur me informacione, gëlon nga toponimet, emrat e vendeve më të veçantë, personazhet e shumtë, plot prej tyre bashkudhëtarë të autorit, e deri tek emrat e ushqimeve e pijeve, veshjeve e fenomeneve. Ndërsa ecën dhe rrëfen, autori zbulon për lexuesin pamjet që i shfaqen, duke i përshkruar me mjeshtri, e cepave të fletëve të librit ia jep mundësinë këtij të fundit që të avitet edhe më pranë thelbit të tregimit, nëpërmjet QR kodeve. Libri, kështu, mund ta fitojë edhe cilësorin “i mençur”, pasi nëpërmjet tyre na nxjerr në fusha krejt të tjera, e që e plotësojnë më tutje informacionin me anë hartash, fotografish a videosh, duke i përfshirë këtu edhe kasidet e interpretuara prej artistëve të ndryshëm. Mjafton ta kesh pranë vetes një telefon të mençur, dhe të bindesh për këtë. (Imer Topanica)

DITURIA ISLAME • Nr. 394 SHTATOR 2023